



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 672 Akti

Nr. 721 Vendimi
Tiranë, më 6.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Etleđa Çiftja	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 4.12.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Françeskina Lekani**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleđa Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit

Françeskina Lekani, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Françeskina Lekani është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Znj. Françeskina Lekani, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Etleda Çiftja dhe Lulzim Hamitaj.

3. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 21.12.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) ish-DSIK, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

5. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, mbi përbërjen e trupit gjykues dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektin informacion shtesë, sipas pyetësorit standard.

6. Në përgjigje, përmes postës elektronike², subjekti paraqiti në Komision dokumentet provuese lidhur me procesin e rivlerësimit dhe nuk ka deklaruar kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

7. Në vijim, Komisioni, përmes postës elektronike³, njoftoi subjektin se me *email*-in e datës 29.1.2021, ka dërguar dokumentacionin provues, por nuk ka dërguar përgjigjet e pyetësorit standard.

8. Në përgjigje, subjekti, përmes postës elektronike⁴, paraqiti përgjigjet e pyetësorit standard.

¹ *Email*, datë 13.1.2021, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

² *Email*, datë 29.1.2021, “Materialet e prokurores Françeskina Lekani”.

³ *Email*, datë 24.7.2023.

⁴ *Email*, datë 24.7.2023.

9. Trupi gjykues, me vendimin e datës 8.11.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Françeskina Lekani, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

10. Në datën 9.11.2023, përmes postës elektronike⁵, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim subjektit iu kërkuar të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 23.11.2023.

11. Në datën 22.11.2023, përmes postës elektronike⁶, subjekti paraqiti shpjegimet me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht. Gjithashtu, shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin provues e paraqiti edhe me depozitim në protokoll⁷ pranë Komisionit.

12. Më tej, Komisioni, në datën 30.11.2023, me anë të postës elektronike⁸, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 4.12.2023, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

13. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Françeskina Lekani, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Në datën 4.12.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, si dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë bashkë me avokatin S. I..

15. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

16. Znj. Françeskina Lekani, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

⁵ Email datë 9.11.2023, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

⁶ Email datë 22.11.2023

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.11.2023 (protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 23.11.2023).

⁸ Email datë 30.11.2023 "Ftesë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore publike për procesin tuaj të rivlerësimit".

17. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 4.12.2023, subjekti i rivlerësimit Françeskina Lekani kërkoi konfirmimin në detyrë.

18. Seanca dëgjimore e datës 4.12.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 6.12.2023, me shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit Françeskina Lekani ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

21. Sipas krerëve IV, V dhe VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017⁹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Françeskina Lekani, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe

⁹ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

24. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* 2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Tokë arë me sipërfaqe 5.500 m², me vendndodhje fshati *, Shkodër, në bashkëpronësi**

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Tokë arë me sipërfaqe 5.500 m², ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, ndodhet në fshatin ***, Njësia Administrative ***. Kjo sipërfaqe toke është e trashëguar nga babai im F. L., që e ka përfitur nga ligji nr. 7501. Toka nuk është e vlerësuar në vlerë (trashëgimtare). Zotëroj 33,3 %*”. Si burim krijimi deklaron: “*E trashëguar nga babai im F. L., që e ka përfitur*

nga ligji nr. 7501”. Për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁰.

1.2. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 (administruar edhe nga ASHK Shkodër¹¹) rezulton se shtetasi F. L., në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, është pajisur me AMTP-në nr. ***, pa datë, fshati ***, për pasurinë tokë arë me sip. 5.500 m², e cila më pas është regjistruar në ASHK-në Shkodër me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 5.500 m², ***, Shkodër.

1.3. Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 26.9.2016, rezulton se shtetasi F. L. ka ndërruar jetë në datën 1.8.2016 dhe trashëgimtarë ligjorë të tij janë përcaktuar: G. L. (bashkëshortja); Françeskina Lekani (e bija) dhe F. L. (i biri), të cilët kanë trashëguar të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të të ndjerit me nga 1/3 pjesë.

1.4. Më pas, pasuria e mësipërme është regjistruar në pronësi të shtetasve F. L. me 1/6 pjesë, Françeskina Lekani me 1/6 pjesë dhe G. L. me 4/6 pjesë dhe është shitur në datën 1.8.2017 me çmim 1.480.000 lekë¹².

1.5. Nga informacioni i administruar nga DPGJC-ja¹³ rezulton se subjekti i rivlerësimit figuron në gjendjen familjare të shtetasit F. L., në datën 1.8.1991.

1.6. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të vjetore bashkëpronësinë mbi sipërfaqen e tokës bujqësore të përfutur si anëtar i familjes bujqësore sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, por nga viti 2016 e në vijim ka deklaruar vetëm pjesën e saj takuese nga e drejta e trashëgimisë së babait të saj.

1.7. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk ka pasur qëllim fshehjeje të pasurisë, pasi formulari i AMTP-së ka qenë në emër të babait të saj dhe nuk ishte bashkëpronare në këtë pasuri. Sipas saj, të drejtat reale pasurore mbi këtë pronë i ka fituar pas vdekjes së babait dhe çeljes së trashëgimisë.

1.8. Referuar pikës 2 të VKM-së nr. ***, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, toka bujqësore ndahej për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes familjare, në datën 1.8.1991. Nga informacioni i administruar nga DPGJC-ja¹⁵ rezulton se subjekti figuron në gjendjen familjare të shtetasit F. L., në datën 1.8.1991. Për pasojë, shpjegimi i subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit nuk është i mbështetur në aktin e mësipërm nënligjor.

1.9. Megjithatë, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i pjesës takuese nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore e, më pas, deklarimi jo i saktë i pjesës së saj takuese në deklaratën *Vetting* 2017 nuk ndikon në vlerësimin e kësaj pasurie në kuadër të procesit e rivlerësimit.

1.10. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

¹⁰ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 9.3.2015; informacion mbi pasurinë nr. *** prot., datë 17.1.2017, të ZVRPP-së Shkodër; certifikatë për vërtetim pronësie datë 14.11.2016, bashkë me kartelën e regjistrimit; dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 26.9.2016.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.7.2023; shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2017, administruar nga ILDKPKI-ja.

¹² Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme tokë arë, me nr. ***, datë 1.8.2017, administruar nga noter L. H., me blerës Gj. B., kundrejt çmimit të shitjes 1.480.000 lekë. BKT-ja konfirmon se shumica e mësipërme ka kaluar në datën 25.10.2017 nga noteri në llogarinë e përbashkët të shtetasve G., Françeskina e F. L.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 1.8.2023.

¹⁴ Email datë 22.11.2023.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 1.8.2023.

2. Tokë arë me sipërfaqe 2.715 m², me vendndodhje fshati *, Shkodër, në bashkëpronësi**

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Tokë arë me sip. 2.715 m², ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në fshatin ***, Njësia Administrative ***, e trashëguar nga i ndjeri, babai im F. L., blerë vëllait të tij A. L. Kontrata e shitblerjes e datës 1.2.2003. Pjesa 33,3%”. Si burim krijimi deklaror “E trashëguar nga babai”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁶.

2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, të administruar edhe nga ASHK Shkodër¹⁷, rezulton se sipas kontratës nr. ***, datë 1.2.2003, shtetasi F. L. ka blerë nga shtetasi A. L. pasurinë e llojit arë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me vendndodhje ***, në vlerën 50.000 lekë, e cila i është dorëzuar shitësve jashtë zyrës noteriale.

2.3. Pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë të të ndjerit F. L., pasuria e mësipërme është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve F. L., Françeskina Lekani dhe G. L. me 1/3 pjesë secili, e më pas është shitur në datën 1.8.2017 me çmim 733.050 lekë¹⁸.

2.4. Sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar nga hetimi.

2.5. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

3. Apartament me sipërfaqe 47 m², në vlerën 600.000 lekë, në Shkodër, në bashkëpronësi

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sipërfaqe 47 m², ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Shkodër. Ky apartament ndodhet në lagjen “***”, rruga: “***”. Vlera 600.000 lekë. Pjesa 33,3%”. Si burim krijimi deklaror: “I trashëguar nga i ndjeri, babai im F. L. Ky apartament është blerë nga i ndjeri, babai im F. L. Kontrata e shitblerjes datë 23.1.2004 nga paratë e dërguara nga djali i tij F. L., emigrant në Itali”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁹.

3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 (të administruar edhe nga ASHK Shkodër²⁰), rezulton se sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 23.1.2004, shtetasi F. L. ka blerë nga shtetasi R. O.(O.) e N. O. (O.) pasurinë apartament banimi me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Shkodër, me sip. 47 m², në vlerën 600.000 lekë. Në kontratë pasqyrohet se kjo shumë i është dorëzuar shitësve nga ana e blerësit jashtë zyrës noteriale. Pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit F. L. pasuria e mësipërme është regjistruar në ASHK në bashkëpronësi

¹⁶ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 14.11.2016, bashkë me kartelën e regjistrimit; certifikatë për vërtetim pronësie datë 24.2.2003; certifikatë për vërtetim pronësie datë 22.8.2002; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 1.2.2003.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2017, e ZVRPP-së Shkodër, administruar nga ILDKPKI-ja.

¹⁸ Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme tokë arë, me nr. ***, datë 1.8.2017, administruar nga noter L. H., me blerës shtetasi Gj. B., kundrejt çmimit të shitjes 733.050 lekë. BKT-ja konfirmon se shuma e mësipërme ka kaluar në datën 25.10.2017 nga noteri në llogarinë e përbashkët të shtetasve G., Françeskina e F. Lekani.

¹⁹ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 24.2.2004; kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme apartament nr. ***, datë 23.1.2004.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2017, administruar nga ILDKPKI-ja.

të shtetasve G. L., F. L. dhe Françeskina Lekani, ku në certifikatën për vërtetim pronësie të datës 15.11.2016 pasqyrohet me 1/3 pjesë secili.

3.3. Mbetet i paqartë fakti që subjekti i rivlerësimit figuron si bashkëpronare me 1/3 pjesë të pasurisë, në kushtet kur në kohën kur është blerë pasuria e mësipërme babai i saj figuron i martuar dhe sipas Kodit të Familjes²¹ nëna e subjektit prezumohet që gëzon 1/2 e pasurisë dhe pjesa e trashëgimlënësit pjesëtohet ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë me 1/3 pjesë secili. Në këtë kuptim, subjektit të rivlerësimit i takon 1/3 e 1/2 pjesë e babait të saj, përkatësisht 1/6 pjesë.

3.4. Në procesverbalet e datave 25.5.2021 dhe 4.6.2021, të ILDKPKI-së²², subjekti ka deklaruar: “...vëllai ka ardhur gjithmonë në Shqipëri në muajin gusht për pushime dhe lekët i ka sjellë gjithmonë dorazi. Vëllai im është emigrant në Itali prej vitit 1992... ku është i punësuar në ndërtim që prej atij viti”.

3.5. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 se babai i saj e ka blerë apartamentin e mësipërm me paratë e dërguara nga djali i tij F. L., Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²³, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegonte arsyet se përse apartamenti i mësipërm nuk ka kaluar në pronësi të vëllait të saj F. L., duke qenë se, referuar deklarimeve të saj në ILDKPKI, vëllai saj ka ardhur gjithmonë në Shqipëri në muajin gusht për pushime. Në përgjigje²⁴, subjekti i rivlerësimit shpjegon se arsyeja e mosregjistrimit të pasurive vetëm në emër të vëllait, përveçse çështje ligji, ka qenë edhe çështje vullneti e vëllait, për shkak të mentalitetit, për të mos u paragjykuar nga të tjerët se kaloi tërë pasurinë në emër të vet, nisur nga fakti se subjekti nuk është martuar dhe nëna mbetet e vetme. Më tej, sqaron se nuk kanë pasur kurrë konflikte pronësie me njëri-tjetrin dhe kanë marrëdhënie të shëndosha, dhe dihet që, jo vetëm kjo pasuri, por edhe pasuritë e tjera, në të ardhmen do t'i kalojnë vëllait dhe fëmijëve të tij. Pavarësisht kësaj, shpjegon subjekti, ka kërkuar të heqë dorë nga trashëgimia e babait të kjo pjesë pasurie, por ka qenë këmbëngulja dhe kërkesa e vëllait që pasuria të regjistrohej në emër të të tretëve.

3.6. Nga dokumentacioni i administruar nga noterja B. T.²⁵ rezulton se shtetasit F. dhe F. L.(vëllai i subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij) me anë të prokurës nr. ***, datë 30.8.2016, i kanë dhënë të drejtën subjektit të rivlerësimit për të nënshkruar aktin e heqjes dorë nga pronësia apo aktin e dhurimit të pasurisë së përfituar nga trashëgimia e të ndjerit F. L.. Në këto kushte, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²⁶, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit nëse ajo dhe nëna e saj/G. L. kanë nënshkruar ndonjë kontratë dhurimi, me objekt dhurimin e pjesës takuese të shtetasve F. dhe F. M. nga pasuritë e trashëguara nga i ndjeri F. L. në favor të nënës/G. L.. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me arsyet që vëllai i saj ka shprehur vullnetin për t'i dhuruar nënës së tij të gjitha pjesët takuese të pasurive të përfituara nga trashëgimia e babait, ndërkohë që, sipas deklarimeve të saj, ai ka qenë kontribuuesi i vetëm në blerjen e tyre.

²¹ Neni 76: “Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak”.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

²³ Email datë 20.9.2023.

²⁴ Email datë 28.9.2023.

²⁵ Me anë të së cilës shtetasit F. dhe F. L., ndër të tjera, i japin të drejtën subjektit të rivlerësimit: “[...] Të paraqitet në zyrat noteriale për të nënshkruar aktin e heqjes dorë nga pronësia apo aktin e dhurimit të pasurisë së përfituar nga trashëgimia e të ndjerit babait tim, duke nënshkruar në emrin tonë, ku ne, të përfaqësuarit F. L. dhe F. M., jemi në cilësinë e palës dhuruese të të gjithë pronave (për pjesën takuese), që vijnë si trashëgim nga i ndjeri F. L. me palë pranuese të dhurimit... nënën time G. L. [...]”.

²⁶ Email datë 20.9.2023.

3.7. Në përgjigje²⁷, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka bërë ndonjë veprim me tagrat që i janë dhënë me këtë prokurë, si dhe shpjegoi se vëllai i saj e ka shprehur këtë vullnet rreth një muaj pas vdekjes së babait, me idenë që prona të regjistrohej në emër të nënës së tyre, për shkak se ai vetë nuk kishte mundësi të vinte shpesh në Shqipëri dhe të merrej me regjistrimin e pronave të trashëguara. Në vijim, shpjegon se mes tyre nuk ka pasur kurrë konflikte pronësie dhe për ta ishte e njëjta gjë, si të regjistroheshin në emër të vëllait apo të nënës.

3.8. Në vijim, Komisioni verifikoi të dhënat për vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë të banesave për vitin 2004²⁸ dhe rezultoi se çmimi për metër katror në qytetin e Shkodrës ishte 45.053 lekë. Për pasojë, vlera totale e apartamentit përlllogaritet 2.117.491 lekë²⁹.

3.9. Në rastin konkret, rezultoi se vlera e çmimit të shitjes të pasqyruar në kontratën nr. ***, datë 23.1.2004, në vlerën 600.000 lekë, është anomalisht më e ulët se ai i tregut dhe, për rrjedhojë, ky çmim është jo real.

3.10. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit të deklarojë çmimin real të blerjes së apartamentit. Në përgjigje³⁰, subjekti i rivlerësimit deklaroi se çmimi i blerjes është ai i vendosur në kontratë, i cili është vendosur me dëshirën e shitësve.

3.11. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit R. O.(O.) e N. O. (O.) dhe nuk rezultoi që të ishte në kushtet e konfliktit të interesit³¹.

3.12. Me anë të pyetësorit nr. 2³², Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të dhëna lidhur me kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë, si dhe të deklarojë nëse ky apartament është përdorur për jetesë apo për të gjeneruar të ardhura. Në përgjigje³³, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Kontrata e energjisë elektrike nr. ***, që i përket apartamentit me sipërfaqe 47 m², është lidhur në emër të babait tim F.L.... Në datën 20.2.2021 është bërë ndryshimi i kontratës nga emri i babait tim në emrin e vëllait tim F. L. Kontrata e furnizimit me ujë lidhur me këtë apartament... është lidhur në emër të vëllait tim F. L. në muajin prill të vitit 2018”*. Më tej, sqaron se pas vitit 2022 kjo banesë i është dhënë të afërmit të tyre, shtetasit M. L., për të jetuar, pa shpërblim apo qira, dhe se nuk është lidhur kontratë qiraje, por verbalisht është rënë dakord që ky shtetas do të paguante vetëm detyrimet e energjisë elektrike/ujësjesit dhe do ta lëshonte banesën në momentin që ajo do të shitej. Gjithashtu, sqaron që kjo banesë është nxjerrë në shitje nga vëllai i saj. Për vërtetimin e deklarimeve ka vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës³⁴.

3.13. Referuar fakteve të mësipërme, Komisioni vëren se: (i) në momentin e blerjes së kësaj pasurie, subjekti ka qenë në kushtet e jetesës së përbashkët faktike me babain e saj (blerësin)³⁵; (ii) figuron në certifikatë familjare me babain e saj; (iii) vëllai i subjektit/F. L. është me banim

²⁷ Email datë 28.9.2023.

²⁸ Udhëzim nr. 1, datë 4.3.2004, i Këshillit të Ministrave.

²⁹ Përlllogarit 47 m² x 45.053 lekë.

³⁰ Email datë 28.9.2023.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

³² Email datë 6.10.2023.

³³ Email datë 11.10.2023.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2023, e OSSH-së; procesverbal i datës 9.10.2023, i OSSH-së; printim nga sistemi elektronik i OSSH-së për kontratën nr. *** bashkë me listën e faturimeve; formular i kërkesës për ndryshim kontrate datë 20.2.2021; certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. ***, z. k. ***, f. ***; shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2023, e UK Shkodër, bashkë me listën e faturimeve.

³⁵ Sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorin standard.

në Itali që prej vitit 1992³⁶ dhe kjo pasuri nuk ka kaluar asnjëherë në pronësi të tij, megjithëse ishte kontribuues i vetëm i krijimit të saj; (iv) pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë të babait të saj, subjekti figuron bashkëpronare në 1/3 e kësaj pasurisë; (v) çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes së apartamentit është joreal.

3.14. Sa më sipër, Komisioni, për të shteruar çdo dyshim lidhur me krijimin e kësaj pasurie, bazuar në nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, hetoi lidhur me mundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit/F. L. për blerjen e këtij apartamenti, në datën 23.1.2004.

Analiza e burimit financiar të krijimit

3.15. Komisioni vëren se të ardhurat e vëllait të subjektit/F. L. janë deklaruar nga subjekti si burim për tri pasuri³⁷ të regjistruara në emër të babait (nga të cilat subjekti ka përfituar 1/3 me anë të trashëgimisë), midis të cilave edhe për apartamentin me sip. 47 m².

3.16. Bashkëlidhur procesverbaleve të datave 25.5.2021 dhe 4.6.2021, të ILDKPKI-së³⁸, ndodhet dokumenti “*Estratto Conto Previdenziale*”, i datës 2.2.2021, në emër të vëllait të subjektit/F. L., ku pasqyrohen të ardhurat e tij bruto që prej datës 1.7.1996.

3.17. Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacion lidhur me të ardhurat neto të vëllait të saj, si dhe i kërkoi që ky dokumentacion të jetë sipas formës së kërkuar ligjore. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentin “*Estratto Conto Previdenziale*”, datë 14.3.2023, me vulë apostile. Komisioni vëren se dokumentacioni i paraqitur nuk përmban informacion mbi të ardhurat neto, por vetëm mbi ato bruto.

3.18. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën shtator 2001 – dhjetor 2003³⁹ lidhur me mundësitë e vëllait të subjektit për blerjen e apartamentit me sip. 47 m² në vitin 2004 (periudha e mëparshme është trajtuar në paragrafin 4.16). Duke marrë në konsideratë⁴⁰ se ky shtetas ka në përbërje familjare bashkëshorten dhe tri vajzat⁴¹, Komisioni përlloraritit shpenzimet e jetesës për familje me tri fëmijë⁴². Sa më sipër, Komisioni pasqyroj në analizën financiare: (i) të ardhurat bruto në shumën 34.577 euro; (ii) shpenzimet e jetesës⁴³ në shumën 43.984 euro, sipas tabelës vijuese:

Tabela nr. 1 – Analiza financiare e vëllait për periudhën shkurt 2001 – dhjetor 2003

Periudha	Të ardhura bruto	Shpenzime vjetore të familjes
Shtator – dhjetor 2001	3,864 €	5,460 € ⁴⁴

³⁶ Deklarimi i subjektit në procesverbalet e datave 25.5.2021 dhe 4.6.2021, të ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2023, e DPPSH-së (TIMS i shtetasit F. L.).

³⁷ Apartamenti me sip. 74 m²; apartamenti me sip. 47 m²; për shumën 900.000 lekë, të depozituar nga nëna e saj në vitin 2017.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

³⁹ Analiza financiare për periudhën e mëparshme është paraqitur në tabelën nr. 2.

⁴⁰ Sipas të dhënave të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2023.

⁴¹ I. L., e datëlindjes 11.11.1994, F. L., e datëlindjes 13.10.1998, F. L., e datëlindjes 24.2.2001.

⁴² Vajza F. L. ka lindur në datën 24.2.2001.

⁴³ Në mungesë të të dhënave për vitet 2002 dhe 2003 u konsiderua mesatarja e të dhënave për vitin 2001 (viti paraardhës për të cilin disponohen të dhëna) dhe vitin 2004 (viti pasardhës për të cilin disponohen të dhëna). https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_7666058/default/table?lang=en

⁴⁴ Në kushtet që në faqen zyrtare të Eurostat-it nuk ka statistika për një familje me 3 fëmijë, shpenzimet e jetesës u përlloraritit si shumatore e: (i) shpenzimeve të jetesës së një familjeje me 2 fëmijë – vlera 4.368 euro – e llogaritur në mënyrë përpjesëtimore për 4 muajt e shpenzimeve vjetore për një familje me 2 fëmijë (13.104 euro x 4/12 muajt); (ii) shpenzimeve të jetesës për një person (fëmija i tretë) – vlera 1.092 euro – e llogaritur në mënyrë përpjesëtimore për 4 muajt e shpenzimeve vjetore për një person (13.104 euro/4 persona x 4/12 muajt).

2002	14,311 €	19,262 € ⁴⁵
2003	16,402 €	19,262 €
TOTAL	34,577 €	43,984 €
Diferenca (të ardhura-shpenzime)		-9,407 €

3.19. Sa më lart, Komisioni konstaton se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L. nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për blerjen e apartamentit me sip. 47 m², në datën 23.1.2004.

3.20. Në kushtet kur problematikat e konstatuara për këtë pasuri janë të njëjta me konstatimet e pasurisë apartament me sip. 74 m², të trajtuar në vijim në pikën 4, konkluzioni lidhur me këtë pasuri është pasqyruar i përbashkët në përfundim të analizës së apartamentit me sip. 74 m².

4. Apartament me sipërfaqe 74 m² në Shkodër, në bashkëpronësi

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament me sip. 74 m², ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Shkodër. Ky apartament ndodhet në lagjen “***”, rruga “***”, vlera 150.000 lekë. Me pjesë 33,3%*”. Si burim krijimi deklaroi: “*I trashëguar nga i ndjeri, babai im F. L. ...me paratë e dërguara nga djali i tij F. L., emigrant në Itali*”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁴⁶.

4.2. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, administruar edhe nga ASHK Shkodër⁴⁷, rezulton se sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2001, shtetasi F. L. ka blerë nga shtetasit Sh. H., B. H. e K. H. apartamentin me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me sip. 47 m², z. k. ***, si dhe apartamentin me nr. pasurie ****⁴⁸, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 27 m², i ndodhur në rrugën “****”, p. ***. Në kontratë parashikohet se çmimi i shitjes është në vlerën 150.000 lekë, e cila i është dorëzuar shitësve në dorë. Pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit F. L., pasuria e mësipërme është regjistruar në ASHK në bashkëpronësi të shtetasve G. L., F. L. dhe Françeskina Lekani, ku në certifikatën për vërtetim pronësie të datës 15.11.2016 pasqyrohet me 1/3 pjesë secili.

4.3. Është i paqartë fakti që subjekti figuron si bashkëpronare me 1/3 pjesë të pasurisë në kushtet kur në kohën kur është blerë pasuria e mësipërme babai i subjektit figuron i martuar e, për pasojë, sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi⁴⁹ bashkëshortja e tij prezumohet që gëzon 1/2 e pasurisë dhe pjesa e trashëgimlënësit pjesëtohet ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë me 1/3 pjesë secili. Në këtë kuptim, subjektit të rivlerësimit i takon 1/3 e 1/2 pjesë e babait të saj, përkatësisht 1/6 pjesë.

4.4. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 se babai i saj e ka blerë apartamentin e mësipërm me paratë e dërguara nga djali i tij F. L., Komisioni, me

⁴⁵ Në kushtet që në faqen zyrtare të Eurostat-it nuk ka statistika për një familje me 3 fëmijë, shpenzimet e jetesës u përlogaritën si shumatore e: (i) shpenzimeve të jetesës së një familjeje me 2 fëmijë – vlera 15.410 euro; (ii) shpenzimeve të jetesës për një person (fëmija i tretë) – vlera 3.853 euro – e llogaritur si 1/4 e shpenzimeve të jetesës së një familjeje me 2 fëmijë (15.410 euro/4 persona).

⁴⁶ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 19.9.2001; kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme dy apartamente banimi, nr. ***, datë 15.9.2001; kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 11.9.2001.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2017, administruar nga ILDKPKI-ja.

⁴⁸ Shtetasi Sh. H. pasurinë nr. *** e ka blerë me kontratën nr. ***, datë 11.9.2001, në vlerën 100.000 lekë, nga shtetasja L. M.

⁴⁹ Në kushtet kur pasuria është fituar para hyrjes në fuqi të Kodit aktual të Familjes të vitit 2003, gjejnë zbatim dispozitat e Kodit Civil, viti 1981. Neni 86 i Kodit Civil, viti 1981: “*Sendet, depozitat në arkat e kursimit dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës janë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve...*”. Neni 87: “*3.Pjesa e secilit bashkëshort caktohet duke u nisur nga barazia e pjesëve*”.

anë të pyetësorit nr. 1⁵⁰, i kërkoi të shpjegonte arsyet se përse apartamenti i mësipërm nuk ka kaluar në pronësi të vëllait të saj F. L., duke qenë se – referuar deklarimeve të saj në procesverbalin e datës 25.5.2021 të ILDKPKI-së⁵¹ – vëllai i saj ka ardhur gjithmonë në Shqipëri në muajin gusht për pushime. Në përgjigje⁵² dhe për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime, sikurse janë pasqyruar më lart në paragrafin 3.5 të vendimit.

4.5. Më tej, Komisioni verifikoi të dhënat për vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë të banesave për vitin 2001⁵³ dhe rezulton se çmimi për metër katror në qytetin e Shkodrës ka qenë 38.087 lekë. Për pasojë, vlera e tregut për këtë apartament përlllogaritet në shumën 2.818.438 lekë⁵⁴.

4.6. Në këto kushte, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit të deklarojë çmimin real të blerjes së apartamentit. Në përgjigje⁵⁵, subjekti i rivlerësimit deklaroi se çmimi i blerjes është ai i vendosur në kontratë, i cili është vendosur me dëshirën e shitësve.

4.7. Komisioni konstaton se vlera e çmimit të shitjes të pasqyruar në kontratën nr. ***, datë 15.9.2001, është anomalisht më i ulët se ai i tregut e, për rrjedhojë, çmimi prej 150.000 lekësh duket joreal.

4.8. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit Sh. H., B. H. e K. H. dhe nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit⁵⁶.

4.9. Nga analizimi i deklarimeve në DIPP-të vjetore dhe në pyetësorë, subjekti ka jetuar në këtë apartament që prej vitit 2001⁵⁷ (trajtuar në seksionin e adresave të banimit, në pikën 13 të vendimit), pra që nga momenti i blerjes së kësaj pasurie.

4.10. Lidhur me mobilimin e këtij apartamenti, në procesverbalin e datës 25.5.2021 të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *“Nuk kam bërë shpenzime për arredimin e apartamentit, pasi apartamenti është bosh”*, ndërkohë që nga hetimi rezultoi se subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament që prej vitit 2001.

4.11. Sa më lart, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁵⁸, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cila shpjegon se mobilimi për këtë apartament është modest, i bërë vite më parë nga babai dhe nga e gjithë familja. Më tej, sqaron se deklarimi i saj që ky apartament është bosh është bërë për arsye se mobilimin dhe pajisjet shtëpiake i ka dërguar tek banesa tjetër, në adresën Gjuhadol, ku jeton aktualisht me nënën.

4.12. Në kushtet që subjekti nuk përcaktoi shumën e shpenzuar për mobilim, Komisioni – në kushtet e mungesës së referencave ligjore për përcaktimin e një vlere për këtë lloj shpenzimi – nuk e paraqiti këtë zë me vlerë specifike në analizën financiare, por pesha e kësaj çështjeje do të konsiderohet gjatë analizës së përgjithshme përfundimtare të fakteve dhe rrethanave.

⁵⁰ Email datë 20.9.2023.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

⁵² Email datë 28.9.2023.

⁵³ Udhëzim nr. 5, datë 31.5.2001, i Këshillit të Ministrave.

⁵⁴ 74 m² x 38.087 lekë.

⁵⁵ Email datë 28.9.2023.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2023, e Prokurorisë së Rrethit Shkodër.

⁵⁷ Në DIPP-të e viteve 2003 – 2017 e ka deklaruar si adresë banimi/regjistrimi në gjendjen civile: *Lagjja “***”, rruga “***”, p. ****, Shkodër. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga viti 2001 e në vazhdim ka jetuar tek banesa e vëllait të saj, të blerë sipas kontratës shitblerjes nr. ***.

⁵⁸ Email datë 20.9.2023.

4.13. FSHU-ja⁵⁹ informon se me gjeneralitetet F. L. identifikohet një abonent në Shkodër me kontratën e furnizimit nr. ***, lidhur në datën 22.10.2003, në adresën “****”, e cila, sipas deklaramit të subjektit⁶⁰, i përket banesës në rrugën “****”, ndërtesa ***, hyrja ***, apartamenti ***. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁶¹, subjekti sqaroi se pas vdekjes së babait kjo kontratë është ndryshuar në emrin e vëllait F. L. në datën 20.2.2021, si dhe paraqiti dokumentacionin provues⁶² (dokumentacion i cili është administruar edhe nga FSHU-ja⁶³).

4.14. Komisioni vëren se: (i) subjekti ka banuar në këtë apartament që nga momenti i blerjes së kësaj pasurie; (ii) në momentin e blerjes së kësaj pasurie, subjekti ka qenë në kushtet e jetesës së përbashkët faktike me babain e saj (blerësin)⁶⁴; (iii) në momentin e porositjes së kësaj pasurie, subjekti figuronte në certifikatë familjare me babain e saj; (iv) vëllai i subjektit/F. L. është me banim në Itali që prej vitit 1992⁶⁵ dhe kjo pasuri nuk ka kaluar asnjëherë në pronësi të tij, megjithëse ishte kontribuues i vetëm i krijimit të saj; (v) pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë të babait të saj subjekti figuron bashkëpronare në 1/3 e pasurisë së mësipërme; (vi) çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes së apartamentit është joreal.

4.15. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktet e mësipërme dhe marrëdhënien e subjektit mbi këtë pasuri, Komisioni, për të shtuar çdo dyshim lidhur me krijimin e kësaj pasurie, bazuar në nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016⁶⁶, hetoi lidhur me mundësitë financiare të vëllait të subjektit/F. L. për blerjen e apartamentit me sip. 74 m², në datën 15.9.2001.

Analiza e burimit financiar të krijimit

4.16. Nga analizimi i dokumentacionit⁶⁷ lidhur me të ardhurat e shtetasit F. L., Komisioni kreu analizën financiare për periudhën korrik 1996 – gusht 2001 në lidhje me mundësinë e blerjes së apartamentit me sip. 74 m² në vitin 2001. Referuar dokumentacionit të administruar nga hetimi⁶⁸, rezulton se ky shtetas ka në përbërje familjare bashkëshorten dhe tri vajzat⁶⁹ e, për rrjedhojë, Komisioni përllogariti shpenzimet e jetesës për periudhën korrik 1996 – shkurt 2001 për një familje me dy fëmijë dhe mars 2001 – gusht 2001 për një familje me tre fëmijë⁷⁰. Sa më sipër, Komisioni pasqyroi në analizën financiare: (i) të ardhurat bruto në shumën 26.917 euro; (ii) shpenzimet e jetesës⁷¹ në shumën 61.222 euro, sipas tabelës vijuese:

⁵⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 16.2.2021.

⁶⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

⁶¹ Email datë 11.10.2023.

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2023, e OSSH-së; procesverbal datë 9.10.2023, i OSSH-së; printim nga sistemi elektronik i OSSH-së për kontratën nr. *** bashkë me listën e faturimeve; formular i kërkesës për ndryshim kontrate, datë 20.2.2021; certifikatë për vërtetim pronësi për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2023.

⁶⁴ Sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard.

⁶⁵ Deklarimi i subjektit në procesverbalet e datave 25.5.2021 dhe 4.6.2021, të ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2023, e DPPSH-së (TIMS i shtetasit F. L.).

⁶⁶ Që autorizojnë organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit e kontrollit të pasurisë çdo situatë, fakt apo cilësi, në funksion të realizimit të qëllimit të këtij procesi, autorizim i cili jo detyrimisht lidhet me cilësimin e personave të tretë si persona të tjerë të lidhur (vendimi nr. 9, datë 26.6.2020 (JR), pg. 13.7 i Kolegjit).

⁶⁷ Të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalet e datave 25.5.2021 dhe 4.6.2021, të ILDKPKI-së dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

⁶⁸ Sipas të dhënave të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2023.

⁶⁹ I. L., e datëlindjes 11.11.1994, F. L., e datëlindjes 13.10.1998, F. L., e datëlindjes 24.2.2001.

⁷⁰ Vajza F. L. ka lindur në datën 24.2.2001.

⁷¹ https://ec.***/databrowser/view/ILC_LI01_custom_7666058/default/table?lang=en

Tabela nr. 2 – Analiza financiare e vëllait për periudhën korrik 1996 – gusht 2001

Periudha	Të ardhura bruto	Shpenzime vjetore të familjes
Korrik – dhjetor 1996	2,968 €	4,633 € ⁷²
1997	6,692 €	10,452 €
1998	3,406 €	11,162 €
1999	0 €	11,768 €
2000	6,124 €	12,560 €
Janar – gusht 2001	7,728 €	10,647 € ⁷³
Total	26,917 €	61,222 €
Diferenca (të ardhura-shpenzime)		-34,304 €

4.17. Sa më lart, Komisioni konstaton se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L. nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për blerjen e apartamentit me sip. 74 m², në datën 15.9.2001.

4.18. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pasuritë apartament me sip. 47 m² dhe apartament me sip. 74 m², Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për konstatimin: *Ka dyshime mbi vërtetësinë e deklaramit të subjektit se ajo është bashkëpronare me nënën dhe vëllain e saj në pasuritë apartament me sip. 47 m² dhe sip. 74 m², duke u përpjekur të paraqesë rrethana të rreme, të cilat tentojnë të shmangin nga kontrolli një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë së plotë për këto pasuri, pasi: (i) Subjekti ka banuar në këto apartamente që nga momenti i blerjes së pasurisë (në kushtet kur subjekti ka deklaruar se apartamentet janë ngjitur dhe kanë pasur derë komunikuese⁷⁴); (ii) Subjekti figuron bashkëpronare në 1/3 e kësaj pasurie, ndërkohë që sipas dispozitave ligjore në fuqi duhej të figuronte me 1/6 pjesë; (iii) Pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë të babait të saj, subjekti figuron bashkëpronare në 1/3 e këtyre pasurive, ndërkohë që, sipas deklaramit, kontribuues i vetëm në blerjen e tyre është vëllai i subjektit; (iv) Nuk duket bindës shpjegimi i subjektit mbi arsyet e mosregjistrimit të këtyre pasurive në emër të vëllait, në kushtet që, sipas deklaramit, ai është kontribuues i vetëm në blerjen e tyre; (v) Të ardhurat e ligjshme të vëllait të subjektit nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës për familjen e tij dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie; (vi) Duket e dyshimtë blerja nga ana e vëllait të subjektit të disa pasurive të paluajtshme në Shkodër, pasuri të cilat as nuk përdoren nga ana e tij dhe as nuk gjenerojnë të ardhura; (vii) Në momentin e blerjes së kësaj pasurie, subjekti figuron në certifikatë familjare me babain e saj (blerësi i kësaj pasurie) dhe jetonte faktikisht me të.*

4.19. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁷⁵, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime:

*- Lidhur me konstatimin se mbetet i paqartë fakti që subjekti figuron si bashkëpronar me 1/3 pjesë të pasurisë, ndërkohë që i takon 1/6 pjesë, sqaron se: “Në aktin noterial nr. *** është*

⁷² E llogaritur në mënyrë përpjesëtimore për 6 muaj e shpenzimeve vjetore për një familje me dy fëmijë (9.265 euro x 6/12 muaj)

⁷³ Në kushtet që në faqen zyrtare të Eurostat-it nuk ka statistika për një familje me 3 fëmijë, shpenzimet e jetesës u përllogaritën si shumatore e: (i) shpenzimeve të jetesës së një familje me dy fëmijë – vlera 8.736 euro – e llogaritur në mënyrë përpjesëtimore për 8 muaj (janar – gusht) e shpenzimeve vjetore për një familje me dy fëmijë (13.104 euro x 8/12 muaj); (ii) shpenzimeve të jetesës për një person (fëmija i tretë) – vlera 1.911 euro – e llogaritur në mënyrë përpjesëtimore për 7 muaj (shkurt – gusht) e shpenzimeve vjetore për një person (13.104 euro/4 persona x 7/12 muaj).

⁷⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

⁷⁵ Email datë 22.11.2023.

përcaktuar ndarja e pasurisë në këtë formë dhe nuk ka pasur kontestim as nga vëllai, i cili ishte pronari real, e as nga ne të tjerët". Një fakt të tillë, vijon subjekti i rivlerësimit, e ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*.

- *Për sa i përket konstatimit se nuk duket bindës shpjegimi lidhur me arsyet e mosregjistrimit të këtyre pasurive në emër të vëllait, sqaron se shpjegimin e ka dhënë në pyetësorin e mëparshëm, duke përsëritur shpjegimin e dhënë në pyetësorin nr. 1*⁷⁶.

- *Lidhur me konstatimin se të ardhurat e ligjshme të vëllait nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës, sqaron se nga Komisioni nuk është marrë në konsideratë fakti që vëllai dhe bashkëshortja e tij kanë punuar në të zezë, përveç orëve të punës që kanë qenë të siguruar. Po ashtu shteti italian, për familjet kur ligjërisht punon vetëm njëri bashkëshort, jep subvencione për jetesë për çdo fëmijë, si dhe shpërblime të tjera vjetore. Në vijim, sqaron se paga deri në vitin 2002 ka qenë me lireta dhe kanë qenë paga shumë të mira. Fakte të tilla, vijon subjekti i rivlerësimit, është e pamundur t'i provojë, pasi si bankat apo institucionet e tjera nuk japin informacion. Për të provuar këtë deklarinim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë me shkrim dore, të fotokopjuar, të vëllait të saj F. L., i cili konfirmon deklarinimet e mësipërme. Më pas, shpjegon se vëllai i saj nuk mund të konsiderohet person i lidhur sipas ligjit nr. 84/2016, neni 3, pika 13 dhe, referuar edhe praktikës së Komisionit dhe të Kolegjit, nuk mund të ngarkohet me barrë prove për të vërtetuar faktin se vëllai ka pasur apo jo mundësi financiare për të bërë investimet në Shqipëri.*

- *Për sa i përket konstatimit se vëllai ka blerë pasuri në Shkodër, të cilat nuk përdoren prej tij dhe nga të cilat nuk gjenerohen të ardhura, sqaron se i vëllai i përdor këto pasuri sa herë që vjen në Shqipëri dhe këto pasuri i ka blerë si investim për fëmijët e tij dhe rehatinë e prindërve, me qëllim që në një të ardhme të vijë edhe vetë në Shqipëri dhe nuk ka pasur asnjëherë qëllim që të nxjerrë përfitim nga këto pasuri.*

- *Lidhur me konstatimin se në kohën e blerjes së këtyre pasurive ka qenë në certifikatë familjare me babain e saj dhe jetonte faktikisht me të, sqaron se ky fakt nuk është i vërtetë, pasi, bazuar në certifikatën familjare elektronike nr. ***, është shkëputur nga trangu familjar në datën 10.3.1992 dhe ka kaluar në Bashkinë Shkodër.*

- *Lidhur me aludimet se pasuritë e blera nga vëllai i saj në vitet 2001 dhe 2004 me të ardhura të emigracionit, të regjistruara në emër të babait të saj, janë pasuri të fshehura të saj, sqaron se nga ana e saj nuk ka qenë e nevojshme të bëjë një lëvizje të tillë, pasi në periudhën në fjalë, nga viti 1993 deri në vitin 2001, babai i saj ka gjeneruar të ardhura nga prodhimet e tokës bujqësore me sipërfaqe 5.5 dynym në fshatin ***, në vlerën 4.547.072 lekë dhe nga viti 2002 deri në vitin 2004 në vlerën 757.845 lekë. Më tej, shpjegon se babai i saj ka pasur të gjitha mundësitë financiare t'i blejë këto pasuri në emër të tij, por nga ana e saj është deklaruar siç ka qenë situata reale. Bashkëlidhur, ka paraqitur dokumentacionin provues*⁷⁷.

⁷⁶ Duke u shprehur edhe një herë se: "Arsyeja e mosregjistrimit të pasurive vetëm në emër të vëllait, përveçse çështje ligji, ka qenë edhe çështje vullneti e vëllait, për shkak të mentalitetit, për të mos u paragjykuar nga të tjerët se kaloi tërë pasurinë në emër të vet, nisur nga fakti se unë nuk isha e martuar dhe nëna mbetej e vetme. Ne nuk kemi pasur kurrë konflikte pronësie me njëri-tjetrin dhe kemi marrëdhënie shumë të shëndosha, dhe dihet që, jo vetëm kjo pasuri, por edhe pasuritë e tjera në të ardhmen do t'i kalojnë vëllait dhe fëmijëve të tij".

⁷⁷ Certifikatë familjare elektronike (trangu familjar e vitit 1974) nr. ***, datë 20.11.2023; akt vlerësimi nr. *** prot., datë 5.10.202, i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.20. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si më poshtë vijon:

4.21. Lidhur me konstatimin si rrethanë dyshuese të faktit që *subjekti figuron si bashkëpronare me 1/3 pjesë të pasurisë, ndërkohë që sipas dispozitave ligjore i takon 1/6 pjesë*, Komisioni arsyeton se nga hetimi administrativ rezulton se në kontratat e shitblerjes së apartamenteve me sip. 74 m² (datë 15.9.2001) dhe sip. 47 m² (datë 23.1.2004) babai i subjektit/F. L. figuron si blerës i vetëm i këtyre pasurive, pavarësisht se rezultonte i martuar. Më pas regjistrimi i pronësisë në regjistrat publikë i pasurive të mësipërme është bërë vetëm në emrin e tij. Në këto kushte, ASHK ka vijuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit F. L. sipas përmbajtjes së këtij akti, pa marrë në konsideratë që në momentin e blerjes së apartamenteve të mësipërme i ndjeri F. L. figuronte i martuar. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se parregullsia e pasqyruar në kontratat e shitblerjes dhe regjistrimin e aktit të dëshmisë së trashëgimisë, nuk ndikon në vlerësimin e pasurive apartament me sip. 47 m² dhe sip. 74 m².

4.22. Në vijim, për sa i përket konstatimit si rrethanë dyshuese të faktit që *në kohën e blerjes së dy pasurive apartament subjekti ka qenë në certifikatë familjare me babain e saj*, rezulton që subjekti ka paraqitur si provë certifikatën familjare datë 20.11.2023, të ZGJC-së, Njësia Administrative ***, Shkodër, në të cilën pasqyrohet përbërja familjare e shtetasit F. L. në vitin 1974, shënimi i ndarjes nga trangu familjar i F. dhe Françeskina në datën 19.2.1992, si dhe shpërngulja e tyre në Bashkinë Shkodër në datën 10.3.1992. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se rrethana dyshuese e pasqyruar më lart gjatë rezultatit të hetimeve nuk do të merret në konsideratë gjatë vlerësimit.

4.23. Nga hetimi administrativ rezulton se sipas kontratave të shitblerjes babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2001 ka blerë apartamentin me sip. 74 m² në shumën 150.000 lekë dhe në vitin 2004 ka blerë apartamentin me sip. 47 m² në shumën 600.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 si burim të krijimit të këtyre pasurive të ardhurat e vëllai të saj F. L. si emigrant në Itali. Gjithashtu, rezulton se këto pasuri nuk kanë kaluar asnjëherë në pronësi të tij, megjithëse ishte kontribuues i vetëm i krijimit të tyre.

4.24. Nga të dhënat për vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë të banesave për qytetin e Shkodrës, rezulton se për vitin 2001⁷⁸, kur është blerë apartamenti me sip. 74 m², vlera e tregut për këtë pasuri përlllogaritet 2.818.438 lekë⁷⁹ dhe për vitin 2004⁸⁰, kur është blerë apartamenti me sip. 47 m², vlera e tregut për këtë pasuri përlllogaritet në 2.117.491 lekë⁸¹.

4.25. Nga analizimi i fakteve të mësipërme, Komisioni arsyeton se çmimet e pasqyruara në kontratat e shitblerjes jo vetëm që nuk përputhen me vlerën mesatare në tregun e lirë të banesave, por janë jologjike, pasi apartamenti me sip. 74 m² është blerë në vitin 2001 në shumën

⁷⁸ Udhëzimi nr. 5 datë 31.5.2001, i Këshillit të Ministrave.

⁷⁹ 74 m² x 38.087 lekë.

⁸⁰ Udhëzimi nr. 1, datë 4.3.2004, i Këshillit të Ministrave.

⁸¹ Përlllogaritur 47 m² x 45.053 lekë

150.000 lekë, ndërsa apartamenti me sip. 47 m², pas 3 viteve nga blerja e apartamentit të parë, duke pasur një sipërfaqe më të vogël, në të njëjtin pallat, është blerë në shumën 600.000 lekë, ndërkohë që sipas të dhënave të EKB-së⁸² nuk rezulton që çmimet në tregun e lirë të banesave në qytetin e Shkodrës të kenë pësuar ndryshime thelbësore gjatë viteve 2001 – 2004. Për më tepër, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 ka deklaruar se babai i saj në vitin 2004 ka shitur banesën 2 dhoma + kuzhinë + aneks + korridor, në fshatin ***, në vlerën 2.700.000 lekë (trajtuar në vijim në pikën 6 të vendimit).

4.26. Komisioni, duke u bazuar në faktet e mësipërme, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁸³, arrin në përfundimin se çmimet e shitjes të pasqyruara në kontratat e shitblerjes janë joreale, duke e vlerësuar këtë konstatim në tërësi me rrethanat e tjera, që janë përcaktuese në vlerësimin e pasurive apartament të cituara më sipër.

4.27. Në vijim, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka jetuar në apartamentin me sip. 74 m² që nga momenti i blerjes së kësaj pasurie në vitin 2001⁸⁴, apartament i cili ka pasur derë komunikuese me apartamentin me sip. 47 m² të blerë në vitin 2004⁸⁵. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ka bashkëjetuar me prindërit e saj që nga viti 2001⁸⁶ dhe ekonomia e tyre ka qenë e përbashkët⁸⁷.

4.28. Nga analizimi i fakteve të mësipërme, Komisioni vëren se: (i) subjekti i rivlerësimit në momentin e blerjes së pasurive apartament me sip. 74 m² dhe sip. 47 m² ka qenë në kushtet e jetesës së përbashkët faktike me babain e saj (blerësin); (ii) vëllai i subjektit/F. L. është me banim në Itali që prej vitit 1992⁸⁸ dhe këto pasuri nuk kanë kaluar asnjëherë në pronësi të tij, megjithëse ishte kontribuues i vetëm i krijimit të tyre; (iii) çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes së apartamentit është joreal⁸⁹.

4.29. Në këto kushte, Komisioni, nisur edhe nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të pandërprerë me këto apartamente, duke qenë se ka jetuar që nga blerja e tyre e në vijim, për të shteruar çdo dyshim lidhur me krijimin e këtyre pasurive, bazuar në nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016⁹⁰, hetoi lidhur me mundësinë financiare të vëllait të subjektit/F. L. për blerjen e këtyre apartamenteve.

⁸² <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>

⁸³ Kolegji është shprehur se pavarësisht se elementet, të drejtat dhe detyrimet e kontratës së shitjes në tregun e lirë imponohen nga vullneti i palëve kontraktore në përcaktimin e tyre, ky vullnet nuk është i pakufizuar, si në përcaktimin e çmimit dysheme, i cili, për shkak të politikave fiskale, parashikohet në akte nënligjore, po ashtu edhe sa i përket vendosjes së çmimeve që dukshëm tejkalojnë çmimin real të përcaktuar po në akte nënligjore, siç janë edhe ato të parashikuara në udhëzimet dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e vlerës mesatare të shitjes së banesave në tregun e lirë (vendimet nr. 3, datë 6.2.2023 (JR) dhe nr. 13, datë 4.4.2023 (JR), të Kolegjit).

⁸⁴ Në DIPP-të e viteve 2003 – 2017 e ka deklaruar si adresë banimi/regjistrimi në gjendjen civile: *Lagjja “****”, rruga “****”, p. ****, *Shkodër*. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga viti 2001 e në vazhdim ka jetuar tek banesa e vëllait të saj, të blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. ***.

⁸⁵ Në përgjigje të rezultateve të hetimit.

⁸⁶ Në përgjigje të pyetësorit standard.

⁸⁷ Në përgjigje të rezultateve të hetimit.

⁸⁸ Deklarimi i subjektit në procesverbalet e datave 25.5.2021 dhe 4.6.2021, të ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2023, e DPPSH-së (TIMS i shtetasit F. L.).

⁸⁹ Kolegji është shprehur se pavarësisht se elementet, të drejtat dhe detyrimet e kontratës së shitjes në tregun e lirë imponohen nga vullneti i palëve kontraktore në përcaktimin e tyre, ky vullnet nuk është i pakufizuar, si në përcaktimin e çmimit dysheme, i cili, për shkak të politikave fiskale, parashikohet në akte nënligjore, po ashtu edhe sa i përket vendosjes së çmimeve që dukshëm tejkalojnë çmimin real të përcaktuar po në akte nënligjore, siç janë edhe ato të parashikuara në udhëzimet dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e vlerës mesatare të shitjes së banesave në tregun e lirë (vendimet nr. 3, datë 6.2.2023 (JR) dhe nr. 13, datë 4.4.2023 (JR), të Kolegjit).

⁹⁰ Që autorizojnë organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit e kontrollit të pasurisë çdo situatë, fakt apo cilësi, në funksion të realizimit të qëllimit të këtij procesi, autorizim i cili jo detyrimisht lidhet me cilësimin e personave të tretë si persona të tjerë të lidhur.

4.30. *Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vëllai i saj nuk mund të konsiderohet person i lidhur sipas ligjit nr. 84/2016, neni 3, pika 13, dhe nuk mund të ngarkohet me barrë prove për të vërtetuar mundësitë financiare për të bërë investimet në Shqipëri,* Komisioni arsyeton se është i vërtetë fakti që subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i saj nuk ka pasur asnjë marrëdhënie të drejtpërdrejtë interesi të natyrës së huas apo të dhurimit, por në këtë rast, Komisioni, në përputhje me orientimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁹¹, hetoi dhe analizoi të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit/F. L. për të shteruar çdo dyshim lidhur me marrëdhënien e vërtetë që subjekti i rivlerësimit ka me pasuritë e mësipërme.

4.31. *Për sa i përket deklarimit të subjektit se vëllai dhe kunata e saj kanë punuar në të zezë në Itali,* ky pretendim mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar. Megjithatë, edhe nëse do të provoheshin të ardhurat nga ky punësim, ato nuk plotësojnë kriterin e parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e, për pasojë, nuk mund të pasqyrohen në analizën financiare.

4.32. *Lidhur me deklarimin e subjektit se pasuritë e mësipërme nuk janë pasuritë e saj të fshehura, pasi babai i saj ka pasur mundësitë financiare t'i blejë këto pasuri me të ardhurat e gjeneruara nga prodhimet e tokës bujqësore, por nga ana e saj është deklaruar siç ka qenë situata reale,* Komisioni vlerëson se shpjegimi lidhur me të ardhurat e babait subjekti i ka paraqitur për herë të parë në përgjigje të rezultateve të hetimit. Megjithatë, subjekti i rivlerësimit vazhdon të deklarojë si burim të krijimit të tyre të ardhurat e vëllait të saj si emigrant në Itali.

4.33. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova shtesë apo shpjegime bindëse lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L. nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për blerjen e apartamenteve me sip. 74 m² në datën 15.9.2001 dhe me sip. 47 m² në datën 23.1.2004.

4.34. Sa më lart, në kushtet kur: (i) subjekti i rivlerësimit ka përdorur këto apartamente që nga krijimi i tyre deri në kohën e deklarimit në deklaratën *Vetting*, pra ka pasur një marrëdhënie të pandërprerë dhe të qëndrueshme me këto apartamente; (ii) vëllai i subjektit është me banim në Itali që prej vitit 1992 dhe këto pasuri nuk janë përdorur prej tij përveç rasteve të ardhjes në Shqipëri; (iii) këto apartamente nuk kanë kaluar asnjëherë në pronësi të vëllait të saj si kontribuues i vetëm i krijimit të tyre, sikundër pretendon subjekti; (iii) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se vëllai i saj F. L. ka pasur të ardhura të mjaftueshme dhe kursime, të cilat i kanë shërbyer babait të saj për krijimin e dy pasurive apartament të sipërcituara – Komisionit i krijohen dyshime të arsyeshme se pasqyrimi në kontratat e shitblerjes së apartamenteve në cilësinë e blerësit të babait të saj, e më pas deklarimi i subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* 2017 se ky i fundit i ka blerë këto pasuri me paratë e dërguara nga vëllai i saj, janë deklarime të pabesueshme dhe të bëra me qëllim që të shmangej kontrolli i burimit të krijimit të këtyre pasurive.

4.35. Në përfundim, bazuar në analizën e rrethanave të mësipërme, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti i rivlerësimi nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk shpjegoi bindshëm marrëdhënien me këto pasuri, duke u përpjekur të fshehtë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

⁹¹ Vendimet nr. 9, datë 26.6.2020 (JR), nr. 36, datë 27.7.2023, etj., të Kolegjit.

5. Automjet tip “Volkswagen “Golf” në vlerën 5.000 euro

5.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *makinë tip “Golf” me targë **** dhe si burim krijimi deklaroi pagat. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁹².

5.2. DPSHTRR-ja⁹³ konfirmon se sipas kontratës nr. ***, datë 27.12.2012, subjekti ka blerë nga shtetasi E. K. automjetin tip “Volkswagen”, vit prodhimi 2000, në shumën 5.000 euro. Në kontratë pasqyrohet se palët janë likuiduar për këtë shumë. Vetë shitësi, shtetasi E. K., këtë automjet e ka blerë në Zvicër në shumën 800 euro, si dhe ka paguar detyrimet doganore në shumën 34.311 lekë. Sa më sipër, nuk konstatohet që subjekti ta ketë blerë automjetin e mësipërm me çmim preferencial.

5.3. Komisioni hetoi nëse subjekti ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin E. K. dhe rezultoi që subjekti nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit⁹⁴.

5.4. Lidhur me analizën financiare të vitit 2012⁹⁵, Komisioni vëren se gjatë këtij viti është kryer edhe një pagesë kësti për apartamentin në Shkodër⁹⁶, si burim i së cilës – sipas deklarimit të subjektit – kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e banesës në fshatin *** (pasuri e trajtuar në pikën 6 të vendimit).

5.5. Në këto kushte, Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2012, për subjektin e rivlerësimit dhe për prindërit (duke përfshirë këstin e dytë për apartamentin dhe burimin e deklaruar për të⁹⁷), paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 3 – Analiza financiare viti 2012 (vetëm automjetet)⁹⁸

Përshkrimi	Vlera
Automjet tip “Golf”, me targë *** (5.000 euro) ⁹⁹	697,450
Automjet tip “Opel Corsa”, me targë *** (2.500 euro) ¹⁰⁰	349,700
Shtim/pakësim likuiditetesh në bankë ¹⁰¹	-120,972
Total pasuri	926,178
Të ardhura subjekti nga pagat	1,253,970
Të ardhura babai nga pension pleqërie	231,464
Të ardhura nëna nga pension pleqërie	163,874
Të ardhura nga interesat bankarë	29,586
Total të ardhura	1,678,894
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	423,072
Shpenzim shumat e dërguara nga subjekti për vëllain ¹⁰²	260,997
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	16,068
Total shpenzime	700,137
Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)	52,579

⁹² Kontratë shitblerjeje pasuri e luajshme automjet nr. ***, datë 27.12.2012.

⁹³ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

⁹⁵ Automjeti është blerë në datën 27.12.2012.

⁹⁶ Kësti i dytë në vlerën 5.000 euro, datë 10.9.2012.

⁹⁷ Trajtuar në pikën 6 të relacionit.

⁹⁸ Balanca negative vjetore e vitit 2010, e paraqitur në tabelën përfundimtare në vlerën -329.868 lekë, është rezultat i shumës së: (i) balancës pozitive të tabelës nr. 4 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesish (+160.582 lekë) – automjetet; (ii) balancës negative të paraqitur në pikën 6 të relacionit (-490.450 lekë) – kësti i dytë i apartamentit.

⁹⁹ Vlerësuar me kursin e këmbimit, Banka e Shqipërisë, datë 27.12.2012, 1 euro = 139,49 lekë.

¹⁰⁰ Vlerësuar me kursin e këmbimit, Banka e Shqipërisë, datë 5.4.2012, 1 euro = 139,88 lekë.

¹⁰¹ Diferenca e gjendjes së llogarive në datën 31.12.2012 me atë të datës 31.12.2011 (pakësim total në vlerën 320.972 lekë), e paraqitur në analizën përkatëse të secilës pasuri, sipas deklarimit të burimit, konkretisht: (i) pakësimi prej 200.000 lekësh – tërheqjet e kryera përpara datës së pagesës së këstit prej 5.000 euro – paraqitur në pikën 6 të relacionit; (ii) pakësimi prej 120.972 lekësh (diferenca e pakësimit prej 320.972 lekësh me pakësimin prej 200.000 lekësh).

¹⁰² Trajtuar në pikën 9 të vendimit.

5.6. Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë ***, në vlerën 5.000 euro.

5.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i si subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare.

6. Dy apartamente banimi në vlerën 113.000 euro, në Shkodër

6.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar: “*Dy apartamente banimi me sip. 88 m² e 69 m², të paregjistruara, por me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.9.2011, ku porosites është i ndjeri, babai im F. L. Për të cilin ka paguar vetëm një këst...* ”¹⁰³. Si burim krijimi deklaroi: “*Të ardhurat nga shitja e banesës në fshatin ***, Njësia Administrative ***, të cilën e kemi të paregjistruar, por të shitur me një deklaratë, ndërtuar para viteve ‘90, si dhe nga kredia e marrë në BKT*”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁰⁴.

6.2. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 (të administruar edhe nga noter A. K.¹⁰⁵) rezulton se ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit/investitorit, dhe shtetasit F. L., në cilësinë e porositesit, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.9.2011, në të cilën parashikohet se sipërmarrësi ka filluar të ndërtojë një objekt 3 kat + çati, të shfrytëzueshme mbi truallin e ndodhur në Shkodër, lagjja “****”, rruga “****”, në pronësi të shtetasve Sh. D., J. T. e P. K. dhe merr përsipër të ndërtojë për llogari të porositesit një apartament banimi me sipërfaqe ndërtimore 88 m², nr. ***, dhe një apartament banimi me sip. ndërtimore 69 m², nr. ***, të ndodhur në katin e dytë teknik. Në kontratë parashikohet se çmimi për shitjen e këtyre dy apartamenteve do të jetë në vlerën 103.000 euro, kur punimet e brendshme do të bëhen nga vetë porositesit dhe nëse do të bëhen nga sipërmarrësi/investitori çmimi i shitjes do të jetë në shumën 113.000 euro. Në vijim parashikohet se shuma do të paguhet me këste, ku: (a) kësti i parë prej 2.000.000 lekësh është paguar jashtë zyrës me nënshkrimin e kësaj kontrate; (b) kësti i dytë, pjesa e mbetur, do të paguhet sipas marrëveshjes së vetë palëve.

6.3. Në procesverbalin e datës 15.1.2016 të ILDKPKI-së¹⁰⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*...apartamenti me sip. 88 m² është blerë për llogari të vëllait F. L. me banim në Itali nga viti 1993...* ”. Në vijim, në procesverbalin e datës 25.5.2021 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar: “*...apartamentet janë blerë në shumën 100.000 euro... Në lidhje me vlerën e paguar, sqaroj se kemi paguar këstin e parë në shumën 19.000 euro, në vitin 2011... me burim nga shitja e banesës në fshat, e cila është shitur në shumën 2.700.000 lekë. Shuma 2.600.000 lekë është paguar në bankë në BKT nga ana e blerësit në emrin tim dhe të babait tim... shuma e përfituar nga shitja e banesës në fshat dhe ajo e kredisë së marrë, pra rreth 6.100.000 lekë, kanë kaluar për blerjen e apartamenteve, që përbën pjesën time të detyrimit sipas marrëveshjes që kam me vëllain. Diferenca e shumës së mbetur pa shlyer kemi rënë dakord që i takon vëllait ta mbyllë. Gjithsesi, marrëdhënia me firmën nuk është përfunduar, pasi objekti është i papërfunduar plotësisht, pa ashensor e parrmakë, i paregjistruar, për këtë arsye edhe vlera e detyrimit do të zbritet”*.

¹⁰³ Subjekti ka vendosur si vlerë shumën 60.000.000 lekë.

¹⁰⁴ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 7.9.2011; deklaratë me shkrim dore e shtetasit F. L., e datës 25.9.2004; mandat “Depozitim *cash* në lekë”, datë 30.4.2004, i BKT-së; kërkesë për transaksion, datë 9.9.2011, e BKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 13.1.2016, e ZVRPP-së Shkodër; vërtetim nr. *** prot., datë 19.1.2017.

¹⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2023.

¹⁰⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

6.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁰⁷, subjekti i rivlerësimit deklaroi se për blerjen e këtyre dy apartamenteve janë kryer këto pagesa: (i) transferata e kryer në datën 9.9.2011, në vlerën 2.107.500 lekë, me transfertë bankare; (ii) depozitimi *cash* në datën 10.9.2012, në vlerën 500.000 lekë; (iii) në datën 25.4.2013 është miratuar kredia në shumën 3.500.000 lekë, e marrë për blerjen e kësaj banese, e cila ka kaluar nga BKT-ja në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k.

6.5. Subjekti i rivlerësimit paraqiti kopje të depozitimit bankar, në datën 10.9.2012, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. pranë BKT-së¹⁰⁸, ku vërehet se shuma e depozituar është 5.000 euro dhe jo 500.000 lekë, sikundër ka deklaruar subjekti.

6.6. Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve në vitin 2011, në qytetin e Shkodrës, nga ku rezultoi se çmimi për metër katror ka qenë në vlerën 55.300 lekë. Për pasojë, vlera totale e apartamenteve të porositura nga babai i subjektit sipas çmimeve të referencës përlllogaritet 8.682.100 lekë¹⁰⁹. Në këto kushte, çmimi për blerjen e apartamentit të mësipërm nuk rezulton të jetë preferencial.

6.7. Në lidhje me konfirmimin e pagesave dhe detyrimit të mbetur nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, sqaroi se me përfaqësuesit e kësaj shoqërie nuk ka asnjë kontakt, pasi ata kanë vite që janë larguar pa kryer shumicën e punimeve të përbashkëta si ashensor, parrmakë shkallësh etj. Gjithashtu, kjo shoqëri nuk është marrë as me përgatitjen e dokumentacionit ligjor për regjistrimin e banesave e, në këto kushte, nga ana e banorëve është bërë aplikimi tek ALUIZNI për regjistrimin e banesave, të cilat janë regjistruar në emrin e tyre, në bazë të kontratave të sipërmarrjes¹¹⁰. Gjithashtu, shpjegon se disa punime të pakryera, konkretisht dyert e brendshme dhe tualetet, janë kryer prej tyre dhe se nëna e saj jeton në këtë banesë që nga viti 2017, ndërsa ajo që prej vitit 2022, për të mos e lënë nënën e saj vetëm. Subjekti i rivlerësimit paraqiti certifikatën e regjistrimit të pronësisë së këtij apartamenti, si dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme, sipas së cilës pronësia mbi këtë pasuri është fituar me lejen e legalizimit nr. ***, datë 13.10.2021, si dhe dokumentacionin shtesë provues¹¹¹.

6.8. Lidhur me mobilimin/arredimin e këtij apartamenti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹¹², subjekti deklaroi se mobiliet dhe pajisjet shtëpiake janë marrë nga apartamenti me sip. 74 m². Në kushtet që subjekti i rivlerësimit nuk përcaktoi shumën e shpenzuar, Komisioni – për shkak të mungesës së referencave ligjore për përcaktimin e një vlere për këtë lloj shpenzimi – nuk e paraqiti këtë zë me vlerë specifike në analizën financiare, por pesha e kësaj çështjeje do të konsiderohet gjatë analizës së përgjithshme përfundimtare të fakteve dhe rrethanave.

6.9. FSHU-ja¹¹³ informon se me gjeneralitetet G. L. identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. ***, në instancën Shkodër, me adresë lagjja “****”, të lidhur në datën 16.5.2017,

¹⁰⁷ Email datë 20.9.2023.

¹⁰⁸ Lidhur me parashikimin në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.9.2011, se kësti i parë prej 2.000.000 lekësh është paguar jashtë zyrës me nënshkrimin e kësaj kontrate, subjekti shpjegoi se kësti i parë i pagesës është kryer me transfertë bankare në datën 9.9.2011 nga llogaria pranë BKT-së, në emër të subjektit dhe babait, në vlerën 2.107.500 lekë.

¹⁰⁹ Referuar përlllogaritjeve bazuar në sipërfaqen totale, sipas kontratës së sipërmarrjes, 157 m² x 55.300 lekë/m².

¹¹⁰ Përgjigje të pyetësorit nr. 1

¹¹¹ Akt evidencimi nr. ***, datë 12.10.2021, i ASHK-së Shkodër; 2 skica fushore; hartë treguese e pasurisë nr. ***, z. k. ***, datë 15.10.2021; planimetri e katit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2021, e ASHK-së Shkodër; vendim nr. ***, datë 13.10.2021, “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”; shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2021, e Bashkisë Shkodër.

¹¹² Email datë 28.9.2023. Në përgjigje të pyetjes nr. 7, lidhur me arredimin e apartamentit nr. ***, z. k. ***, me sip. 74 m², subjekti shpjegoi arredimin dhe pajisjet shtëpiake i ka dërguar tek shtëpia tjetër, në adresën Gj., ku jeton aktualisht me nënën, adresë e cila përkon me apartamentin e blerë me kontratë porosie.

¹¹³ Shkresa nr. *** prot., datë 16.2.2021

e cila, sipas deklarimit të subjektit¹¹⁴, i përket banesës së re me adresë Gj., hyrja ***, apartamenti ***, pra i përket pikërisht këtij apartamenti.

6.10. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit (të administruar edhe nga Komisioni¹¹⁵) konstatohet se subjekti i rivlerësimit figuron bashkëpronare me 1/3 pjesë të pasurisë. Në kushtet kur pasuria e mësipërme është porositur në vitin 2011 nga babai i subjektit, i cili figuron i martuar, sipas parashikimeve të Kodit të Familjes¹¹⁶, nëna e subjektit prezumohet që gëzon 1/2 e pasurisë e, për pasojë, pjesa e trashëgimlënësit pjesëtohet ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë me 1/3 pjesë secili. Në këtë kuptim, subjektit të rivlerësimit i takon 1/3 e 1/2 pjesë e babait të saj, përkatësisht 1/6 pjesë.

6.11. Gjithashtu, konstatohet se sipas kartelës së pasurisë nr. ***, sipërfaqja totale e këtij apartamenti është 171,3 m², ndërkohë që në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.9.2011, sipërfaqja totale rezulton 154 m² (dy apartamente 88 m² dhe 69 m²).

6.12. Sa më lart, me anë të pyetësorit nr. 2¹¹⁷, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë shumën e shpenzuar dhe vitin në të cilin janë kryer punimet nga ana e saj për këtë apartament, si dhe të shpjegojë mospërputhjen e konstatuar në lidhje me sipërfaqen. Në përgjigje¹¹⁸ subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Diferenca në fjalë ka ardhur për shkak se në momentin që është lidhur kontrata e sipërmarrjes me ndërtuesin, nga ky i fundit është përfshirë në kontratë vetëm sipërfaqja reale e banimit, jo sipërfaqet e përbashkëta. Ndërkohë, kur janë bërë matjet në vend, pasi lidhur me këtë objekt ka pasur problematikë specifike për shkak se sipërmarrësi nuk e ka përfunduar objektin sipas rregullave dhe sipërmarrësi ka depozituar vetëdeklarim/kërkesë për legalizim e, më pas, nga ana jonë si porositës është depozituar kontrata e porosisë, në matjet e bëra janë përfshirë edhe sipërfaqet e përbashkëta. Kjo është arsyeja pse në përfundim në kartelën e pasurisë kanë rezultuar më shumë metër katrorë sesa në kontratën e sipërmarrjes”.*

6.13. Më tej, lidhur me punimet e kryera, subjekti i rivlerësimit deklaroi se vëllai i saj është i specializuar për ndërtime dhe rikonstrukcion banesash dhe gjatë periudhës 2013 – 2017, sa herë që ka ardhur në Shqipëri, ka kryer punimet e nevojshme për montimin e pjesëve hidraulike, të banjës, suvatime etj. dhe shuma e shpenzimeve ka qenë rreth 700.000 lekë, duke konsideruar vetëm koston e materialeve të blera, pasi puna fizike është kryer nga vetë ai. Gjithashtu, shpjegon se në periudhën në fjalë, kryesisht viti 2016, vëllai i saj ka pasur të ardhura në vlerën 33.227 euro. Për vërtetimin e deklarimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë të shtetasit F. L. (me shkrim dore), ku ai konfirmon se shpenzimet dhe punimet janë mbuluar nga ana e tij, dhe disa fatura lidhur me materialet e blera.

6.14. Lidhur me aspektin deklarativ, Komisioni në fazën e hetimit administrativ arriti në përfundimin se: (i) *Deklarimi i subjektit se ka kryer punime të brendshme në vlerën 700.000 lekë nuk e justifikon mosshlyerjen e çmimit të mbetur për blerjen e apartamenteve në vlerën 68.000 euro, për pasojë mbetet i paqartë fakti që nëna e saj, e më pas subjekti, kanë poseduar apartamentet nga viti 2017 e në vijim, pa shlyer pjesën e mbetur të çmimit të blerjes;* (ii) *Deklarimi i subjektit se objekti ishte i papërfunduar dhe disa punime (dyert e brendshme dhe*

¹¹⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

¹¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2023, e ASHK-së Shkodër.

¹¹⁶ Neni 76: *“Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak”.*

¹¹⁷ Email datë 9.10.2023.

¹¹⁸ Email datë 11.10.2023.

banjot) janë kryer prej saj/vëllait dhe jo nga shoqëria “****” sh.p.k., mbetet i paprovuar; (iii) Deklarimi i subjektit se sipërfaqja e regjistruar e apartamentit është më e madhe se sipërfaqja e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2011, për shkak se në këtë të fundit është pasqyruar vetëm sipërfaqja reale e banimit e jo sipërfaqet e përbashkëta, nuk është bindës, pasi në ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, parashikohet se sipërfaqet e përbashkëta regjistrohen të ndara nga sipërfaqet individuale e, për pasojë, sipërfaqja prej 171,3 m², e pasqyruar në certifikatën e pronësisë së subjektit, përfaqëson vetëm sipërfaqen individuale.

6.15. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹⁹, subjekti i rivlerësimit sqaron se mosshlyerja e detyrimeve në total ndaj subjektit ndërtues ka ardhur jo për shkak të mosrealizimit të punimeve të brendshme, por për shkak se ky subjekt i ka pasur të gjitha llogaritë e bllokuara, pasi ka qenë në gjyq me ortakët e tij (konfirmuar kjo me vendimin nr. ***, datë 3.5.2016) për shkak se nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Subjekti i rivlerësimit vijon shpjegimet se: “Nga ana jonë është synuar që pagesa të bëhej nëpërmjet bankës, por meqë llogaritë e tij ishin të bllokuara, nuk kemi pasur mundësi të shlyejmë detyrimin e mbetur dhe aktualisht nuk dimë se cilit subjekt duhet t’ia likuideojmë pjesën e mbetur të detyrimit”.

Lidhur me vlerën 700.000 lekë të shpenzuar për punime të brendshme, subjekti i rivlerësimit, pasi citon kushtet e kontratës së sipërmarrjes¹²⁰, shpjegon se vëllai i saj kishte vite që punonte në ndërtim dhe ishte specialist në këtë fushë e, për këtë shkak, punimet e brendshme janë kryer prej tij, duke ulur koston nga çmimi total i shitjes dhe duke kryer punime më cilësore. Më pas, sqaron se është fakt i njohur që punimet e brendshme nuk janë kryer nga sipërmarrësi, i cili nuk e ka përfunduar as projektin në afat, duke e detyruar që certifikatën e pronësisë ta marrë nëpërmjet procedurës së legalizimit.

Lidhur me diferencën në sipërfaqen e regjistruar, subjekti i rivlerësimit sqaron edhe një herë se diferenca në fjalë ka ardhur për shkak se në momentin që është lidhur kontrata e sipërmarrjes me ndërtuesin, ky i fundit ka përfshirë në kontratë vetëm sipërfaqen reale të banimit, jo sipërfaqet e përbashkëta. Më pas, pasi ka depozituar kërkesën për legalizim, për shkak se sipërmarrësi nuk e ka përfunduar objektin sipas rregullave, në matjet e bëra në vend janë përfshirë edhe sipërfaqet e përbashkëta. Kjo është arsyeja pse në përfundim, në kartelën e pasurisë, kanë rezultuar më shumë metër katrorë sesa në kontratën e sipërmarrjes.

Në lidhje me konfliktin e interesit

6.16. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe ortakët/administratorët e saj Sh. D. dhe A. D..

6.17. Nga dokumentacioni i administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër¹²¹ rezulton se mbi bazën e kallëzimit të bërë nga Zyra e Përmbartimit Shkodër ndaj shoqërisë “****” sh.p.k dhe shtetasit Sh. D. D. është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2022, pa emër personi, për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, e cila është pushuar me vendim të prokurores Françeskina Lekani në datën 30.6.2022.

6.18. Referuar fakteve të pasqyruara më lart, rezulton se: (i) ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe babait të subjektit/shtetasit F. L. është lidhur kontrata e sipërmarrjes datë 7.9.2011 për

¹¹⁹ Email datë 22.11.2023.

¹²⁰ Ku përcaktohet kushti se çmimi i shitjes do të ulej nga 113.000 euro në 103.000 euro nëse punimet do të kryhen nga porositësi.

¹²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2023.

blerjen e dy apartamenteve në vlerën 113.000 euro; (ii) shuma që i është paguar shoqërisë për këtë apartament nga subjekti dhe babai i saj është 6.241.950 lekë¹²²; (iii) pas vdekjes së shtetasit F. L., subjekti rezulton trashëgimtare ligjore e tij, duke gëzuar 1/3 e pjesës së pasurisë; (iv) subjekti ka konfirmuar që marrëdhënia me shoqërinë nuk është përfunduar¹²³.

6.19. Në këto kushte, Komisioni analizoi dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në raport me faktet e mësipërme dhe arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ishte i detyruar të hiqte dorë nga ndjekja dhe marrja e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, me qëllim shmangien e situatës së konfliktit të interesit, duke qenë se mes tij dhe të kallëzuarve ekzistonte marrëdhënia juridiko-civile me karakter pasuror/detyrimi, e cila nuk kishte përfunduar.

6.20. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se *subjekti ka ndjekur procedimin penal nr. ***/2022, e më pas ka marrë vendimin e datës 30.6.2022 për pushimin e këtij procedimi, në kushtet e konfliktit të interesit me të kallëzuarit, shoqërinë “***” sh.p.k. dhe shtetasin Sh. D., pasi mes tyre ekzistonte një marrëdhënie juridiko-civile me karakter pasuror/detyrimi, e cila nuk kishte përfunduar.*

6.21. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²⁴, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga ana e saj nuk është çmuar se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.9.2011, është lidhur me shtetasin A. D., djalin e shtetasit Sh. D.. Në vitin 2017, vijon subjekti i rivlerësimit, kur banesa është marrë në dorëzim, nga ana e saj ka qenë e shlyer plotësisht pjesa takuese e detyrimit dhe në vitet në vijim ka mbetur pa shlyer vetëm detyrimi i vëllait, kjo për shkaqet e cituara më lart (bllokimi i llogarive të shoqërisë ndërtuese). Në këto kushte, në vitin 2022, kur është shortuar materiali kallëzues në fjalë, ka çmuar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ajo personalisht nuk kishte asnjë detyrim të pashlyer ndaj djalit të këtij shtetasi. Më tej shpjegon se vendimi i saj nuk është ankimuar nga pala kallëzuese.

Analizimi i burimeve të krijimit të dy apartamenteve të banimit

6.22. Nga analizimi i deklarimeve dhe provave të administruara, duket se shuma totale e paguar për apartamentet ka qenë 6.241.950 lekë¹²⁵ (rreth 44.500 euro), përkundrejt çmimit 113.000 euro të parashikuar në kontratën e porosisë. Pronësia mbi këtë pasuri është fituar në vitin 2021 me leje legalizimi.

6.23. Komisioni vëren se: (i) në momentin e porositjes së kësaj pasurie subjekti ka qenë në kushtet e jetesës së përbashkët faktike me babain e saj (porositësin)¹²⁶; (ii) subjekti ka kontribuar në pagesat e këtij apartamenti, pasi figuron në cilësinë e kredimarrësit në kontratën

¹²² (i) Datë 9.9.2011, vlera 2.107.500 lekë, transfertë nga BKT-ja në favor të shoqërisë “***” sh.p.k.; (ii) datë 10.9.2012, vlera 690.450 lekë (ekuivalenti i vlerës 5.000 euro), depozitim në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k.; (iii) datë 26.4.2013, vlera 3.444.000 lekë, transfertë nga BKT-ja në favor të shoqërisë “***” sh.p.k.

¹²³ Në procesverbalin e datës 25.5.2021 të ILDKPKI-së.

¹²⁴ Email datë 22.11.2023.

¹²⁵ (i) Datë 9.9.2011, vlera 2.107.500 lekë, transfertë nga BKT-ja në favor të shoqërisë “***” sh.p.k.; (ii) datë 10.9.2012, vlera 690.450 lekë (ekuivalenti i vlerës 5.000 euro), depozitim në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k.; (iii) datë 26.4.2013, vlera 3.444.000 lekë, transfertë nga BKT-ja në favor të shoqërisë “***” sh.p.k.

¹²⁶ Sipas deklaramentit të subjektit në pyetësorin standard.

e kredisë me BKT-në; (iii) subjekti e ka në përdorim këtë pasuri që prej vitit 2022¹²⁷. Për rrjedhojë, Komisioni analizoi burimet financiare të përdorura nga subjekti dhe babai i saj për pagesën e kësteve.

i) Burimi i parë – të ardhurat nga shitja e shtëpisë në fshatin *, Shkodër**

6.24. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë me shkrim dore datë 25.9.2004, të babait të saj F. L., i cili ka deklaruar: “...mbaj këtë deklaratë për shitjen e shtëpisë në fshatin *** prej 2 dhoma + kuzhinë + aneks + korridor.... shtetasit F. F., në shumën 27 milionë të vjetra. Ramë dakord që shumën prej 21 milionë ta likuidojë deri në fund të vitit 2004. Shumën e mbetur prej 6 milionë të vjetra ta likuidojë në një periudhë tjetër sipas mundësive. I pranishëm në këtë deklaratë është edhe shtetasi Gj. F., nipi i F.”. Kjo deklaratë është firmosur nga shtetasit F. L., F. K. F. dhe Gj. F..

6.25. Rezulton se në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë në BKT (nga shitja e shtëpisë)*”. Në seksionin “Të ardhurat” ka deklaruar: “*Shitja e shtëpisë fshati ***, viti 2004, me vlerë 2.100.000 lekë*”.

6.26. Më pas, në procesverbalin e datës 15.1.2016 të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në llogarinë e përbashkët në emër të saj dhe të babait F. L. në BKT pasqyrohen dy depozitimet e bëra në datën 30.12.2004, në shumën 2.100.000 lekë dhe në datën 6.6.2005, në shumën 500.000 lekë, me burim shitje shtëpie.

6.27. Në procesverbalin e datës 4.6.2021 të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “...kemi paguar këstin e parë në shumën rreth 15.000 euro... 2.100.000 lekë në vitin 2011.. me burim nga shitja e banesës në fshat, ...kësti i parë është paguar në fund të vitit 2004 në shumën 2.100.000 lekë ...kësti i dytë 600.000 lekë është paguar nga blerësi në vitin 2012 dorazi dhe më pas babai e ka derdhur në llogari të firmës së ndërtimit...”.

6.28. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹²⁸, subjekti i rivlerësimit deklaroi se çmimi i shitjes ka qenë në vlerën 2.700.000 lekë, vlerë të cilën shtetasi F. F. e ka likuiduar në dy këste, konkretisht, kësti i parë në vitin 2004 në shumën 2.100.000 lekë, ndërsa kësti i dytë në vitin 2005 në shumën 600.000 lekë, vlera të cilat ky shtetas ia ka dhënë në dorë babait të saj e, më pas, ky i fundit i ka depozituar në BKT. Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.9.2023, të shtetasit F. F., që konfirmon deklarin e mësipërm.

6.29. Në kushtet që subjekti ka deklaruar se kjo pasuri nuk ka qenë e regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk është hartuar akt noterial për shitjen e saj, fillimisht Komisioni hetoi dhe analizoi: (a) ekzistencën e banesës në fshatin *** në pronësi të shtetasit F. L.; (b) marrëdhënien juridike të shitjes; (c) çmimin e shitjes së kësaj banese.

a) Lidhur me ekzistencën e pasurisë banesë në fshatin *, Shkodër**

6.30. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja¹²⁹, rezulton se shtetasi F. L. është pajisur me AMTP nr. *** pa datë, në të cilën, përveç tokës bujqësore të trajtuar në pikën 1 të relacionit, pasqyrohet shënimi “Te shtëpia, sip. trualli 250”.

¹²⁷ Sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin nr. 1.

¹²⁸ Email datë 28.9.2023.

¹²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.7.2023.

6.31. Në vijim, rezulton se me kërkesën e datës 28.1.2015, drejtuar Komunës *** Shkodër¹³⁰, shtetasi F. L. ka kërkuar kalimin e pronësisë së banesës me nr. ***, z. k. ***, fshati ***, ndërtuar përpara datës 10.8.1991, sipas parashikimeve të VKM-së nr. ***¹³¹.

6.32. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 13.1.2016, të ZVRPP-së Shkodër, e cila sqaron shtetasin F. L. se bazuar në kërkesën e tij për informacion lidhur me pasurinë nr. ***, z. k. ***, rezulton se nuk është e regjistruar në zërin kadastral ndërtesë (shtëpi banimi), por është afishuar vetëm sipërfaqe trualli 250 m², në vol. ***, f. ***, pasuri e cila është e pacertifikuar.

6.33. Më pas, Bashkia Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 22.8.2018, i ka përcjellë ALUIZNI-t kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues të shtetasit F. L. (në shkresë është L.) për trajtim.

6.34. ALUIZNI, me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2015, ka informuar Komunën *** se në pasurinë nr. ***, z. k. ***, fshati ***, Shkodër, ka vetëdeklarim për objekt në proces legalizimi të datës 15.11.2006, në posedim të shtetasit A. H. U..

6.35. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹³², subjekti i rivlerësimit deklaron se shtetasin A. U. nuk e njeh fare dhe nuk ka asnjë lidhje me të. Më tej shpjegon se pas transferimit në qytet, prindërit ia kanë shitur këtë shtëpi shtetasit F. K. F. dhe për këtë shitje është mbajtur edhe një deklaratë dore e datës 25.9.2004, shtëpi e cila nuk qenë e regjistruar në kadastrë.

6.36. Nga dokumentacioni i administruar nga noter B. Xh. T.¹³³, rezulton se në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.3.2015, shtetasi F. L. ka deklaruar se: “...kontrata e energjisë elektrike nr. *** rezulton në emrin tim F. L., ndërkohë që ajo me kohë është kaluar në emrin e F. F., por vazhdon të faturohet ende në emrin tim F. L. dhe deklaroj se këtë kontratë ia kaloj F. F., duke u faturuar tani e tutje energjia në emrin e F. F. dhe unë nuk mbaj përgjegjësi për këtë kontratë...”.

6.37. Subjekti ka paraqitur¹³⁴ shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2021, të ASHK-së Shkodër, e cila informon shtetasin F. F. se kërkesa e tij për përfshirje në proces legalizimi¹³⁵ është administruar dhe do të shqyrtohet pasi të zbatohen hapat proceduralë (të administruar dhe nga ASHK Shkodër¹³⁶).

6.38. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet se: (i) sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 10.8.1991 shtetasi F. L. figuron banor i Komunës ***, fshati ***¹³⁷; (ii) në AMTP-në nr. *** akti, përveç tokës bujqësore të trajtuar në pikën 1 të relacionit, pasqyrohet shënimi “Te shtëpia, sip. trualli 250”; (iii) ASHK Shkodër konfirmon se në vitin 2015 shtetasi F. L. ka aplikuar për regjistrimin e banesës në fshatin ***, krijon bindjen se shtetasi F. L. ka pasur në posedim banesë në fshatin ***, Bashkia Shkodër.

¹³⁰ Të paraqitur dhe nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

¹³¹ “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.8.1991”.

¹³² Email datë 28.9.2023.

¹³³ Shkresë nr. *** prot., datë 9.8.2023 (në Komision).

¹³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2023.

¹³⁵ Protokoll hyrës në ASHK, me nr. ***, datë 11.2.2021.

¹³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 1.11.2023.

¹³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.7.2023, e ASHK-së Shkodër.

b) Lidhur me marrëdhënien juridike të shitjes së shtëpisë ndërmjet shtetasve F. L. dhe F. F.

6.39. Lidhur me shitjen e shtëpisë në fshatin ***, nga hetimi administrativ, rezultoi se: (i) në DIPP-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar shitjen e shtëpisë fshatin ***, me vlerë 2.100.000 lekë; (ii) subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting 2017* deklaratën me shkrim dore të datës 25.9.2004, ku shtetasi F. L. deklaroi se shtëpinë e tij në fshatin *** ia shet shtetasit F. F. në shumën 27 milionë lekë të vjetra; (iii) në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.3.2015, shtetasi F. L. ka deklaruar se kontratën e energjisë elektrike ia kalon shtetasit F. F.; (iv) në deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.9.2023, shtetasi F. F.¹³⁸ ka deklaruar se në vitin 2004 ka blerë nga shtetasi F. L. një banesë 1 kat, e përbërë nga dy dhoma e kuzhinë, me adresë fshati ***, ish-Komuna ***, Shkodër, në vlerën 2.700.000 lekë.

6.40. Nga analizimi i fakteve të mësipërme, Komisioni çmon se marrëdhënia e shitblerjes e banesës në fshatin *** ndërmjet shtetasve F. L. dhe F. F. nuk është formalizuar në formën e kërkuar ligjore, për shkak se shitësi nuk e kishte të regjistruar banesën në regjistrin e pasurive të paluajtshme, megjithatë kjo rrethanë nuk përbën shkak që të arrihet në konkluzionin se marrëdhënia e shitblerjes në rastin konkret nuk ekziston, për sa kohë që nga rrethanat e pasqyruara në paragrafin e mësipërm rezultoi se subjekti e ka deklaruar shitjen e banesës në DIPP/2004. Në vitin 2015 palët kanë bërë deklaratë të përbashkët për kalimin e kontratës së energjisë elektrike dhe marrëdhënia e shitblerjes konfirmohet nga shtetasi F. F. nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 27.9.2023.

6.41. Sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se ndërmjet shtetasve F. L. dhe F. F. ka ekzistuar marrëdhënia e shitblerjes së banesës në fshatin ***, Shkodër.

c) Lidhur me çmimin e shitjes

6.42. Sikurse është trajtuar në paragrafët e mësipërm, referuar deklaratës me shkrim dore që mban datën 25.9.2004 dhe deklaratës noteriale nr. ***, datë 27.9.2023, të shtetasit F. F., çmimi i shitjes ka qenë 2.700.000 lekë, vlerë, e cila, sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, është marrë *cash* nga babai i saj dhe është depozituar në llogarinë dyemërore pranë BKT-së, respektivisht në datën 31.12.2004, në vlerën 2.100.000 lekë dhe në datën 6.7.2005, në vlerën 500.000 lekë.

6.43. Nga këqyrja e lëvizjeve të llogarive të përcjella nga BKT-ja¹³⁹, konfirmohet se në llogarinë dyemërore të subjektit dhe të babait të saj është kryer një depozitim në datën 30.12.2004, me vlerë 2.100.000 lekë, me përshkrimin "*Cash deposit*" dhe një depozitim në datën 6.7.2005, me vlerë 500.000 lekë, me përshkrimin "*Françeskina Lekani, derdhje në dep. 6-mujore*".

6.44. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit u konstatua një mospërputhje lidhur me vitin në të cilin ishte arkëtuar kësti i dytë nga ana e babait, konkretisht në procesverbalin pranë ILDKPKI-së në vitin 2016 subjekti ka deklaruar se kësti i dytë prej 500.000 lekësh është burim i depozitimit në BKT, në datën 6.7.2005¹⁴⁰ (çka do të thotë që kësti i dytë nga shitja e banesës

¹³⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

¹³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2021.

¹⁴⁰ Në procesverbalin e datës 15.1.2016 të ILDKPKI-së, ka deklaruar se në llogarinë e përbashkët në emër të subjektit dhe të babait/F. L., në BKT, pasqyrohen dy depozitimet e bëra në datën 30.12.2004, në shumën 2.100.000 lekë dhe në datën 6.6.2005, në shumën 500.000 lekë, me burim shitje shtëpie.

në fshat është paguar në vitin 2005), ndërsa në procesverbalin e vitit 2021 ka deklaruar që kësti prej 600.000 lekësh është paguar nga blerësi në vitin 2012¹⁴¹.

6.45. Lidhur me këtë mospërputhje, subjekti i rivlerësimit sqaron¹⁴² se kësti i dytë i shitjes së banesës në fshatin *** është bërë në vitin 2005, ku këto para janë depozituar në llogarinë e përbashkët me datë 6.7.2005, në BKT.

6.46. Gjithashtu, sqaron se shuma 600.000 lekë (e depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k.) ka si burim të ardhurat nga shitja e shtëpisë në fshatin ***, por ndër vite ka kryer lëvizje bankare e kryesisht tërheqje, e këto para i ka pasur *cash* në shtëpi dhe kjo është arsyeja pse është bërë ngatërresa.

6.47. Sa më lart, Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar arkëtimin e kështit të parë prej 2.100.000 lekësh, si dhe e ka deklaruar këtë shumë si burim për krijimin e depozitimit të kryer në BKT, në të njëjtën vlerë, në datën 30.12.2004.

6.48. Lidhur me këstin e dytë, në vlerën 600.000 lekë, Komisioni nga hetimi administrativ konstatoi se: (i) arkëtimi i këtij kësti nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005, sikundër është deklaruar arkëtimi i kështit të parë në vitin 2004; (ii) për herë të parë arkëtimi i këtij kësti është deklaruar në vitin 2016, në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, pra rreth 11 vite më vonë; (iii) subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në procesverbalet e ILDKPKI-së lidhur me vitin në të cilin është arkëtuar ky këst.

6.49. Për rrjedhojë, Komisioni, në fazën e hetimit administrativ arriti në përfundimin se *ka dyshime lidhur me çmimin e shitjes prej 2.700.000 lekësh të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, pasi duket që çmimi i shitjes ka qenë 2.100.000 lekë.*

6.50. Më tej, Komisioni analizoi nëse të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj banese plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, lidhur me detyrimet tatimore.

6.51. Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime deri në vitin 2004, në raport me faktet e mësipërme, në përfundim të rezultateve të hetimit Komisioni arriti në përfundimin se *subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 2.100.000 lekë, në datën 31.12.2004, në llogarinë dyemërore, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara si burim dhe gjithashtu kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 500.000 lekë, në datën 6.7.2004, në llogarinë dyemërore, pasi nuk provohet arkëtimi i kështit të dytë nga shitja e banesës në fshatin ***, si dhe nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.*

6.52. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴³ lidhur me çmimin e shitjes së banesës në fshatin ***, subjekti i rivlerësimit sqaron se shitja e banesës nuk është bërë me akt noterial, pasi kjo banesë nuk ka qenë e regjistruar në kadastër dhe paratë e shitjes babai i saj i ka depozituar në llogarinë e përbashkët në BKT. Në vijim shpjegon se: “*Në kushtet kur shitja e shtëpisë është mbajtur me shkrim dore në mirëbesim, shtetasi F. F., pas kërkesës së saj, ka përpiluar dhe akt noterial, ku ka deklaruar faktin e blerjes së banesës dhe dhënies së babait tim të shumës*

¹⁴¹ Në procesverbalin e datës 4.6.2021 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se: “.. kemi paguar këstin e parë në shumën rreth 15.000 euro...2.100.000 lekë në vitin 2011...me burim nga shitja e banesës në fshat,...kësti i parë është paguar në fund të vitit 2004, në shumën 2.100.000 lekë ...kësti i dytë 600.000 lekë është paguar nga blerësi në vitin 2012 dorazi dhe më pas babai e ka derdhur në llogari të firmës së ndërtimit...”.

¹⁴² Në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

¹⁴³ Email datë 22.11.2023.

2.700.000 lekë, në dorë, me dy këste”. Sipas subjektit të rivlerësimit, dokumentet që vërtetojnë shitjen e shtëpisë dhe pagesën që ka bërë ky shtetas është deklarata me shkrim dore e bërë me datë 25.8.2004, ku shitës është babai i saj, blerës F. F., i pranishëm shtetasi Gj. F. dhe deklarata noteriale e lëshuar nga shtetasi F. F., me datë 27.9.2023.

6.53. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën 500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit shpjegon se burimi i tyre është shitja e shtëpisë në fshatin *** (500.000 lekë), por ndër vite ka bërë lëvizje bankare e kryesisht tërheqje e këto para i ka pasur cash në shtëpi.

6.54. Lidhur me faktin se nga babai i saj nuk janë paguar detyrimet tatimore, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka pasur dijëni deri tani, por kjo situatë nuk mund të shpjegohet në konkluzionin se këto të ardhura, të provuara me prova shkresore që kanë ekzistuar realisht, të njohura dhe nga Komisioni se marrëdhënia ka ekzistuar dhe shitja është kryer, nuk duhen marrë në konsideratë. Gjithashtu, shpjegon se sot si trashëgimtare ligjore e babait të saj, bashkë me trashëgimtarët e tjerë, merr përsipër pagimin e këtij detyrimi ndaj shtetit.

Analizimi i këstit të parë dhe të dytë të paguar për shoqërinë “**” sh.p.k. (vlerë 2.107.500 lekë, datë 9.9.2011 dhe vlerë 5.000 euro, datë 10.9.2012)**

6.55. Komisioni konstaton se dy shumat e depozituara (2.100.000 lekë dhe 500.000 lekë) janë kaluar në depozita me afat dhe, në vijim, pas maturimit në vitin 2011, janë kryer këto transaksione: (i) në datën 22.8.2011 është kryer një transfertë bankare në vlerën 301.930 lekë, në favor të subjektit (në llogarinë individuale), me përshkrimin “... kalim në llogari të kredisë për mbyllje kredie¹⁴⁴”; (ii) në datën 9.9.2011 është kryer një transfertë bankare në vlerën 2.170.500 lekë, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim fondi në llogari të “****” sh.p.k. për blerje apartamenti”; (iii) tërheqje në shumën 200.000 lekë¹⁴⁵. Më tej, në këto llogari janë kryer transaksionet e paraqitura në tabelën vijuese.

Tabela nr. 4 – Përmbledhëse e veprimeve të kryera në llogaritë në lekë në BKT

Viti	Depozitime	Interesa	Tërheqje	Transfertë për “Ani” sh.p.k.	Transfertë në llogarinë e subjektit	Gjendja e depozitave në fund të vitit ¹⁴⁶
2004	2,100,000					2,100,000
2005	500,000	51,832				2,651,832
2006						2,651,832
2007						2,651,832
2008						2,651,832
2009						2,651,832
2010						2,651,832
2011		863,820	200,000	2,107,500	301,930	906,222
2012		29,586	350,000			585,807
2013		2,715	483,700			104,822
2014						104,822
2015						104,822
2016		3,304	108,126			0
TOTAL	2,600,000	951,256	1,141,826	2,107,500	301,930	0

6.56. Lidhur me pagimin këstit të parë, me vlerë 2.107.500 lekë, në datën 9.9.2011, Komisioni vëren se në kushtet që depozitimi prej 2.100.000 lekësh, në BKT, në datën 31.12.2004, ka

¹⁴⁴ Kredi në vlerën 298.500 lekë, datë 7.6.2011.

¹⁴⁵ Datë 11.10.2011.

¹⁴⁶ E për llogaritur: gjendje nga viti i mëparshëm + depozitime + interesa – tërheqje – transfertat.

shërbyer si burim për pagesën e këtij kësti, duket se subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burime të ligjshme financiare për pagesën e kështit të parë për apartamentin e porositur.

6.57. Lidhur me këstin e dytë, me vlerë 5.000 euro, në datën 10.9.2012, Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se *si burim i tij ka shërbyer kësti i dytë i arkëtuar nga shitja e banesës në fshatin *** dhe se ndër vite ka kryer tërheqje nga llogaria bankare, shuma të cilat i ka pasur cash në shtëpi.*

6.58. Për rrjedhojë, në fazën e hetimit administrativ, Komisioni arriti në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 490.450 lekë për pagesën e kështit të dytë për apartamentet e porositur.*

ii) Burimi i dytë – kredi në BKT, në vlerën 3.500.000 lekë

6.59. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar kredi për blerje banese në datën 25.4.2013, në BKT, me vlerë 3.500.000 lekë¹⁴⁷.

6.60. BKT-ja¹⁴⁸ konfirmon se në datën 25.4.2013 është lidhur kontrata e kredisë nr. ***, sipas së cilës banka ka akorduar në favor të kredimarrësve (subjektit dhe shtetasit F. L.) një total kreditimi jo më shumë se 3.500.000 lekë, për blerje shtëpie. Si kolateral për këtë kredi është vendosur apartamenti me sip. 74 m², i cili në kohën e marrjes së kredisë figuronte në pronësi të babait të subjektit (trajtuar në pikën 4).

6.61. Kredia prej 3.500.000 lekësh është lëvruar në datën 25.4.2013, në llogarinë rrjedhëse në emër të subjektit dhe në datën 26.4.2013 është kryer një transfertë në vlerën 3.444.000 lekë në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim fondi për “****” sh.p.k., për blerje apartamenti nga F. L.”.

6.62. Në procesverbalin e datës 15.1.2016 të ILDKPKI-së¹⁴⁹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Kjo kredi është marrë për shlyerjen e detyrimit të dy apartamenteve të blera sipas kontratës së porosisë që ju kam vënë në dispozicion*¹⁵⁰”.

6.63. Nga analizimi i llogarive bankare konstatohet se kjo kredi është shlyer nga llogaria rrjedhëse e subjektit, me burim depozitimet e kryera çdo muaj ose nga kreditimi i pagës.

6.64. Në përfundim, lidhur me pagesën për këstin e tretë me vlerë 3.444.000 lekë, datë 26.4.2013, rezulton se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare pasi si burim ka shërbyer kredia e marrë pranë BKT-së.

6.65. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se: *1. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 171,3 m²: Ka dyshime mbi vërtetësinë e deklaratimit të subjektit se ajo është bashkëpronare me nënën dhe vëllain e saj në këtë pasuri, duke u përpjekur të paraqesë rrethana të rreme, të cilat tentojnë të shmangin nga kontrolli një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë së plotë mbi këtë pasuri, pasi: (i) Në momentin e blerjes së kësaj pasurie subjekti figuronte në certifikatë familjare me babain e saj (porositësi i kësaj pasurie) dhe jetonte faktikisht me të; (ii) Subjekti dhe babai i saj kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 2.590.450*

¹⁴⁷ Më tej, subjekti ka deklaruar shumën e shlyer gjatë vitit dhe vlerën e mbetur të kredisë.

¹⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.21.

¹⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

¹⁵⁰ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 7.9.2011.

lekë për pagesën e kësteve pasi kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 2.100.000 lekë për pagesën e kështit të parë, pasi për të ardhurat e deklaruar si burim nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore; kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 490.450 lekë për pagesën e kështit të dytë pasi për depozitimin prej 690.450 lekësh (ekuivalenti i 5.000 euro) mund të ketë shërbyer si burim vetëm shuma prej 200.000 lekësh, e tërhequr nga llogaria në vitin 2012, përpara kryerjes së depozitimit; (iii) Kontrata e porosisë është nënshkruar vetëm nga babai i subjektit, ndërkohë që në vitin 2013 subjekti është bashkëkredimarrës në kredinë prej 3.500.000 lekësh (përdorur për pagesën e kështit të tretë), kredi e cila shlyhet periodikisht nga subjekti; (iv) Është e dyshimtë që për këtë apartament është paguar rreth 44.500 euro përkundrejt çmimit 113.000 euro të pasqyruar në kontratën e porosisë; (v) Është e dyshimtë që vëllai i subjektit ka kryer shpenzimet dhe punimet për përfundimin e këtij apartamenti, ndërkohë që nuk e ka përdorur dhe as nuk ka gjeneruar të ardhura; (vi) Subjekti ka deklaruar në procesverbalin e datës 25.1.2016 të ILDKPKI-së se apartamenti me sip. 88 m² është blerë për llogari të vëllait F. L., ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2016 nuk e ka deklaruar këtë fakt dhe deri në këtë fazë të hetimit nuk rezulton që ky shtetas të ketë kontribuar për blerjen e apartamentit; (vii) Është e paqartë që subjekti figuron bashkëpronare në 1/3 e kësaj pasurie, ndërkohë që sipas dispozitave ligjore në fuqi duhej të figuronte me 1/6 pjesë.

1. Në lidhje me dy depozitimet e kryera në llogarinë dyemërore të subjektit dhe babait të saj:

(i) Subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 2.100.000 lekë, në datën 31.12.2004, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruar si burim; (ii) Subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 500.000 lekë, në datën 6.7.2005, pasi nuk provohet arkëtimi i kështit të dytë nga shitja e banesës në fshatin ***, si edhe nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.

6.66. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁵¹, subjekti i rivlerësimit jep këto shpjegime:

- Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare në vlerën 2.100.000 lekë për pagesën e kështit të parë, për shkak se nuk janë shlyer detyrimet tatimore, sqaron se ky fakt nuk mund të shpjegohet në konkluzionin se burimi nuk ka ekzistuar dhe as të bëjë të paligjshme të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie. Detyrimi tatimor i pashlyer është një detyrim që mund të paguhet në çdo kohë, duke rikuperuar çdo pasoje. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare në vlerën 490.450 lekë për pagesën e kështit të dytë sqaron se një shumë të tillë e ka pasur cash në banesë dhe burim krijimi ka qenë pikërisht shitja e banesës në fshatin *** nga babai i saj.

- Lidhur me faktin se kontrata e porosisë (sipërmarrjes) është lidhur nga babai, ndërsa te kontrata e kredisë e vitit 2013 është bashkëkredimarrëse me babain, subjekti i rivlerësimit shpjegon se kjo është bërë pasi banka, për shkak të moshës së babai të saj dhe të të ardhurave që siguronte, nuk i jepte kredi. Ndërkohë, në kontratën e hipotekimit, vijon subjekti i rivlerësimit, hipotekues janë vetëm nëna dhe babai i saj.

- Lidhur me dyshimin që janë paguar vetëm 44.500 euro nga shuma totale prej 113.000 euro, subjekti i rivlerësimit sqaron se në fakt se çmimi i shitjes është 103.000 euro dhe diferenca e papaguar ka ardhur për shkak se kësti i dytë do të paguhej në momentin që do të merrej në

¹⁵¹ Email datë 22.11.2023.

dorëzim objekti. Në momentin që është marrë në dorëzim objekti, vijon subjekti, sipërmarrësi i ka pasur të gjitha llogaritë bankare të bllokuara dhe ka qenë në konflikte gjyqësore me ortakët e tij dhe kjo e ka bërë të pamundur pagesën e këstit të dytë.

- *Lidhur me dyshimin se vëllai i saj ka kryer shpenzime për punimet e brendshme, ndërkohë që nuk e ka përdorur këtë apartament dhe as ka gjeneruar të ardhura*, subjekti i rivlerësimit u referohet sqarimeve të mësipërme.

- *Lidhur me deklarin e blerjes së apartamentit me sip. 88 m² për llogari të vëllait F. L. në procesverbalin e datës 25.1.2016, kur ndërkohë një deklarin të tillë nuk e ka bërë në DIPP-në e vitit 2016 as në vijim të hetimit*, subjekti i rivlerësimit sqaron se në atë kohë nuk ka pasur asnjë të drejtë reale mbi këtë pasuri dhe këto të drejta i ka fituar vetëm në vitin 2022, si trashëgimtare ligjore e babait të saj. Më pas sqaron se në DIPP-në e vitit 2016 dhe në vitet në vijim nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor që të deklarojë një pasuri, e cila nuk ishte regjistruar ende në emër të babait të saj. Kështu që nga ana e saj nuk është bërë asnjë lloj fshehjeje. Në procesverbalin e datës 25.1.2016, vijon shpjegimin subjekti i rivlerësimit, kur është pyetur nga inspektori, e ka sqaruar këtë rrethanë, por edhe në atë kohë, pasuria nuk ka qenë e regjistruar.

- *Lidhur me paqartësinë e Komisionit për sa i përket pjesës takuese me 1/3 e pasurisë*, shprehet edhe një herë se kjo është bërë në bazë të dëshmisë së trashëgimisë të nxjerrë nga noteri dhe nuk është bërë ndarja e pasurisë me trashëgimtarët e tjerë.

- *Lidhur me konstatimin se ajo dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme lidhur me dy depozitimet e kryera në llogarinë dyemërore të përbashkët, për shkak se nuk janë paguar detyrimet tatimore*, i referohet shpjegimeve të mësipërme.

Arsyetimi ligjor i Komisionit lidhur me këto pasuri

6.67. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të rezultateve të hetimit; (v) deklarinet e subjektit në seancë dëgjimore – arsyeton si më poshtë:

Lidhur me vërtetësinë e deklarin të kësaj pasurie

6.68. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se *mosshlyerja e detyrimeve në total ndaj subjektit ndërtues ka ardhur jo për shkak të mosrealizimit të punimeve të brendshme, por për shkak se ky subjekt i ka pasur të gjitha llogaritë e bllokuara* shton edhe më shumë dyshimet e Komisionit lidhur me burimet e krijimit të pasurive të sipërpërmendura, pasi konstatohet se vendimi nr. ***, datë 3.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁵² ka marrë formë të prerë në datën 5.12.2016. Për pasojë, mbetet i dyshimtë deklarin i subjektit të rivlerësimit se e disponon diferencën e çmimit të blerjes së apartamentit (rreth 58.500 euro¹⁵³), për sa kohë që nga hetimi administrativ nuk konstatohet ndonjë depozitë në emrin e saj apo të nënës së saj në këtë shumë dhe në kushtet kur, referuar analizës financiare të vëllait të saj për periudhën 2011 – 2016, të ardhurat e tij të ligjshme nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës e, për pasojë, përjashtohet mundësia e kursimit të shumës së mësipërme. Gjithashtu, edhe vlera e përfitur nga shitjet e

¹⁵² Të paraqitur nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

¹⁵³ Diferencë e shumës 103.000 euro (sipas parashikimit në kontratë për rastin kur punimet e brendshme do të kryhen nga porositi) me totalin e pagesave, në shumën rreth 44.500 euro.

tokave bujqësore në datën 1.8.2017, me çmim 1.480.000 lekë dhe 733.000 lekë, nuk e mbulojnë diferencën e çmimit të mbetur.

6.69. Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se *objekti ishte i papërfunduar dhe disa punime (dyert e brendshme dhe tualetet) janë kryer nga ana e saj/vëllait të saj dhe jo nga shoqëria “***” sh.p.k.*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 4 dokumente fletë-dalje, si dhe disa fatura shitjeje, ku pasqyrohen materiale të ndryshme ndërtimi, por ky dokumentacion duke mos qenë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁵⁴, nuk ka vlerë provuese për Komisionin. Për më tepër, në disa prej këtyre dokumenteve, në cilësinë e blerësit nuk pasqyrohet shtetasi F. L., por persona të tjerë. Fatura e vetme që plotëson kushtet ligjore është një faturë e datës 25.10.2017, me vlerë totale 149.753 lekë, për blerje mobiliesh. Gjithashtu, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokument ligjor justifikues për të mbështetur pretendimet e tij. Për pasojë, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ.

6.70. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *sipërfaqja e regjistruar e apartamentit është më e madhe se sipërfaqja e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2011, për shkak se në këtë të fundit është pasqyruar vetëm sipërfaqja reale e banimit, jo sipërfaqet e përbashkëta*, Komisioni vlerëson se ky shpjegim nuk mbështetet në parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”¹⁵⁵, ku parashikohet se sipërfaqet e përbashkëta regjistrohen të ndara nga sipërfaqet individuale e, për pasojë, sipërfaqja 171.3 m², e pasqyruar në certifikatën e pronësisë së subjektit, përfaqëson vetëm sipërfaqen individuale.

6.71. Për rrjedhojë, Komisioni çmon se barra e provës qëndron dhe se: (i) Deklarimi i subjektit se ka kryer punime të brendshme në vlerën 700.000 lekë nuk e justifikon mosshlyerjen e çmimit të mbetur për blerjen e apartamenteve në vlerën 68.000 euro, për pasojë mbetet i paqartë fakti që nëna e saj e, më pas, subjekti kanë poseduar apartamentet nga viti 2017 e në vijim pa shlyer pjesën e mbetur të çmimit të blerjes; (ii) Deklarimi i subjektit se objekti ishte i papërfunduar dhe disa punime (dyert e brendshme dhe tualetet) janë kryer nga ana e saj/vëllait të saj dhe jo nga shoqëria “***” sh.p.k. mbetet i paprovuar; (iii) Deklarimi i subjektit se sipërfaqja e regjistruar e apartamentit është më e madhe se sipërfaqja e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2011, për shkak se në këtë të fundit është pasqyruar vetëm sipërfaqja reale e banimit, jo sipërfaqet e përbashkëta, nuk është bindës, pasi në ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, parashikohet se sipërfaqet e përbashkëta regjistrohen të ndara nga sipërfaqet individuale e, për pasojë, sipërfaqja 171,3 m² e pasqyruar në certifikatën e pronësisë së subjektit përfaqëson vetëm sipërfaqen individuale, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me konfliktin e interesit

6.72. Konflikti i interesit, sipas ligjit nr. 9367/2005, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë

¹⁵⁴ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 46, pika 1, përcakton: “Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre”.

¹⁵⁵ Neni 52 parashikon: “1. Në kartelën kadastrale ku është regjistruar objekti i ri në tërësi përcaktohen sipërfaqet që zënë njësitë individuale dhe sipërfaqet e përbashkëta. 2. Sipërfaqet e përbashkëta regjistrohen në tërësi dhe me kuota të ndara për çdo pronar të njësisë individuale. Ndalohet regjistrimi me pjesë takuese në favor të pronarëve i sipërfaqes së përbashkët.”

të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike¹⁵⁶. Një ndër rrethanat të cilat mund të dëshmojnë konfliktin e mundshëm të interesit, janë interesat privatë të zyrtarit që bazohen, burojnë nga të drejta dhe detyrime pasurore të çdo natyre dhe çdo marrëdhënieje tjetër juridiko-civile¹⁵⁷. Në vijim, ligji nr. 9367/2005, në nenin 4¹⁵⁸, pika 1, shkronja “a”, nënndarja “ii”, ka përcaktuar detyrimin për zbatimin e dispozitave të tij, edhe për çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte të organeve gjyqësore dhe akte të organeve të prokurorisë, ndërsa në nenin 13, pika 2 parashikon: “2. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar”. Kjo dispozitë nuk përjashton veprimtarinë e gjyqtarëve/prokurorëve nga fusha e zbatimit të ligjit nr. 9367/2005, për sa i përket detyrimit të tyre për të verifikuar dhe shmangur konfliktin e vazhdueshëm dhe rast pas rasti të interesit. Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioni arsyeton se ekzistenca e konfliktit të interesit nuk kushtëzohet nga lloji i vendimmarrjes apo mënyra e zgjidhjes së çështjes¹⁵⁹.

6.73. Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se nga ana e saj nuk është çmuar se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.9.2011, është lidhur me shtetasin A. D., Komisioni arsyeton se neni 64 i Kodit Civil përcakton se: “Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar)”. Në kuptim të kësaj dispozite, përfaqësimi është i detyrueshëm kur buron nga ligji apo vendimi gjyqësor dhe vullnetar rastin kur burimi i krijimit të marrëdhënies së përfaqësimit është prokura. Referuar dispozitave të Kodit Civil¹⁶⁰, prokura është një veprim juridik i njëanshëm, me anë të së cilës një subjekt i jep një tjetri tagrin e përfaqësimit. Ky i drejtohet jo vetëm personit të përcaktuar si përfaqësues, por lidhet edhe me anën e jashtme, pasi shërben për t’u treguar të tretëve, me të cilët përfaqësuesi do të kontaktojë, se ai është i autorizuar të veprojë në emrin e tij. Kjo do të thotë që përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit dhe nga kjo kuptohet se i gjithë rezultati ekonomik dhe juridik i veprimit që kryhet i përket personit të përfaqësuar¹⁶¹.

6.74. Në pjesën hyrëse të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 7.9.2011, ku parashikohen palët në kontratë, pasqyrohet në cilësinë e palës “sipërmarrës/investitor” shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., e përfaqësuar nga shtetasi Sh. D. D. dhe e përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A. Sh. D., prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 6.8.2010 dhe në cilësinë e palës “porositës” pasqyrohet shtetasi F. L.. Në fund të kontratës pasqyrohen nënshkrimet e palëve, ku në cilësinë e palës “sipërmarrës/investitor” figuron shoqëria “****” sh.p.k., me përshtetimin “Përfaq. me prokurë të përgj.”, si dhe nënshkrimi i shtetasit A. D..

¹⁵⁶ Neni 3, pika 1 parashikon: “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike”.

¹⁵⁷ Neni 5 parashikon: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile...”.

¹⁵⁸ Ligji nr. 9367/2005, neni 4 parashikon: “Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t’u zbatuar nga: a) çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për:... ii) akte të organeve gjyqësore...”.

¹⁵⁹ Vendimet nr. 3, datë 4.3.2020 (JR) dhe nr. 6, datë 18.6.2020 (JR) etj., të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁶⁰ Neni 70 parashikon: “Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuarit, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagrave që i ka dhënë përfaqësuesit”.

¹⁶¹ Vendimi nr. ***, datë 5.11.2015, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

6.75. Referuar fakteve të mësipërme është e qartë se shtetasi A. D., me firmosjen e kontratës së sipërmarrjes, ka vepruar në emrin dhe për llogari të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., e cila mbart të drejtat dhe detyrimet. Për pasojë, kontrata konsiderohet e lidhur ndërmjet babait të subjektit të rivlerësimit/F. L. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

6.76. Në kushtet kur babai i subjektit ka ndërruar jetë, subjekti, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të tij, ka trashëguar 1/3 e pasurisë së trashëgimlënësit dhe, sipas parashikimeve të nenit 341¹⁶², të Kodit Civil, trashëgimtarët përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët e tyre deri në vleftën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë. Si pasojë, në rastin e kontratës së sipërmarrjes së vitit 2011, është bërë suksesdimi (zëvendësimi) i palës porositëse nga shtetasi F. L. tek trashëgimtarët e tij, të cilët mbartin të drejtat dhe detyrimet e kontratës në përpjesëtim me pjesën e tyre. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit ka trashëguar jo vetëm të drejtën e pronësisë, por edhe detyrimet e babait të saj ndaj shoqërisë ndërtuese në përpjesëtim me pjesën që ka trashëguar nga pasuria.

6.77. Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit se *nga ana e saj ka qenë e shlyer plotësisht pjesa takuese e detyrimit dhe në vitet në vijim ka mbetur pa shlyer vetëm detyrimi i vëllait*, mbetet në nivel deklarativ, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe deklarimeve të saj në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶³ nuk rezulton që pasuritë apartament të jenë pjesëtuar (ndarë) ndërmjet trashëgimtarëve ligjore të të ndjerit F. L., përkundrazi rezulton që të dyja apartamentet e porositura nga ana e tij janë bashkuar në një apartament të vetëm, ku jeton subjekti i rivlerësimit bashkë me nënën e saj dhe ky apartament është regjistruar në regjistrat publikë në bashkëpronësi me 1/3 pjesë të secilit prej tyre. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit bashkë me nënën dhe vëllain e saj janë të detyruar në mënyrë solidare t’i paguajnë shoqërisë “****” sh.p.k. shumën e mbetur nga çmimi i shitjes.

6.78. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kërkuar dorëheqjen nga ndjekja e procedimit penal nr. ***, me qëllim shmangien e situatës së konfliktit të interesit, duke qenë se mes saj dhe të kallëzuarit, shoqërisë “****” sh.p.k. ekzistonte marrëdhënia juridiko-civile me karakter pasuror/detyrimi, e cila nuk kishte përfunduar.

6.79. Në përfundim, lidhur me konfliktin e interesit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në ndjekjen dhe marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2022, gjendet në situatën e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me burimin e parë – të ardhurat nga shitja e shtëpisë në fshatin ***, Shkodër

6.80. Për sa i përket konstatimit se *nga babai i saj nuk janë paguar detyrimet tatimore*, Komisioni arsyeton se në nenin 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime deri në vitin 2004, janë përcaktuar llojet e të ardhurave të realizuara nga një burim në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar vetëm në to, siç janë të ardhurat nga kalimi i të drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë. Në vijim, shkronja “g” e pikës 1 e nenit 8 të ligjit të sipërcituar parashikon se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura

¹⁶² Kodi Civil, neni 341 parashikon: “Trashëgimtarët përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët e tyre, gjer në vleftën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë...”.

¹⁶³ Faqja 10: “... Lidhur me paqartësinë e Komisionit për sa i përket pjesës takuese me 1/3 e pasurisë, siç e kam cituar dhe më lart, kjo është bërë në bazë të Dëshmisë së Trashëgimisë së nxjerrë nga noteri, nuk është bërë ndarja e pasurisë nga unë as nga trashëgimtarët e tjerë...”.

të tatueshme: të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, sipas nenit 8/1 të ligjit, të ardhurat e realizuara nga kalimi/transferimi i të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga tatimi.

6.81. Bazuar në analizën e mësipërme, në rastin konkret, babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur detyrimin për të deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga transaksioni i shitjes së banesës në fshatin ***, Shkodër.

6.82. *Shpjegimet e subjektit se kësti i dytë në shumën 600.000 lekë*, i depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k., ka si burim të ardhurat nga shitja e shtëpisë në fshatin ***, në shumën 500.000 lekë, të cilën e ka pasur *cash* në shtëpi, trupi gjykues çmon se nuk janë bindëse, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit: (i) nuk e ka deklaruar arkëtimin e këtij kësti në DIPP-në e vitit 2005, sikundër ka deklaruar arkëtimin e kështit të parë në vitin 2004; (ii) për herë të parë arkëtimi i këtij kësti është deklaruar në vitin 2016, në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, pra, rreth 11 vite më vonë; (iii) ka kryer deklarime kontradiktore në procesverbalet e ILDKPKI-së lidhur me vitin në të cilin është arkëtuar ky këst, (iv) nuk provohet se depozitimi i shumës 500.000 lekë ka si burim shitjen e shtëpisë në fshatin ***.

6.83. Sa më sipër, në kushtet kur: (i) babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore nga përfitimi i vlerës 2.100.000 lekë nga shitja e shtëpisë në fshatin ***, Shkodër; (ii) me paraqitjen e kërkesës për legalizim nga shtetasi F. F.¹⁶⁴ ekziston mundësia që detyrimi tatimor të mos bëhet i kërkueshëm nga organet përgjegjëse – trupi gjykues çmon se shuma 2.100.000 lekë, që babai i subjektit të rivlerësimit ka përfituar nga shitja e banesës në fshatin ***, nuk kalon kriterin e nenit të D të Aneksit të Kushtetutës e, për pasojë, kjo shumë nuk është pasqyruar në analizën financiare.

6.84. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.600.000 lekë për kryerjen e depozitimeve në llogarinë dyemërore pranë BKT-së, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pagesën e kësteve të këtyre apartamenteve

6.85. Për sa i përket transfertës bankare në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., referuar arsytimit më lart, rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën e kështit të parë në vlerën 2.107.500 lekë, në vitin 2011, respektivisht kësti i parë.

6.86. Për sa i përket kështit të dytë me vlerë 5.000 euro, datë 10.9.2012, rezulton që ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 490.450 lekë, pasi nga analizimi i transaksioneve pranë BKT-së (paraqitur në tabelën nr. 4) dhe deklarimeve të subjektit, konstatohet se: (i) shumat e tërhequra në vitin 2011 nuk janë deklaruar si likuiditete *cash* në DIPP-në e vitit 2011¹⁶⁵ e, për rrjedhojë, nuk mund të kenë shërbyer si burim i depozitimit të shumës 5.000 euro; (ii) në vitin 2012 janë kryer tri tërheqje me vlerë totale 350.000 lekë¹⁶⁶, nga e cila 200.000 lekë janë tërhequr

¹⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 1.11.2023, e ASHK-së Shkodër.

¹⁶⁵ Nëse subjekti do të kishte disponuar kursime në formën e likuiditeteve *cash*, do duhet t'i kishte deklaruar në këtë deklaratë, referuar nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, ku parashikohet se *subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në Bono Thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*, dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër “*në deklarinin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë*”.

¹⁶⁶ Datë 3.4.2012 – tërheqje 100.000 lekë; datë 26.7.2012 – tërheqje 100.000 lekë; datë 11.12.2012 – tërheqje 150.000 lekë.

përpara datës 10.9.2012 (data e depozitimit), ndërsa 150.000 lekë janë tërhequr pas kësaj date. Për rrjedhojë, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime bindëse për të kundërshtuar rezultatet e hetimit dhe mbetet i pandryshuar konkluzioni lidhur me mungesën e burimeve për pagimin e këstit në vlerën 5.000 euro.

6.87. *Për sa i përket shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit për pikën “iii” të rezultateve të hetimit, që ka lidhje me apartamentin me sipërfaqe 171,3 m², Komisioni arsyeton se ky konstatim është vlerësuar në tërësi bashkë me konstatimet e tjera për ngritjen e dyshimit se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë rrethana jo të vërteta, me qëllim shmangien nga kontrolli i marrëdhënies së plotë të pronësisë mbi këto pasuri.*

6.88. *Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit se pagesa e detyrimit të mbetur nuk është paguar pasi llogaritë e shoqërisë ndërtuese ishin bllokuar, trupi gjykues çmon se ky shpjegim i subjektit të rivlerësimit shton edhe më shumë dyshimet mbi burimet e krijimit të pasurive të sipërpërmendura, për sa kohë që nga hetimi administrativ nuk konstatohet ndonjë depozitë në emrin e saj apo të nënës së saj në këtë shumë dhe kushtet kur, referuar analizës financiare të vëllait të saj për periudhën 2011 – 2016, të ardhurat e tij të ligjshme nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës. Gjithashtu, edhe vlera e përfituar nga shitjet e tokave bujqësore në datën 1.8.2017, me çmim 1.480.000 lekë dhe 733.000 lekë, nuk e mbulon diferencën e çmimit të mbetur.*

6.89. *Lidhur me deklarin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur detyrim për deklarimin në DIPP-në e vitit 2016 të apartamentit me sip. 88 m², në emër të vëllait, pasi prona nuk ishte e regjistruar, Komisioni vëren se ky deklarin është kontradiktor me deklarimin e saj në DIPP-në e vitit 2016, ku subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar si prona të trashëguara nga babai i saj apartamentet me sip. 69 m² dhe 88 m², si dhe nuk mbështet në situatën aktuale, ku rezulton se të dyja apartamentet janë bashkuar dhe janë regjistruar me një numër pasurie dhe në këtë apartament jeton ajo bashkë me nënën e saj. Për pasojë, deklarimi i subjektit të rivlerësimit në procesverbalin e ILDKPKI-së se apartamenti me sip. 88 m² është blerë për llogari të vëllait të saj mbetet në nivel deklarativ dhe kjo rrethanë është vlerësuar në tërësi me rrethanat e tjera.*

6.90. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni çmon se pasqyrimi në kontratat e shitblerjes së apartamenteve në cilësinë e porositësit të babait të saj/F. L., person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit për shkak të jetesës së përbashkët dhe huapërdorjes së apartamentit pa kundërshtpërblim të apartamentit të blerë nga babai i subjektit, e më pas deklarimi i subjektit të rivlerësimit se këto apartamente janë trashëguar nga babai i saj, duke shtuar elemente të tjera si: (i) bashkimi dhe posedimi i apartamenteve në mënyrë vazhduese pa paguar pjesën e mbetur të çmimit të shitjes; (ii) deklarimin se nuk ka shlyer pjesën e mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit për shkak se shoqëria i kishte llogaritë e bllokuara, në kushtet kur nuk rezulton ndonjë depozitë në emrin e saj apo të nënës së saj në këtë vlerë dhe në kushtet kur, referuar analizës financiare të vëllait të saj për periudhën 2011 – 2016, të ardhurat e tij të ligjshme nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës; (iii) mosprovimin e marrjes së apartamentit në dorëzim të papërfunduar; (iv) regjistrimin në pronësi të apartamenteve me sipërfaqe më të madhe se ajo e parashikuar në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2011; (v) mungesën e burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.590.450 lekë për pagesën e kësteve të apartamentit; (vi) marrjen e kredisë në shumën 3.500.000 lekë për shlyerjen e këstit të tretë – të gjitha këto rrethana të vlerësuara në tërësi krijojnë dyshime të arsyeshme se veprimet e mësipërme dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 dhe gjatë hetimit administrativ janë bërë në

funksion të fshehjes së të drejtës së plotë të pronësisë për këto pasuri, me qëllim shmangien nga kontrolli i burimit të krijimit të tyre.

6.91. Në konkluzion, për pasuritë apartamente banimi me sip. 88 m² e 69 m², të paregjistruara, por me kontratë sipërmarrjeje nr. * rep., nr. *** kol., datë 7.9.2011, në Shkodër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka deklarime kontradiktore lidhur me porositjen e apartamenteve në vitin 2011; (ii) nuk ka deklaruar pjesën e saj takuese në këto apartamente, duke qenë se ka marrë dhe kredi për pagimin e kështit në shumën 3.500.000 lekë; (iii) nuk provoi bindshëm ekzistencën e të ardhurave të ligjshme të babait të saj për pagesën e kryer në vitin 2011; (iv) nuk provoi plotësisht burimet e ligjshme për shumën 5.000 euro, paguar në vitin 2012; (v) ka poseduar apartamentin në vitin 2017, edhe pse nuk kishte shlyer më shumë se 50% të vlerës së kontratës; (vi) ka pushuar hetimin në ngarkim të investitorit të apartamentit në kushtet e një marrëdhënieje detyrimi të pashlyer, pra në kushtet e konfliktit të interesit. Në vlerësimin tërësor të këtyre rrethanave arrihet në përfundimin se këto pasuri janë të subjektit të rivlerësimit dhe nuk janë deklaruar me vërtetësi në deklaratën *Vetting* 2017 dhe ato periodike.**

6.92. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën *Vetting* 2017 bashkëpronësinë me 1/3 pjesë nga trashëgimia ligjore e babait të saj në pasuritë apartament me sip. 88 m² dhe sip. 69 m², duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

KONSTATIME TË TJERA

7. Hua mbesës në shumën 2.600 euro, në vitin 2004

7.1. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar “*Gjendje cash 2.600 euro të mbesës në Itali*”, data e krijimit të pasurisë 23.7.2004. Në seksionin e detyrimeve financiare, ka deklaruar: “*Lekë në përdorim të mbesës në Itali, 2.600 euro*”.

7.2. Në procesverbalin e datës 15.1.2016 të ILDKPKI¹⁶⁷-së, subjekti ka deklaruar: “*Në lidhje me huan e deklaruar 2.600 euro, sqaroj se kjo shumë ka qenë dhuratë nga vëllai F., që jeton e banon në Itali dhe meqenëse në këtë periudhë e kisha cash në banesë e kam deklaruar, por më mbropa kjo shumë është përdorur për nevojat e mia*”.

7.3. Sa më lart, në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e kësaj shume në deklaratat periodike vjetore të viteve pasardhëse, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁶⁸, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit se në cilin vit është përdorur kjo shumë, si dhe i kërkoi të paraqesë deklaratë konfirmuese nga vëllai lidhur me këtë dhurim, duke specifikuar burimin financiar të krijimit. Në përgjigje, subjekti shpjegoi se e ka deklaruar këtë shumë në vitin 2004, pasi e ka pasur *cash* në shtëpi dhe se kjo shumë është përdorur për nevojat e subjektit vit pas viti. Mosdeklarimi i pakësimit të kësaj shume ka qenë neglizhencë dhe nuk ka pasur ndonjë qëllim të caktuar, vijoi subjekti.

¹⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

¹⁶⁸ Email datë 20.9.2023.

7.4. Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime vetëm në lidhje me arsyet e mosdeklarimit të pakësimit në vitet në vijim, por nuk ka paraqitur deklaratë konfirmuese nga vëllai për këtë dhurim të deklaruar dhe nuk ka specifikuar burimin financiar të krijimit.

7.5. Në këto kushte, Komisioni e paraqiti shumën 2.600 euro si gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2004 dhe në vitet në vijim e pandryshuar, për shkak të mosdeklarimit të pakësimit, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

7.6. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se *mungon dokumentacioni ligjor justifikues për krijimin e likuiditeteve cash në vitin 2004, në vlerën 2.600 euro.*

7.7. Në përgjigje¹⁶⁹ të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se mosparaqitja e dokumentacionit justifikues lidhur me sa më lart ka qenë një harresë e saj dhe ka paraqitur deklaratën me shkrim dore të vëllait të saj, të fotokopjuar, me të cilën konfirmon se shumën në fjalë ia ka dhuruar.

7.8. Trupj gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se pas analizës financiare të pasqyruar më lart në tabelat nr. 1, 2 e 5 të këtij vendimi, rezulton se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L. në periudhën 1996 – 2004 nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës, çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit që shuma 2.600 euro ka qenë dhuratë nga vëllai i saj nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues.

7.9. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën 2.600 euro në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

8. Automjet tip “Opel”, në shumën 2.500 euro, në vitin 2012

8.1. Nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja¹⁷⁰, rezulton se në procesverbalin e datës 15.1.2016 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. *** kol., datë 5.4.2012, me anë të së cilës ka blerë nga shtetasi S. M. automjetin tip “Opel”, me targë ***, me çmim 2.500 euro, si dhe ka deklaruar se: “...ky mjet nuk arriti as të regjistrohej në DPSHTRR në emrin tim, pasi në dhjetor 2012 ia shita shtetasit M. N., i cili e ka targuar mjetin ***, por kontratën nuk e disponoj”.

8.2. DPSHTRR-ja¹⁷¹ përcolli kontratën nr. *** kol., datë 5.4.2012, në të cilën pasqyrohet se subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin e mësipërm kundrejt çmimit 2.500 euro, nga shtetasi S. M.. Vetë shitësi e ka blerë këtë automjet në datën 12.1.2007, me kontratën nr. ***, kundrejt çmimit 200.000 lekë.

8.3. Gjithashtu, u administrua edhe kontrata nr. ***, datë 24.12.2015, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë automjet tek shtetasi M. N. kundrejt çmimit 100.000 lekë.

8.4. Komisioni konstaton se subjekti nuk e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2012 dhe as shitjen e tij në DIPP-në e vitit 2015, në kundërshtim me parashikimin e shkronjës “b” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

¹⁶⁹ Email datë 22.11.2023.

¹⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

¹⁷¹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.8.2023.

8.5. Në kushtet që nga dokumentacioni i administruar rezultoi se ky automjet është shitur në dhjetor të vitit 2015, ndërsa sipas deklaramit të subjektit pranë ILDKPKI-së është shitur në dhjetor të vitit 2012, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁷² Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me këtë mospërputhje, si dhe i kërkoi që të deklarojë burimin financiar të krijimit dhe, në përgjigje, subjekti i rivlerësimit deklaroi se si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer të ardhurat nga pagat si prokurore.

8.6. Ndërsa lidhur me mospërputhjen e konstatuar, subjekti i rivlerësimit shpjegon se këtë automjet e ka përdorur deri në fund të vitit 2012 dhe se gjatë kësaj periudhe mjeti ka pasur defekte dhe e ka shitur më lirë nga sa e ka blerë. Më tej, subjekti sqaron se në muajin dhjetor 2012 këtë automjet ia ka shitur shtetasit M. N., i cili, në atë moment, nuk ka qenë prezent në Shqipëri dhe duke pasur njohje me të ia ka dhënë automjetin një njeriu të tij pa bërë kontratë shitblerjeje noteriale. Në momentin që ka marrë automjetin ka bërë edhe pagesën prej 100.000 lekësh. Ky shtetas e ka përdorur këtë automjet deri në vitin 2015 pa e pasur në emrin e tij. Në vitin 2015, në kontratën e shitjes nr. *** është kryer veprimi noterial i shitjes së automjetit, të cilin *de facto* e ka pasur në posedim që në dhjetor të vitit 2012, përfundoi subjekti.

8.7. Në kushtet që subjekti nuk e ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2012 (sikundër deklaroi), Komisioni i paraqiti të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në vitin 2015, bazuar në datën në të cilën është nënshkruar kontrata e shitjes.

8.8. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit S. M. dhe M. N. dhe nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹⁷³.

8.9. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare në datën 5.4.2012, duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe për prindërit dhe rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë ***.

8.10. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9. Transferta në shumën 9.340 euro në periudhën 1.1.2010 – 31.12.2014 dhe 1.100 euro në periudhën 1.1.2016 – 1.2.2021

9.1. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁷⁴, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kam nxjerrë jashtë shtetit për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2014... në total rreth 9.000 euro. Kjo transferë është bërë në drejtim të vëllait tim F. L. me banim në Itali, ku burim i kësaj shume janë paratë e tij, të cilat i ka pas të depozituara i ndjeri babai im F. L.. Qëllimi i kësaj transferte ka qenë për nevojat e tij familjare. Sqaroj se babai F. L. ka qenë në pamundësi fizike të bëjë vetë transaksionet, m’i ka dhënë mua personalisht që t’ia kryej”*.

9.2. Në procesverbalin e datës 15.1.2016 të ILDKPKI-së¹⁷⁵, lidhur me konfirmimin e Unionit Financiar të Tiranës se gjatë periudhës 1.1.2010 – 31.12.2014 ka kryer 18 transferime në dalje, duke dërguar 9.340 euro dhe 14.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Këto transferta*

¹⁷² Email datë 20.9.2023.

¹⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

¹⁷⁴ Email datë 24.7.2023.

¹⁷⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

janë bërë në drejtim të vëllait tim F. L. me banim në Itali dhe burimi i këtyre shumave janë paratë e tija të depozituara kohë më parë, por në numrin e llogarisë së babait F. L.”.

9.3. Në vijim, në procesverbalin e datës 4.6.2021, lidhur me konstatimin e ILDKPKI-së se gjatë periudhës 1.1.2017 – 31.12.2017 ka kryer 5 transaksione në dalje në euro në shumën 1.100 euro dhe tri transaksione në lekë në shumën 14.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “...shumat janë transferuar drejt Italisë, mbesës sime F. L. për shkollë dhe ditëlindje, si dhe kunatës F. M. (bashkëshortja e vëllait) për të na blerë ilaçe mua dhe nënës sime”.

9.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁷⁶, subjekti i rivlerësimit deklaroi se këto para i janë dërguar babait nga ana e vëllait përpara vitit 2010, kryesisht dorazi, me anë të njerëzve që vinin në Shqipëri, si dhe sa herë ka ardhur vetë. Babai nuk i ka shpenzuar të gjitha dhe një pjesë të mirë të tyre i ka ruajtur në banesë dhe në bankë. Subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi se në cilën llogari janë ruajtur shumat e dërguara nga vëllai. Më tej shpjegon se pas vitit 2010 vëllai nuk ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe, rrjedhimisht, edhe ekonomikisht e, për këtë arsye, babai i ka dërguar paratë që vetë vëllai ia kishte sjellë në kohë të ndryshme, në ndonjë rast, kur babai nuk ka pasur mundësi shëndetësore të dalë nga banesa, i ka dërguar nëpërmjet saj.

9.5. Unioni Financiar¹⁷⁷ ka përcjellë informacion të detajuar vetëm në lidhje me transaksionet që prej datës 1.1.2016 e në vijim. Referuar dokumentacionit të administruar, gjatë vitit 2016, konstatohet një dërgesë në vlerën 10.000 lekë nga subjekti në favor të shtetasit S. G.¹⁷⁸ dhe një dërgesë në vlerën 5.000 lekë nga ky shtetas në favor të subjektit.

9.6. Në kushtet e mungesës së deklarimeve lidhur me periudhën në të cilën vëllai i subjektit të rivlerësimit ka dërguar shumën 9.340 euro, Komisioni analizoi të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 2004 – 2010, paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare e vëllait për periudhën 2004 – 2010

Periudha	Të ardhura bruto	Shpenzime vjetore të familjes (5 persona)
2004	18,937 €	22,144 €
2005	17,406 €	22,533 €
2006	18,626 €	22,933 €
2007	15,826 €	23,793 €
2008	13,250 €	24,633 €
2009	12,912 €	24,579 €
2010	7,629 €	25,144 €
TOTAL	104,586 €	165,756 €
Diferenca (të ardhura-shpenzime)		-61,170 €

9.7. Sa më lart, vërehet se të ardhurat e ligjshme të vëllait të subjektit nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës për familjen e tij dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për dërgimin e shumës 9.340 euro.

9.8. Në kushtet që nga dokumentacioni i administruar rezultoi që subjekti ka dërguar shumën 9.340 euro gjatë periudhës 1.1.2010 – 31.12.2014, por nuk ka përcaktuar shumën e dërguar çdo vit kalendarik, Komisioni, në analizën financiare e shpërndau vlerën 9.340 euro në 5 vite si shpenzime të subjektit të rivlerësimit, konkretisht në vlerën 1.868 euro për secilin nga vitet 2010 – 2014.

¹⁷⁶ Email datë 28.9.2023.

¹⁷⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 12.9.2023.

¹⁷⁸ Subjekti ka deklaruar se mbesa e saj është martuar në vitin 2014 me shtetasin S. G.

10. Depozitim *cash* në shumën 900.000 lekë nga nëna e subjektit/G. L.

10.1. Nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja¹⁷⁹, rezulton se në procesverbalin e datës 25.5.2021 subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kërkesën për saktësim deklarate pasurie drejtuar këtij institucioni, ku ka deklaruar se: “Në vijim të plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, saktësot tek deklarata e personit të lidhur (nënës sime), për sa i përket një llogarie të hapur në datën 5.1.2017, në BKT, dega Shkodër, ku nga ana e saj janë derdhur 900.000 lekë dhe, më pas, janë tërhequr, por brenda po këtij viti dhe kthyer në euro nga ana e saj dhe më pas, në datën 11.10.2017, në BKT, dega Shkodër, ajo përsëri ka hapur llogari në euro, ku ka depozituar gjithsej 14.000 euro, gjë për të cilën nuk kam qenë në dijeni... nëna ime ...këto para i ka nga djali i saj F. F. L., i cili jeton dhe punon në shtetin italian në ndërtim prej 25 vitesh... Këtë sasi parash djali i saj ia ka sjellë ndër vite...”.

10.2. BKT-ja¹⁸⁰ informon se në datën 5.1.2017 shtetasja G. L. ka derdhur *cash* në llogarinë e saj shumën 990.000 lekë. Në të njëjtën datë është krijuar një depozitë me afat në të njëjtën vlerë, depozitë e cila është maturuar në datën 17.7.2017.

10.3. Komisioni vëren se nëna e subjektit të rivlerësimit ka plotësuar deklaratën *Vetting* në vitin 2017, ndërkohë që nuk figuronte në të njëjtin trung familjar me subjektin që prej datës 29.3.2016¹⁸¹, pra referuar ligjit nr. 84/2016, nuk ka pasur detyrim për deklarim.

10.4. Pavarësisht të sa më lart, në kushtet kur: (i) subjekti jeton me nënën e saj; (ii) evidentohet depozitimi *cash* i shumës 990.000 lekë nga nëna e subjektit përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting*; (iii) subjekti ka deklaruar se kjo shumë ka si burim të ardhurat e vëllait të saj ndër vite; (iv) nisur edhe nga fakti që subjekti ka deklaruar kontributin e vëllait të saj në deklaratimet periodike në krijimin e disa pasurive të paluajtshme të trajtuara më sipër – Komisioni, për të shteruar çdo dyshim lidhur me faktin nëse kjo është një pasuri e subjektit, bazuar në nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, hetoi lidhur me mundësitë financiare të vëllait të subjektit/F. L. dhe nënës së subjektit për krijimin e shumës 990.000 lekë, në datën 9.1.2017.

10.5. Në vijim, Komisioni analizoi të dhënat mbi të ardhurat e vëllait, shtetasit F. L., për periudhën 2011 – 2016, paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare e vëllait për periudhën 2011 – 2016

Periudha	Të ardhura bruto	Shpenzime vjetore të familjes
2011	4,108 €	25,154 € ¹⁸²
2012	11,127 €	25,168 €
2013	9,244 €	24,779 €
2014	10,962 €	19,856 € ¹⁸³
2015	9,722 €	19,966 €
2016	33,227 €	20,471 €
TOTAL	78,390 €	135,393 €
Diferenca (të ardhura-shpenzime)		-57,003 €

¹⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2023.

¹⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.21.

¹⁸¹ Referuar informacionit të përcjellë nga DPGJC-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2023, subjekti është shkëputur nga trungu familjar në datën 29.3.2016.

¹⁸² Familje me tre fëmijë.

¹⁸³ Familje me dy fëmijë (I. L. ka lidhur martesë në vitin 2014).

10.6. Sa më lart, vërehet se të ardhurat e ligjshme të vëllait të subjektit të rivlerësimit nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës për familjen e tij dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për dërgimin e shumës 990.000 lekë.

10.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Ka dyshime se shuma 990.000 lekë e depozituar në bankë nga nëna e subjektit në datën 5.1.2017 është pasuri e subjektit pasi: (i) Subjekti ka deklaruar kontributin e vëllait të saj në deklaratimet periodike në krijimin e disa pasurive të paluajtshme të trajtuara më sipër; (ii) Të ardhurat e ligjshme të vëllait të subjektit (të deklaruara si burim për këtë depozitim) nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës për familjen e tij dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për dërgimin e shumës 990.000 lekë; (iii) Subjekti jetonte me nënën e saj dhe kanë pasur ekonomi të përbashkët.*

10.8. Në përgjigje¹⁸⁴ të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka dhënë shpjegime të qarta dhe bindëse, për sa i përket faktit se këto pasuri nuk janë pasuri të fshehura të saj dhe nuk ka pasur arsye të fshehë pasuri në emër të vëllait, pasi në atë kohë babai i saj ka pasur të ardhura të ligjshme nga të ardhurat e tokës bujqësore dhe mbi të gjitha vëllai i saj nuk mund të konsiderohet subjekt i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, neni 3, pika 13 dhe nuk ngarkohet të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë, e cila nuk i është dhuruar apo dhënë hua.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

10.10. Subjekti, në procesverbalin e datës 25.5.2021 të ILDKPKI-së, ka deklaruar se “...*këto para i ka nga djali i saj F. F. L., i cili jeton dhe punon në shtetin italian...*” dhe, bazuar në deklaratimin e saj, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit bashkëjeton me nënën e saj dhe të ardhurat e vëllait të subjektit/F. L. janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për tri pasuri të regjistruara në emër të babait të saj, e më pas ka përfituar 1/3 pjesë të tyre me anë të trashëgimisë ligjore bazuar në nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, për të shteruar çdo dyshim hetoi mundësitë financiare të vëllait të subjektit/F. L. dhe nënës së subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës 990.000 lekë në datën 9.1.2017.

10.11. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *vëllai i saj nuk mund të konsiderohet subjekt i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk detyrohet të provojë ligjshmërinë e burimit të pasurisë, e cila nuk i është dhuruar apo dhënë hua*, Komisioni, bazuar edhe në arsyetimin e pasqyruar në pikën 4.30 të vendimit, thekson edhe një herë se nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016 autorizojnë organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit e kontrollit të pasurisë çdo situatë, fakt apo cilësi, në funksion të realizimit të qëllimit të procesit

¹⁸⁴ Email datë 22.11.2023.

të rivlerësimit, autorizim që jo detyrimisht lidhet me cilësimin e personave të tretë si persona të tjerë të lidhur. Bazuar në këto dispozita ligjore, Komisioni hetoi dhe analizoi të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit/F. L. për të verifikuar dyshimet e ngritura lidhur me burimin e krijimit të shumës së depozituar nga nëna e saj edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ngarkohet me barrën e provimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

10.12. Sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova shtesë apo shpjegime bindëse lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L. nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për dërgimin e shumës 990.000 lekë, trupi gjykues vlerëson se ka dyshime të arsyeshme se kjo shumë, e depozituar në bankë nga nëna e subjektit në datën 5.1.2017, është pasuri e subjektit.

10.13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se krijohen dyshime të arsyeshme se shuma 990.000 lekë është pasuri e subjektit të rivlerësimit, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli dhe verifikimi burimet e krijimit të saj, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

11. Depozitat ndër vite pranë BKT-së

11.1. Nga analizimi i informacionit të përcjellë nga BKT-ja¹⁸⁵, Komisioni konstatoi se në llogarinë dyemërore të subjektit me babain e saj, në fillim të vitit 2002 evidentohen tri kreditime, konkretisht: (i) datë 26.8.2002, vlera 628,40 euro; (ii) datë 26.8.2002, vlera 5.258,28 euro; (iii) datë 7.10.2002, vlera 1.045,13 euro.

11.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁸⁶, subjekti deklaroi se depozita pranë BKT-së është çelur në datën 1.1.2002 në emrin e saj dhe të babait dhe se shumata e derdhura në këtë llogari janë xhirim/shuma të transferuara nga depozita me afat që ka pasur pranë kësaj banke para vitit 2000. Subjekti nuk kujton datat kur janë depozituar fondet. Si burim krijimi për depozitat, subjekti deklaroi kursimet nga të ardhurat familjare (paga ndër vite, të ardhurat e siguruar nga babai nga shitjet e prodhimeve të tokës në fshatin ***).

11.3. BKT-ja¹⁸⁷ bëri me dije se pas privatizimit të bankës të gjitha tepricat në llogaritë e klientëve u kaluan nga sistemi i vjetër në sistemin e ri të BKT-së dhe se transaksionet e sipërcituara i përkasin këtij rasti. Ky informacion i përket periudhës kur banka ende nuk ishte privatizuar dhe, për rrjedhojë, banka nuk e disponon dokumentacionin përkatës lidhur me datën e krijimit dhe interesat e përfituar.

11.4. Në kushtet e mungesës së informacionit lidhur me datën e saktë të krijimit të këtyre depozitave, Komisioni u bazua në deklarinë e subjektit se këto depozita janë krijuar para vitit 2000 dhe kreu analizën financiare për periudhën 1994 – 2000, për verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e shumës 6.931,81 euro, paraqitur në tabelën vijuese.

¹⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2021.

¹⁸⁶ Email datë 28.9.2023.

¹⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2023.

Tabela nr. 7 – Analiza financiare për periudhën 1994 – 2000

Përshkrimi	Vlerë
Depozitat e mbartura në BKT ¹⁸⁸	919,019
Total pasuri	919,019
Të ardhura nga paga subjekti ¹⁸⁹	1,863,168
Total të ardhura	1,863,168
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT ¹⁹⁰	546,178
Total shpenzime	546,178
Balanca e fondeve (të ardhura-shpenzime-pasuri)	397,971

11.5. Sa më lart, rezulton se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e depozitave pranë BKT-së.

11.6. Më tej, Komisioni vëren se këto depozita kanë pësuar ndryshime gjatë viteve (pasqyruar në tabelën nr. 9 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht), të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat periodike përkatëse. Megjithatë, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e tyre, trupi gjykues vlerëson se pasaktësia në deklaratimet periodike vjetore nuk ndikon në vlerësimin e tyre në kuadër të procesit të rivlerësimit.

11.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika për këto pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

12. Shpenzime mjekësore në vitin 2016 në Itali

12.1. Referuar dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja, rezultoi se subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me kontrole mjekësore, diagnostikime, përgjigje analizash etj., të kryera në Itali. Në këtë dokumentacion nuk evidentohet shuma e shpenzuar.

12.2. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁹¹, i kërkoi subjektit të deklarojë shumën e shpenzuar për çdo vit kalendarik, si dhe të paraqesë dokumentacion provues për shumën e paguar.

12.3. Në përgjigje¹⁹², subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka bërë asnjë shpenzim, pasi është e pajisur me dokumente italiane, “*Permesso di Soggiorno*” dhe kartë shëndeti italiane, dhe se të vetmet shpenzime që ka bërë kanë qenë biletat e udhëtimit. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti dokumentin “*Permesso di soggiorno*”, nr. ***, i cili mban datën e lëshimit 20.9.2021.

12.4. Komisioni vëren se në dokumentacionin bashkëlidhur procesverbalit të ILDKPKI-së është administruar kopje e leje qëndrimit nr. ***, me datë lëshimi 7.2.2019, ndërkohë që bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në procesverbalin e ILDKPKI-së, vizitat dhe kontrollet janë kryer në dhjetor të vitit 2016.

12.5. Sa më lart, Komisioni, në fazën e hetimit arriti në përfundimin se *shpjegimi i subjektit që nuk ka kryer shpenzime në vitin 2016 për mjekimin e marrë në Itali për arsye se ka qenë pajisur me leje qëndrimi nuk përputhet me dokumentacionin justifikues, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti deri në këtë fazë të hetimit i përket një periudhe të mëvonshme.*

¹⁸⁸ Shuma totale e vlerave të mbartura (6.931,81 euro) shumëzuar me kursin e këmbimit sipas faqes zyrtare në Bankën e Shqipërisë (1 euro = 132,58 lekë).

¹⁸⁹ Vërtetimi të ardhurash Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁹⁰ Përlllogaritje shpenzime jetese për 1 person (subjekti), në masën 30% të të ardhurave të subjektit për periudhën 1994 – 1999. dhe sipas shkresës së ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 4.3.2019, për vitin 2000.

¹⁹¹ Email datë 20.9.2023.

¹⁹² Datë 28.9.2023.

12.6. Në përgjigje¹⁹³ të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se dokumentet i ka marrë për herë të parë në datën 18.4.2016. Për të provuar këtë fakt, i është drejtuar me *email* Zyrës së Emigracionit, Kuestura Varese, e cila me *email*-in e datës 21.11.2023 konfirmon se është pajisur me dokumente në datën 18.4.2016.

12.7. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së korrespondencës elektronike të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se Kuestura e Vareses, Itali, me *email*-in e datës 21.11.2023 konfirmon se subjekti është pajisur me leje qëndrimi në datën 18.4.2016.

12.8. Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova dhe shpjegime bindëse për datën kur është pajisur me leje qëndrimi në Itali e, për pasojë, nuk konstatohen problematika lidhur me shpenzime mjekësore në vitin 2016 në Itali.

12.9. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika për sa i përket shpenzimeve mjekësore të subjektit të rivlerësimit në vitin 2016, në Itali, që lidhen me procesin e rivlerësimit.

13. Adresat e banimit

13.1. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁹⁴, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga fundi i vitit 1996 dhe deri në fund të vitit 2001 ka banuar tek halla e saj, znj. V. Sh., me banim në Shkodër, pa qira dhe asnjë detyrim, përveç shpenzimeve të jetesës. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur një deklaratë të lëshuar nga ana e kësaj shtetaseje, në datën 20.1.2001, deklaratë e thjeshtë, me shkrim dore.

13.2. Më tej, nga viti 2001 e në vijim, ka jetuar në banesën e vëllait, banesë kjo e blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., pa asnjë detyrim¹⁹⁵. Komisioni vëren se kjo kontratë i përket blerjes së apartamentit me sipërfaqe 74 m².

13.3. Nga viti 2001¹⁹⁶ e në vazhdim ka jetuar me prindërit (me babain deri në datën 1.8.2016, datë në të cilën ka ndërruar jetë, ndërsa aktualisht vazhdon të jetojë së bashku me nënën)¹⁹⁷.

13.4. Në DIPP-të vjetore 2003 – 2016 ka deklaruar si adresë banimi/regjistrimi në gjendjen civile “Lagjja “***”, rruga “***”, p. ***, Shkodër”, ndërsa në deklaratën *Vetting* 2017 ka deklaruar adresën Bashkia Shkodër, rruga “***”.

13.5. Sa më lart, referuar deklarimeve në pyetësorin standard dhe në pyetësorin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka jetuar në apartamentin me sip. 74 m², së bashku me prindërit e saj, që prej vitit 2001.

13.6. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹⁹⁸, subjekti ka deklaruar se ka jetuar në apartamentin me sip. 47 m² deri në vitin 2022¹⁹⁹ dhe, më tej²⁰⁰, ka shpjeguar se banesa ku ka

¹⁹³ *Email* datë 22.11.2023.

¹⁹⁴ *Email* datë 24.7.2023.

¹⁹⁵ Subjekti ka deklaruar: “Nga viti 2001 e në vazhdim kam jetuar në lagjen “***”, rruga “***”, Shkodër, tek banesa e vëllait tim (banesë kjo e blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., pa asnjë detyrim, pasi ai jetonte në Itali dhe unë kam qëndruar në atë banesë”.

¹⁹⁶ Në pyetësorin standard ka deklaruar se vitin 2011, por në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaroi se viti 2011 është lapsus dhe se në çdo deklaram që ka bërë ka theksuar faktin se nga viti 2001 e në vijim ka jetuar së bashku me prindërit.

¹⁹⁷ Lidhur me adresat e banimit të prindërve, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se ata kanë jetuar nga viti 1994 deri në vitin 2001 në fshatin ***, Bashkia Shkodër, e më tej, nga viti 2001 deri në vitin 2017 në adresën rruga “***”, ndërtesa ***, h. ***, ap. ***, Shkodër (pra, apartamenti me sip. 74 m²).

¹⁹⁸ *Email* datë 11.10.2023.

¹⁹⁹ Në përgjigje të pyetjes nr. 1 të pyetësorit nr. 2, lidhur me apartamentin me sip. 47 m², subjekti ka deklaruar se apartamenti në fjalë është përdorur për jetesë deri në vitin 2022 nga ana e saj.

²⁰⁰ Në përgjigje të pyetjes nr. 4 të pyetësorit nr. 2.

jetuar deri në vitin 2022 ka qenë ngjitur me banesën e prindërve, madje kanë pasur dhe derë komunikuese mes banesave. Pra, fizikisht, vijon shpjegimin subjekti i rivlerësimit, kanë qenë pothuajse të ndarë, por ekonomikisht kanë qenë bashkë, pasi prindërit e saj ishin në moshë, kishin nevoja të vazhdueshme mjekësore dhe nuk kishte logjikë që t'i linte vetëm e as të kishte ekonomi të ndarë prej tyre.

13.7. Komisioni vëren se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me apartamentin ku ka jetuar duke filluar nga viti 2001, pasi në pyetësin standard ka deklaruar që ka banuar në apartamentin me sip. 74 m², ndërsa në pyetësin nr. 2 ka deklaruar se ka banuar në apartamentin me sip. 47 m².

13.8. Në përgjigje²⁰¹ të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se në bazë të shkresës nr. *** prot., datë 16.11.2023, të Bashkisë Shkodër, adresat në fjalë i referohen të njëjtës adresë, e cila është e riemërtuar. Për sa i përket mospërputhjes ndërmjet deklarimeve të saj në pyetësin standard dhe në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit sqaron se janë lapsuse të bëra nga ana e saj, por thekson se banesa ku ka jetuar ka qenë ajo me sipërfaqe 47 m². Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur si provë shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2023, të Bashkisë Shkodër.

13.9. Rezulton se në shkresën e mësipërme Bashkia Shkodër sqaron se bazuar në adresarin e ri janë hequr emërtimet e vjetra, si lagjja “****” dhe banesa e subjektit ndodhet në adresën: Lagjja Nr. **, rruga “****”, nd. **, ap. **, kodi postar **, Shkodër.

13.10. Sa më sipër, Komisioni çmon se pasaktësitë e deklarimeve të subjektit në DIPP-të vjetore lidhur me adresën e banimit dhe deklarimet e saj kontradiktore në pyetësin standard dhe në pyetësin nr. 2 sa i përket apartamentit ku ka banuar nuk ndikojnë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të rivlerësimit të pasurisë.

13.11. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit që ndikojnë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të rivlerësimit të pasurisë.

14. Analiza financiare

14.1. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën dhjetor 1994 – 2016, duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin dhe prindërit, duke marrë në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar me prindërit gjatë periudhës 2001 – 2017 (e, më tej, me nënën nga viti 2022 e në vijim) dhe se kanë pasur ekonomi të përbashkët, si dhe duke konsideruar që subjekti dhe babai kanë pasur llogari bankare dyemërore. Gjithashtu, Komisioni vendosi në dispozicion të subjektit të rivlerësimit aneksin nr. 1, me emërtimin “Analiza financiare e detajuar” dhe aneksin nr. 2, me emërtimin “Metodika e analizës financiare”.

14.2. Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe babai kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në datat e krijimit të pasurive, në një vlerë totale prej 3.090.450 lekësh, të detajuar si në vijim: (i) Në vitin 2004, subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve*

²⁰¹ Email datë 22.11.2023.

të ligjshme financiare në vlerën 2.100.000 lekë për pagesën e këstit të parë prej 2.107.500 lekësh për apartamentin me sip. 171,3 m², pasi për të ardhurat e deklaruar si burim (depozitimi i vlerës 2.100.000 lekë, në datën 31.12.2004, në llogarinë dyemërore në BKT) nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore (barra e provës, kaluar në paragrafin 6.65); (ii) Në vitin 2005, subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 500.000 lekë, në llogarinë dyemërore pranë BKT-së, në datën 6.7.2005, pasi nuk provohet arkëtimi i këstit të dytë nga shitja e banesës në fshatin ***, si dhe nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura (barra e provës kaluar në paragrafin 6.65); (iii) Në vitin 2012, subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 490.450 lekë për pagesën e këstit të dytë prej 5.000 euro për apartamentin me sip. 171,3 m², pasi si burim për këtë pagesë mund të ketë shërbyer vetëm shuma prej 200.000 lekësh, e tërhequr nga llogaria dyemërore në BKT, në vitin 2012, përpara datës së pagesës së këstit (690.450 lekë – 200.0000 lekë). (Barra e provës kaluar në paragrafin 6.65).

14.3. Në përgjigje²⁰² të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka dhënë shpjegime dhe prova shteruese në pikat e mësipërme, për sa i përket këtyre konstatimeve.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

14.4. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

14.5. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova shtesë apo shpjegime bindëse lidhur me konstatimet e rezultateve të hetimit, për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme financiare për pagesën e këstit të parë në vlerën 2.100.000 lekë dhe këstit të dytë prej 490.450 lekësh për blerjen e apartamentit me sip. 171,3 m², si dhe mungesës së burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 500.000 lekë, në llogarinë dyemërore në BKT, në datën 6.7.2005.

14.6. Sa më sipër, Njësia e Shërbimit Ligjor, bazuar në arsyetimet e pasqyruara në pikën 6 të vendimit, kreu analizën financiare për subjektin dhe prindërit²⁰³, si në tabelën vijuese.

²⁰² Email datë 22.11.2023.

²⁰³ Pa përfshirë mungesën e burimeve të vëllait për të dyja apartamentet e blera nga babai, me sip. 74 m² dhe 47 m².

Tabela nr. 8 – Analiza financiare (subjekti dhe prindërit)

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit	Balanca negative në momentin e krijimit
1994-2003	800,000	0	254,820	4,504,843	0	1,836,143	1,613,880	0	
2004	0	329,524	2,178,072	1,144,464	0	281,592	-1,644,724	-1,644,724	-2,429,524
2005	0	0	888,273	1,207,701	0	359,306	-39,878	-39,878	-500,000
2006	0	0	395,984	1,174,510	0	368,874	409,651	0	
2007	0	0	-544,357	1,252,098	0	711,440	1,085,016	0	
2008	0	0	56,648	1,251,560	0	494,240	700,672	0	
2009	0	0	-58,105	1,491,431	0	427,006	1,122,530	0	
2010	0	0	-510,132	1,459,591	0	676,098	1,293,626	0	
2011	2,107,500	0	-1,754,494	2,352,676	298,500	1,308,707	989,462	0	
2012	1,737,600	0	-320,972	1,678,894	0	700,137	-437,871	-437,871	-490,450
2013	3,444,000	0	-504,077	1,578,625	3,500,000	1,003,398	1,135,304	0	
2014	0	0	29,959	1,773,733	0	1,291,630	452,143	0	
2015	0	0	37,029	1,930,928	0	1,026,472	867,427	0	
2016	0	0	-381,853	1,651,146	0	1,062,609	970,390	0	
TOTAL	8,089,100	329,524	-233,205	24,452,200	3,798,500	11,547,653	8,517,628	-2,122,473	-3,419,974

14.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 329.524 lekë për krijimin e likuiditeteve *cash* në vitin 2004; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vitet 2004 dhe 2005, në një vlerë totale prej 2.600.000 lekësh, për depozitimet e kryera në llogarinë dyemërore në BKT²⁰⁴; (iii) babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 490.450 lekë për blerjen e pasurisë apartament me sip. 171,3 m². Mungesa e burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit me sip. 171,3 m², e vlerësuar në tërësi me rrethanat e tjera të pasqyruara në pikën 6.91 të vendimit, krijoi bindjen te trupi gjykues se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 dhe gjatë hetimit administrativ janë bërë në funksion të fshehjes së të drejtës së plotë të pronësisë për këto pasuri, me qëllim shmangien nga kontrolli i burimit të krijimit të tyre.

15. Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

15.1. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:

- *Lidhur me pasurinë tokë arë me sip. 5.500 m², me vendndodhje fshati ***, Shkodër, në bashkëpronësi,* nuk konstatohen problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

- *Lidhur me pasurinë tokë arë me sipërfaqe 2.715 m², me vendndodhje fshati ***, Shkodër, në bashkëpronësi* nuk konstatohen problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

- *Lidhur me pasuritë apartament me sip. 74 m² dhe sip. 47 m²,* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë bashkëpronësinë me 1/3 pjesë nga trashëgimia ligjore e babait të saj, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

- *Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf”,* deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare.

- *Lidhur me depozitimet e kryera në llogarinë dyemërore në BKT,* subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.600.000 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

²⁰⁴ Nga të cilat 2.100.000 lekë janë përdorur si burim për blerjen e pasurisë apartament me sip. 171,3 m².

- *Lidhur me pasuritë dy apartamente banimi në vlerën 113.000 euro, në Shkodër*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën *Vetting 2017* bashkëpronësinë me 1/3 pjesë nga trashëgimia ligjore e babait të saj, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, dhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

- *Lidhur me huan nga mbesa në shumën 2.600 euro, në vitin 2004*, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën 2.600 euro në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga shkronja “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- *Lidhur me pasurinë automjet tip “Opel”, në shumën 2.500 euro, në vitin 2012*, nuk konstatohen problematika për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

- *Lidhur me depozitim cash të shumës 990.000 lekë nga nëna e subjektit/G. L.*, krijohen dyshime të arsyeshme se kjo shumë është pasuri e subjektit të rivlerësimit, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli dhe verifikimi burimet e krijimit të saj, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

15.2. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Françeskina Lekani ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësim të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport me shënimin “Sekret”.

2. Komisioni kërkoi nga AKSIK-ja deklasifikimin e raportit mbi kontrollin e figurës së znj. Françeskina Lekani, si dhe përditësimin e raportit me informacionet shtesë. AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2023, ka përcjellë raportin për subjektin e rivlerësimit të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 5.10.203, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

3. Sipas raportit, për subjektin e rivlerësimit Françeskina Lekani disponohen të dhëna mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e ndërveprimit korruptiv. Në përfundim, AKSIK-ja gjykon që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponojë si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga AKSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton si më poshtë:

4.1. DPGJC-ja²⁰⁵ informon se sipas aktit të lindjes subjekti ka këto të dhëna: F. L., atësia F., amësia G., datëlindja 14.11.1963. Në vijim sqaron se nga verifikimet e kryera në ZGJC ***,

²⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2023.

Bashkia Shkodër, në regjistrin themeltar të shtetasve në fshatin *** është bërë ndryshimi i emrit nga F. në F., por për këtë veprim nuk rezultoi asnjë shënim apo dokumentacion.

4.2. Në vijim, rezultoi se në formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, subjekti ka deklaruar si gjeneralitete të mëparshme emrin “Franka”.

4.3. Sa më sipër, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit të deklaronte kohën kur e ka bërë ndryshimin e emrit nga “Franka” në “Françeskina”, si dhe të paraqesë aktin mbi bazën e të cilit është bërë ky ndryshim.

4.4. Në përgjigje²⁰⁶, subjekti ka deklaruar se: *“Në momentin e lindjes në Zyrat e Gjendjes Civile jam regjistruar me emrin Franka Lekani, por që në lindje më kanë thirrur Françeskina, siç ka dashur gjyshi, por për shkak të regjimit prindërit nuk janë lejuar të më regjistrojnë me këtë emër. Në vitin 1991, me ardhjen e demokracisë jam krezmuar në Kishë me emrin Françeskina Lekani, emër të cilin e kam pasur që në momentin që jam pagëzuar kur kam lindur. Pas kësaj, unë personalisht jam paraqitur në zyrat e Gjendjes Civile Mes, ku në bazë të ligjit të atëhershëm, para punonjësit të gjendjes civile kam shprehur vullnetin për ndryshim e emrit, kam bërë pagesën, e cila me sa kujtoj ka qenë 500 lekë (të vjetra) dhe më pas janë bërë shënimet në regjistrin përkatës. Ndryshimin e kam bërë pa asnjë arsye, por thjesht për shkak se të afërmit dhe familja ime më kanë thirrur gjithnjë me këtë emër dhe jo emrin me të cilin isha e regjistruar”*. Për vërtetimin e deklarimit ka paraqitur vërtetimin e pagëzimit nr. *** prot., viti 2022, lëshuar nga Arqidioqezja Metropolitane Shkodër – Pult, ku në rreshtin ku pasqyrohen të dhënat e të pagëzuarit është shënuar “Françeskina (Franka) Lekani”.

4.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, konstatohet se në informacionin e ISHSH-së Shkodër²⁰⁷ lidhur me të ardhurat neto nga paga dhe shpërblimet gjatë kohës që subjekti ka punuar në Ndërmarrjen Pyjore Shkodër për vitet 1982 – 1993, si dhe në Kooperativën Bujqësore Postribë 1987 – 1991 gjeneralitetet e subjektit janë “Franka F. Lekani”.

4.6. DPGJC-ja²⁰⁸ ka përcjellë certifikatën e gjendjes familjare të shtetasit F. L. në datën 1.8.1991, ku subjekti pasqyrohet me gjeneralitetet “Frankë Lekani”.

4.7. Në dosjen personale të subjektit të administruar nga KLP-ja²⁰⁹ konstatohet se në shkresën nr. *** prot., datë 7.7.1994, të Prokurorisë së Përgjithshme, “Për emërim kuadri”, me anë të së cilës subjekti është emëruar si prokurore ushtarake në Prokurorinë e Rrethit Shkodër, subjekti pasqyrohet me gjeneralitetet “Françeskina Lekani”. Më pas, në shkresën nr. *** prot., datë 4.9.1995, të Prokurorisë së Përgjithshme “Për emërim kuadri”, me anë të së cilës subjekti është emëruar prokurore ushtarake në Prokurorinë Ushtarake Shkodër, pasqyrohet me gjeneralitetet “Françeska Lekani” dhe në urdhrin nr. ***, datë 27.11.2008, të ministrit të Mbrojtjes, “Për dalje në lirim”, subjekti pasqyrohet me gjeneralitetet “Françeskina Lekani”.

4.8. Në vijim, në certifikatën e gjendjes familjare të datës 7.9.2011 të shtetasit F. L., subjekti pasqyrohet me gjeneralitetet “Françeskina Lekani”.

²⁰⁶ Email datë 28.9.2023.

²⁰⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2016.

²⁰⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 1.8.2023.

²⁰⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.9.2023.

4.9. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime për konstatimin se: *Mbetet e paqartë koha kur subjekti ka ndryshuar emrin nga Franka në Françeskina.*

4.10. Në përgjigje²¹⁰, subjekti i rivlerësimit sqaron se sipas letërnjoftimit nr. ***, të lëshuar në datën 12.10.1991, vërtetohet se ndryshimi i emrit përkon me po këtë datë, pasi në të njëjtën ditë që ka ndryshuar emrin është pajisur me letërnjoftimin e ri dhe se shpjegimet më të hollësishme i ka dhënë në pyetësorët e mëparshëm. Bashkëlidhur ka vënë në dispozicion një kopje të letërnjoftimit të cituar më sipër, si dhe kopje të certifikatës familjare të datës 22.11.2023, në të cilën pasqyrohet gjendja familjare e shtetasit F. L. sipas regjistrimit themeltar të vitit 1974.

4.11. Nga shqyrtimi i certifikatës familjare të datës 20.11.2023, rezulton se në gjendjen familjare të shtetasit F. L. emri i subjektit të rivlerësimit pasqyrohet “Frankë”. Gjithashtu, në këtë dokument pasqyrohet shënimi “Françeskina ka bërë korrigjim emri nga “Frankë në Françeskina”, pa shënime të tjera. F. dhe Françeskina shpërngulje në Bashkinë Shkodër, datë 10.3.1992”.

4.12. Në vijim, në letërnjoftimin “****”, të lëshuar në datën 12.10.1992, emri i subjektit të rivlerësimit pasqyrohet “Françeskina”.

4.13. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe ka paraqitur dokumentacionin justifikues që provon se e ka ndryshuar emrin e saj në vitin 1992.

4.14. Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Françeskina Lekani.

3. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave

²¹⁰ Email datë 22.11.2023.

nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

5. Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit Françeskina Lekani ka punuar si oficer i policisë gjyqësore e, më pas, me vendimin nr. ***, datë 1.7.1994, të KLD-së, është emëruar prokuror ushtarak në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pas suprimimit të gjykatave ushtarake²¹¹, subjekti ka kaluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e shortuara rezulton se prokurorja Françeskina Lekani shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit, si dhe shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Në dosjet e vëzhguara konstatohet se e ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret, si dhe identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit Françeskina Lekani për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve penale të shortuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti i rivlerësimit organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente me faktet e parashtruara në akt dhe bazën ligjore të përdorur gjatë arsyetimit, si dhe tregon vëmendje që aktet e përgatitura të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike.

Hetimi i Komisionit

6. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dosjen nr. 3 të shortuar, si vijon:

7. Lidhur me dosjen nr. ***, që i përket procedimit penal nr. ***, datë 27.6.2016, i regjistruar për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve të gjahut”, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka urdhëruar dërgimin e armëve të gjahut të sekuestruara në banesën e shtetasit P. K. në laboratorin kriminalistik, për të zbuluar nëse janë përdorur për ngjarje kriminale sipas parashikimeve të neneve 178 e 183 të Kodit të Procedurës Penale.*

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²¹², subjekti i rivlerësimit shpjegon se procedimi penal në fjalë nuk ka qenë një procedim i filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, por ka ardhur si procedim i ndarë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila ka sjellë për

²¹¹ Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

²¹² Email datë 22.11.2023.

kompetencë vetëm faktin e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, pasi veprimet e tjera hetimore janë kryer nga Prokuroria e Rrethit Lezhë. Gjithashtu, sqaron se sistemi automatik i databazës në IPSH nuk mban të regjistruara të dhënat e gëzhojave të armëve të gjahut të ngjarjeve të mëparshme. Për këtë arsye, krahasimi nëse një armë gjahu është përdorur apo jo në ngjarje të mëparshme, është i pamundur dhe nuk bëhet në asnjë rast.

Analiza e Komisionit

9. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në datën 2.1.2016 ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të gjahut”, të parashikuara nga nenet 78 e 280 të Kodit Penal lidhur me vrasjen e shtetasit D. L., ku dyshohet se vrasja është bërë me armë gjahu. Për shkak të dyshimeve të ngritura, organi i akuzës, pasi ka marrë miratimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka urdhëruar kontrollin e banesës së shtetasit P. K.. Nga kontrolli i ushtruar në banesën e të dyshuarit në ***, Bashkia Shkodër, janë gjendur armët e gjahut “Mosberd” e “Benelli”, një armë pa mbishkrime e numër, si dhe 90 fishekë. Është kryer ekspertimi teknik i armëve dhe ka rezultuar se armët e gjahut “Mosberd” dhe “Benelli” janë në gjendje të rregullt teknike dhe realizojnë qitje normalisht, ndërsa arma pa mbishkrime e numër nuk hapet dhe nuk mund të përcaktohet gjendja teknike. Më pas, prokurori i çështjes ka regjistruar emrin e shtetasit P. K. si person që i atribuohet vepra penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal dhe ka vendosur ndarjen e procedimit penal të regjistruar për vrasjen e shtetasit D. L., duke marrë si person nën hetim shtetasin P. K. për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, si dhe ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve të procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

10. Bazuar në aktet e përcjella, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit P. K. për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal. Pasi ka administruar informacionin nga Drejtoria e Policisë Shkodër se armët e gjahut të gjendura në banesën e shtetasit P. K. ishin të regjistruara në emër të tij dhe për to ishte pajisur me leje, subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 8.9.2016 ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të të dyshuarit, me arsyetimin se nuk janë konsumuar elementet e figurës së veprës penale, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal.

11. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale konstatohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në kërkesën drejtuar gjykatës për kontrollin e banesës së shtetasit P. K., ka arsyetuar se ky shtetas është person për të cilin ka dyshime për vepra penale të rënda, është person që disponon armë gjahu, ku nga të dhënat operative rezulton se ka aftësi në përdorimin e tyre, si dhe ka theksuar që shtetasi D. L. është vrarë pikërisht përmes përdorimit të armës së gjahut. Gjithashtu, konstatohet se shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë nuk kanë marrë vendim për ekzaminimin e armëve të sekuestruara në laboratorin kriminalistik, për të zbuluar nëse janë përdorur në vrasjen e shtetasit D. L. apo në ngjarje të tjera kriminale. Gjithashtu, pas ardhjes së dosjes penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, subjekti i rivlerësimit, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, nuk ka urdhëruar dërgimin e armëve të gjahut të gjendura në shtëpinë e shtetasit P. K. për ekzaminim në laboratorin kriminalistik, për të zbuluar nëse janë përdorur në ngjarje kriminale sipas parashikimeve të

neneve 178 dhe 183²¹³ të Kodit të Procedurës Penale, por është mjaftuar me verifikimin e faktit nëse këto armë janë të regjistruara në Drejtorinë e Policisë dhe për emrin e personit që i posedon.

12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Rezulton se subjekti i rivlerësimit Françeskina Lekani për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 ka trajtuar 533 çështje. Nga analizimi i të dhënave konstatohet se ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuar dhe numrin total të çështjeve të përfunduara për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Rezulton se subjekti i rivlerësimit Françeskina Lekani kryen veprime procedurale hetimore produktive, të cilat janë në përputhje me dispozitat ligjore. Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurores në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e saj të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në drejtim të rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale janë përpiluar dhe strukturuar në respektim të normave të drejtshkrimit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe nga dosjet e hedhura me short, rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit lidhur me kryerjen e veprimeve apo mbajtjen e qëndrimeve jo në përputhje me etikën e prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar.

²¹³ Kodi i Procedurës Penale, neni 178: “1. Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave, ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore...”.
Neni 183: “1. Organi procedues, pasi sigurohet për identitetin e ekspertit, e pyet nëse ka shkaqe përjashtimi nga detyra e ekspertit, e paralajmëron për detyrimet e përgjegjësitë e parashikuara nga ligji penal, i formulon kërkesat e ekspertimit dhe e fton të bëjë këtë deklaratë: “I vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që marr përsipër, do ta kryej atë me ndershmëri e drejtësi dhe do të ruaj sekretin për të gjitha veprimet që lidhen me ekspertimin”.

Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësia e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short vihet re se komunikimi është i qartë dhe në përputhje me etikën e prokurorit.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nga vlerësimet e punës për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë bashkëpunuese.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Nga të dhënat në dosjen personale, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në 5 trajnime, të cilat kanë lidhje me detyrën e prokurorit.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme

13. Nga verifikimi i të dhënave në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se ndaj subjektit Françeskina Lekani, me urdhrin nr. ***, datë 31.7.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.

14. Nga informacioni i administruar nga KPL-ja rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ndaj subjektit të rivlerësimit Françeskina Lekani janë regjistruar këto çështje: kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2016; kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2016; kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2014; kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2016, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Hetimi i Komisionit

15. Komisioni, duke u bazuar në nenin 42²¹⁴, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton se burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve parashikohen në ligjin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe nenin 77²¹⁵, shkronja “ë” e ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet se si burim vlerësimi shërbejnë edhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit, që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, pasqyroi rrethanat e dhënies së masës disiplinore “Vërejtje” nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2014 ndaj subjektit të rivlerësimit, duke e vlerësuar në tërësi me gjetjet e tjera që janë konstatuar në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale.

16. Gjithashtu, Komisioni mori në shqyrtim kallëzimet penale ndaj subjektit të rivlerësimit, të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dosjen penale të administruar në kuadër

²¹⁴ Ligji nr. 84/2016, neni 42: “1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

²¹⁵ Ligji nr. 96/2016, neni 77: “Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime: ...ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo”.

të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2014 dhe për dosjen penale të administruar në kuadër të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2016.

17. Më tej, Komisioni, pasi u njoh nëpërmjet mediave elektronike²¹⁶ lidhur me kallëzimet penale të shtetasve D. M. dhe L. Z., mori në shqyrtim vendimin dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2020 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Gjetjet nga shqyrtimi i materialeve kallëzuese dhe i dokumenteve të administruara pasqyrohen si më poshtë:

18. *Lidhur me masën disiplinore të vitit 2014* – Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 30.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër²¹⁷, rezulton se në datën 26.9.2012, shtetasi F. Z., së bashku me babain e tij, kanë shkuar për të prerë dru në vendin e quajtur ***. Rreth orës 13:00, pasi kanë prerë drutë, në momentin që janë nisur për të shkuar në banesë, janë takuar me shtetasin A. D.. Mes tyre ka filluar debati në lidhje me pronësinë e tokës dhe në debat e sipër shtetasi F. Z. ka nxjerrë nga brezi një armë zjarri pistoletë dhe ka qëlluar disa herë në drejtim të shtetasit A. D., duke e plagosur rëndë. Shtetasi A. D. është transportuar në spital dhe, më pas, ditën e nesërme, ka vdekur në Spitalin Ushtarak Tiranë. Nga akti i ekspertimit mjekoligjor i datës 4.12.2012 ka rezultuar se *në trupin e viktimës konstatohen plagë me armë zjarri tejshpuese dhe depërtuese, këto dëmtime janë shkaktuar nga predhat armë zjarri jo nga një qitje e vetme. Drejtimi i qitjes është nga përpara mbrapa dhe nga e majta në të djathtë, ndërsa distanca nuk mund të përcaktohet. Shkaku i vdekjes së shtetasit A. D. ka qenë shoku i rëndë traumatik-hemorragjik si pasojë e dëmtimeve të organeve të gjoksit dhe barkut*”.

19. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal, duke e akuzuar të pandehurin për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 88/2²¹⁸ dhe 278/2²¹⁹ të Kodit Penal. Gjatë gjykimit, gjykata ka pranuar kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 30.4.2013, ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprat penale të cituara më sipër dhe, pasi i ka zbritur 1/3 e dënimit, e ka dënuar përfundimisht me 7 vite burgim.

20. Mbi bazën e ankimit të shtetasit N. D., Prokuroria e Përgjithshme ka filluar procedimin disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit. Në përmbajtjen e urdhrin për dhënien e masës disiplinore pasqyrohet se *kualifikimi ligjor i veprës penale në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen në ngarkim të autorit, është në kundërshtim flagrant me të dhënat që dalin nga aktet e fashikullit dhe dispozitat e Kodit Penal. Plagët e shumta me armë zjarri që i janë shkaktuar viktimës, shumica e tyre në organe jetike, si në gjoks, bark dhe shpinë, tregojnë se qëllimi i vetëm i autorit ka qenë vdekja e viktimës. Nga ana objektive autori i ka kryer të gjitha veprimet, të cilat kanë sjellë si pasojë vdekjen e shtetasit A. D.. Pavarësisht vdekjes jo të menjëhershme të viktimës, por pas disa orësh për shkak të shokut të rëndë traumatik-hemorragjik nga plagët e shkaktuara me armë zjarri, është më se e qartë se ndodhemi para veprës penale të vrasjes.*

21. Në vijim pasqyrohet se prokurorja në përfaqësimin e çështjes në gjykatë nuk ka mbajtur qëndrimin e duhur ligjor në lidhje me kërkesën për masë dënimi për veprën penale

²¹⁶https://*** /ky-eshte-prokurori-i-ri-qe-hetoi-vjedhjen-e-pronave-ne-velipoje-por-u-sabotua-nga-koleget/

²¹⁷ Administruar nga faqja elektronike gjykata.gov.al

²¹⁸ “Plagosja e rëndë me dashje”, me pasojë vdekjen.

²¹⁹ “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”.

“Armëmbajtja pa leje”, pasi ka injoruar rrethanat e kryerjes së veprës penale, ku autori e ka përdorur armën dhe ka kërkuar një dënim prej pak më shumë se 1/4-ta e maksimumit të dënimit, që parashikonte dispozita e kohës. Gjithashtu, pasqyrohet se prokurorja nuk ka zbatuar me korrektësi nenin 55 të Kodit Penal mbi bashkimin e dënimeve, pasi rrethanat në të cilat janë realizuar të dyja veprat penale nga autori, si “Plagosja e rëndë me pasojë vdekjen” (sipas akuzës të ngritur nga prokurorja), ashtu edhe “Armëmbajtja pa leje”, që tregojnë një rrezikshmëri të lartë të autorit, çka impononte që prokurorja duhet t’i ishte referuar paragrafit të dytë të dispozitës së kohës për aplikimin e dënimit më të rëndë të shtuar.

22. Në përfundim, duke marrë në konsideratë karrierën e gjatë të prokurores, faktin se nuk është ndëshkuar asnjëherë me masë disiplinore, si dhe faktin që gjykata e ka gjetur të drejtë kualifikimin ligjor të prokurores, për veprën penale objekt gjykimi, Këshilli i Prokurorisë me shumicë votash ka sugjeruar të merret masa disiplinore “Vërejtje”. Më pas, Prokurori i Përgjithshëm, duke marrë në konsideratë karakterin e shkeljeve dhe mendimin e Këshillit me urdhrin nr. ***, datë 31.7.2014, ka urdhëruar që prokurores Françeskina Lekani t’i jepet masa disiplinore “Vërejtje”.

23. Lidhur me dosjen penale të administruar në kuadër të kallëzimit penal nr. * të vitit 2014**, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit, për konstatimin se: (i) *Konkluzioni i subjektit në vendimin e datës 15.7.2013 se “nuk mund të provohet fakti se në zyrën noteriale është paraqitur një person tjetër për të kryer veprimin”, nuk bazohet në rezultatet e hetimit nga të cilat është vërtetuar se: (a) kallëzuesi në kohën kur është kryer veprimi noterial nuk gjendej në Shqipëri; (b) noteri ka bërë shënimin në regjistrin noterial ku pasqyrohet se shtetasi E. K. ka kryer veprimin noterial dhe në arsyetimin ligjor për detyrimin e noterit për identifikimin e personit që paraqitet për kryerjen e veprimit noterial; (ii) Subjekti në vendimin e datës 15.7.2013 nuk ka analizuar elementet e anës objektive të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” në raport me faktet e vërtetuara gjatë hetimit, pasi: (a) nuk ka analizuar nëse veprimet e noterit përbëjnë ose jo mospërmbushje të rregullt të detyrës; si dhe (b) pasojat e tyre nëse i kallëzuari ka siguruar përfitime materiale ose jomateriale për vete apo persona të tjerë ose nëse ka shkaktuar dëmtimin e interesave të ligjshëm të kallëzuesit.*

24. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²²⁰, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, duke verifikuar të gjitha veprimet e kryera nga noteri. Sipas bindjes së saj të brendshme, të bazuar në provat e marra gjatë hetimeve paraprake, nuk ka rezultuar që noteri të ketë kryer veprime me dashje, të cilat mund të përbënin elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Vendimi në fjalë i është njoftuar kallëzuesit, i cili nuk ka bërë ankim.

Analiza e Komisionit

25. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se bazuar në kallëzimin e shtetasit E. K., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. */2013, i cili është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë kallëzim, kallëzuesi ka deklaruar se nga viti 2009 jeton në Kanada dhe në dhjetor të vitit 2012 është vënë në dijeni se pranë autoriteteve kufitare është paraqitur nga shtetasi A. V. një certifikatë familjare e tij, e shoqëruar me dokumentin “Vërtetim i njësisë me origjinalin”, i datës 20.9.2011, i lëshuar nga noteri P. Z. në emër të kallëzuesit. Kallëzuesi ka pretenduar se në kohën e lëshimit të dokumentit**

²²⁰ Email datë 22.11.2023.

nga noteri nuk ka qenë në Shqipëri, por në Kanada, duke paraqitur edhe dokumentet e sistemit kufitar kanadez. Në vijim, ka pretenduar se në regjistrin e noterit, në të njëjtin rresht, janë kryer veprime në emër të një shtetasi tjetër, me emrin V. A.. Nga këqyrja e regjistrin noterial ka rezultuar se veprimi noterial i lartpërmendur ndodhet i regjistruar në të njëjtin rresht me shënimin e bërë për veprimet e kryera nga shtetasi V. A.. Noteri P. Z. ka deklaruar se nuk e kujton si rast, por duke iu referuar shënimeve në regjistër mendon se këta dy shtetas duhet të kenë qenë njëkohësisht në zyrën e tij për kryerjen e të njëjtit veprim “Vërtetim me origjinalin” dhe, si pasojë e ngarkesës atë ditë, duhet të jetë bërë shënimi në të njëjtin rresht. Në deklarimin e tij, shtetasi V. A. ka deklaruar se është paraqitur tek zyra noteriale për të kryer veprimin për vërtetësinë e një dokumenti “Makinë gjermane”, nuk e njeh shtetasin E. K. dhe nuk kujton të ketë kryer ndonjë transaksion me këtë person.

26. Subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 15.7.2013 ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke arsyetuar se nuk është konsumuar vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” nga noteri, pasi veprimet e kryera nga ana e tij figurojnë në regjistrin noterial, pavarësisht se në të njëjtin rresht regjistri, dhe nuk provohet që noteri e ka kryer me dashje këtë regjistrim. Pasi është njohur me këtë vendim, kallëzuesi ka paraqitur kallëzim penal ndaj prokurores Françeskina Lekani në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila më pas i ka përcjellë aktet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në vijim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***/2014 dhe prokurori i çështjes, me vendimin e datës 10.6.2014, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nga veprimet e kryera dhe nga vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

27. Komisioni arsyeton se pavarësisht faktit që veprimet e subjektit janë analizuar në kuadër të një procedimi penal, duke çmuar se të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit në ndjekjen e çështjes penale²²¹. Subjekti i rivlerësimit në vendimin e pushimit të procedimit penal, ndërmjet të tjerave, arsyeton se: *“Regjistrimi në libër dhe kryerja e veprimeve noteriale bëhet nga noteri pasi njihet me dokumentin e identifikimit të personit që kërkon shërbimin dhe nga prokuroria nuk mund të provohet fakti nëse në zyrën noteriale është paraqitur një person tjetër për të kryer veprimin që pretendon kallëzuesi, pasi praktika është asgjësuar”*. Nga hetimet paraprake është konstatuar se në të njëjtin rresht të regjistrin noterial është bërë shënimi i veprimit “Vërtetim me origjinalin” i shtetasit E. K. me veprimin e shtetasit V. A.. Gjithashtu, sipas dokumentacionit të autoriteteve kufitare kanadeze, vërtetohet që në kohën kur është lëshuar dokumenti noterial, kallëzuesi ka qenë në territorin kanadez. Sa më sipër, duket se konkluzioni i subjektit në vendimin e pushimit se nuk mund të provohet fakti se në zyrën noteriale është paraqitur një person tjetër për të kryer veprimin, nuk bazohet në: (i) rezultatet e hetimit; (ii) arsyetimin ligjor të vendimit, ku është shprehur se regjistrimi në libër dhe kryerja e veprimeve noteriale bëhet nga noteri, pasi njihet me dokumentin e identifikimit të personit që kërkon shërbimin.

28. Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit në vendimin e saj nuk ka analizuar elementet e anës objektive të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248²²² i Kodit Penal, në raport me faktet e vërtetuara gjatë hetimit, pasi nuk ka analizuar: (i)

²²¹ Vendimi nr. 30, datë 18.11.2019 (JR), pg. 52 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²²² Kodi Penal, neni 248: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të*

nëse veprimet e noterit përbëjnë ose jo mospërbushje të rregullt të detyrës; (ii) pasojat e këtyre veprimeve nëse noteri ka siguruar përfitime materiale ose jomateriale për vete apo persona të tjerë, ose nëse ka shkaktuar dëmtimin e interesave të ligjshëm të kallëzuesit²²³.

29. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se vendimin e ka marrë bazuar në bindjen e saj të brendshme, Komisioni arsyeton se koncepti i bindjes së brendshme të magjistratëve është i lidhur vetëm me interpretimin e ligjit në kontekstin e fakteve dhe provave të një çështjeje të caktuar. Në çdo rast, bindja e brendshme duhet të jetë në përputhje me ligjin, me analizën e fakteve dhe provave në brendësi të çështjes, për ta kualifikuar atë sipas ligjit²²⁴.

30. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor, duke u bazuar në tregues të tillë, si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit, kriteret të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

31. Lidhur me dosjen penale të administruar në kuadër të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2016, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin e datës 11.1.2013 për pushimin e çështjes penale nr. *** pa kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka verifikuar aktet hartografike të kundërshtuara për origjinalitetin e tyre nga kallëzuesit.*

32. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²²⁵, subjekti i rivlerësimit shpjegon se pretendimi për falsifikim i ankueses ndaj palës që kishte përfituar nga vendimi i KKKP-së i referohej periudhës para vitit 1994 dhe deri në datën 27.7.2012 kishte kaluar çdo afat i parashkrimit të ndjekjes penale. Për këtë arsye, vijon subjekti i rivlerësimit, nuk është hetuar më tej rreth këtij fakti, aq më tepër kur këto pretendime pala i ka paraqitur edhe gjatë gjykimit civil dhe nuk janë marrë në konsideratë nga gjykata. Në vijim, sqaron se gjykata, me vendimin nr. ***, datë 5.9.2013, i ka caktuar si detyrë vetëm pyetjen e të gjithë trashëgimtarëve dhe të drejtuesit dhe kryeregjistruesit, që kanë qenë në detyrë në atë kohë në ZVRPP-në Shkodër, veprime të cilat i ka kryer. Gjithashtu, shpjegon se procedimi penal është hetuar nga një prokuror tjetër, i cili po ashtu ka konkluduar me vendim për pushimin e çështjes.

Analiza e Komisionit

33. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se shtetaset L. dhe Z. H. kanë paraqitur kallëzim penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, me shkakun se dokumentet, mbi bazën e të cilave është mbështetur vendimi i KKKP-së në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit P. D., janë të falsifikuara, pasi në hartat e vitit 1938 objekti nuk ekziston, por shfaqet në hartat e vitit 1964, çka sipas tyre provon se është një objekt i ndërtuar nga shteti dhe, për pasojë, duhet të hetohet nga ana e prokurorisë se në ç’mënyrë është bërë i mundur pasqyrimi i objektit. Në kuadër të këtij kallëzimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 11.1.2013 ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. ***, me arsyetimin se pretendimet e kallëzuesve janë verifikuar në gjykimin civil dhe janë gjendur të pabazuara. Kundër këtij vendimi kallëzueset kanë paraqitur ankim në gjykatë.

tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

²²³ Vendimi nr. ***, datë 14.5.2014, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²²⁴ Vendimet nr. 1, datë 30.5.2021 (JD) dhe nr. 3, datë 7.12.2022 (JD), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²²⁵ Email datë 22.11.2023.

34. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 5.9.2013²²⁶, ka vendosur pranimin e ankimit, prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke lënë dhe detyrat përkatëse²²⁷. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 30.1.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, me arsyetimin se kryerja e veprimeve hetimore të administrimit të dokumentacionit hartografik, pyetja e trashëgimtarëve dhe e regjistruessve të ZVRPP-së Shkodër, lidhur me ndryshimet në paraqitjen e hartave të viteve 1938 e 1964 dhe marrja e opinioneve të ekspertëve hartografë lidhur me këto ndryshime, vlerësohen si thelbësore për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të kallëzuesve.

35. Pas kthimit të çështjes për vazhdimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 26.10.2015 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***. Ky vendim është ankimuar në gjykatë dhe rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 26.7.2016²²⁸, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 29.9.2017²²⁹. Nga verifikimi në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë rezulton se kjo çështje ndodhet për gjykim pranë kësaj gjykate (nr. ***) dhe nuk është caktuar data e gjykimit.

36. Pasi janë njohur me vendimin e datës 26.10.2015, shtetaset L. dhe Z. H. kanë bërë kallëzim penal ndaj prokurores Françeskina Lekani në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke e akuzuar për shpërdorim detyre. Më pas, ky kallëzim penal është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Prokurori i çështjes me vendimin e datës 6.6.2016 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk ka elemente të veprës penale²³⁰.

37. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e datës 11.1.2013 për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se pretendimet e kallëzuesve lidhur me falsifikimin dokumenteve janë shqyrtuar në gjykimin civil, duke mos u shprehur lidhur me konsumimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale²³¹, sikurse ka shpjeguar në përgjigje të rezultateve të hetimit. Në vijim, nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 27.5.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë²³², ku është trajtuar çështja civile së cilës i referohet subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton që pala e paditur L. dhe Z. H. gjatë gjykimit të kenë ngritur pretendime lidhur me falsifikimin e dokumenteve të paraqitura nga pala paditëse në KKKP dhe këto pretendime të jenë vlerësuar nga gjykatat. Për pasojë, duket se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e datës 11.1.2013, për pushimin e çështjes penale nr. ***, nuk është i mbështetur në vendimet gjyqësore të marra në gjykimin civil. Për pasojë, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me konstatimet e rezultateve të

²²⁶ Të administruar nga sistemi elektronik gjykata.gov.al

²²⁷ Urdhërohet prokurorja Françeskina Lekani të bëjë të gjitha hetimet e nevojshme lidhur me faktin se si është bërë i mundur pasqyrimi i objektit "jerevi" nga trashëgimtarët e P. Sh. D.. Lidhur me këtë, prokurorja duhet të pyesë të gjithë trashëgimtarët, si dhe të gjithë drejtuesit, kryeregjistruessit, që kanë qenë në ZVRPP dhe të analizojë se në ç'mënyrë është bërë shtesa e objektit (jerevi) në hartat regjistruese.

²²⁸ Të administruar nga sistemi elektronik gjykata.gov.al.

²²⁹ Të paraqitur nga denoncuesja L. H. në denoncimin nr. ***, datë 18.1.2018.

²³⁰ Kundër këtij vendimi kallëzueset kanë paraqitur ankim në gjykatë dhe rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. ***, datë 23.12.2016, ka vendosur mospranimin e ankimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 6.12.2017. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 15.6.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesset L. H. dhe Z. H..

²³¹ Referuar përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 5.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vendimit nr. ***, datë 30.1.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

²³² Të administruar nga faqja elektronike e Gjykatës së Lartë.

hetimit, se ka marrë vendimin e datës 11.1.2013 për pushimin e çështjes penale nr. *** pa kryer veprimet e nevojshme hetimore.

38. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

39. Lidhur me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. * të vitit 2020**, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) *Mbetet i paqartë fakti që nga ana e subjektit nuk është ngritur akuza për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal ndaj shtetasit A. B., në kushtet kur nga hetimi është vërtetuar se: pasuria e paluajtshme tokë me sip. 39 ha është përfituar me dokumente të falsifikuara; dokumentacioni është paraqitur në AKKP e, më pas, në gjykatë nga shtetasi A. B.; shtetasi A. B., në cilësinë e përfaqësuesit të shtetases D. H., këtë pasuri e ka tjetërsuar tek shtetasi F. Gj. me anë të kontratës së dhurimit;* (ii) *Subjekti nuk ka hetuar pretendimet e kallëzueses se: (a) pronën objekt hetimi e ka poseduar vazhdimisht shtetasi P. Gj.; (b) procesi gjyqësor për fitimin e pronës është ndjekur nga shtetasja S. B., juriste pranë bizneseve të shtetasit P. Gj., me qëllim vërtetimin e faktit nëse shtetasi P. Gj. ka pasur ose jo dijeni që prona e shtetases D. H. është përfituar me dokumente të falsifikuara dhe nëse ka pasur si qëllim pastrimin e produkteve të veprës penale nëpërmjet kalimit të pasurisë objekt hetimi babait të tij me anë të kontratës së dhurimit;* (iii) *Mbetet i paqartë fakti që nga ana e subjektit nuk është kërkuar konfiskimi i pasurisë tokë me sip. 30 dynymë, e cila i është kthyer si e lirë shtetases D. H., në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar që dokumentet mbi bazën e të cilave është përfituar kjo pasuri, kanë rezultuar të falsifikuara dhe kur shtetasi K. Gj. e ka përfituar këtë pasuri me kontratë dhurimi.*

40. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²³³, subjekti i rivlerësimit shpjegon se është e vërtetë që dokumenti ka rezultuar i falsifikuar dhe këtë fakt e ka pasqyruar në vendimin e pushimit, por sipas saj ishte parashikuar ndjekja penale. Gjithashtu, shpjegon se nuk është arritur të provohet personi i cili e ka falsifikuar këtë dokument, e aq më pak dijenia e shtetasit A. B. që ky dokument ishte i falsifikuar. Në këto kushte, sipas saj nuk ka pasur asnjë element për të ngritur akuzë ndaj shtetasit në fjalë. Gjithashtu, shpjegon se për pronën në fjalë është vënë në dijeni si nga ana e prokurorisë, ashtu edhe nga Avokatura e Shtetit si institucion që mbron interesat shtetërorë dhe i lind detyrimi ligjor të kërkojë kthimin e asaj sipërfaqeje toke në gjendjen fillestare, por ky institucion nuk ka shfaqur interes për të marrë pjesë në gjykim. Më pas shpjegon se kërkesa e saj për pushimin e çështjes është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. *** datë 14.11.2022.

Në vijim, shpjegon se nga ana e saj nuk është çmuar se ekzistonin elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, por edhe nëse do të ekzistonin, dyshimi kryesor në këtë procedim penal bie mbi të ndjerën D. H., si përfituese e parë e pronës dhe tjetërsuese e saj, dyshim i cili nuk mund të hetohet më tej, për sa kohë kjo shtetase kishte ndërruar jetë. Më pas, shpjegon se gjykata në analizën e saj ka konkluduar se, pasi u hetua mundësia e ekzistencës së veprave të tjera penale, të cilat janë ngritur si pretendim nga kallëzuesit, ka arritur në

²³³ Email datë 22.11.2023.

përfundimin se nuk ka asnjë veprim hetimor, i cili mund të përcaktojë ndonjë përgjegjësi penale të personave të tjerë në këtë procedim.

Në përfundim, bën me dije se lidhur me këtë rast, për vendimin e pushimit të marrë nga ana e saj, është bërë ankim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili me vendimin nr. *** prot., datë 31.7.2023, ka vendosur “Arkivimin për shqyrtimin fillestar të ankesës”. Bashkëlidhur shpjegimeve ka paraqitur si provë vendimin nr. ***, datë 14.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vendimin e ILD-së.

Analiza e Komisionit

41. Nga shqyrtimi i kërkesës për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** dhe vendimit nr. ***, datë 14.11.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër²³⁴, rezulton se organet ligjzbatuese kanë marrë informacion se shtetasja D. H. ka përfituar një tokë në ***, Velipojë, me sipërfaqe 39 hektarë, të cilën dyshohet se e ka përfituar në mënyrë të paligjshme, me dokumente të falsifikuara.

42. Në vijim, në datën 29.7.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka paraqitur kallëzim penal shtetasja L. Z. (vajza e shtetasës D. H.), e cila ka pretenduar se noterja V. H. ka falsifikuar prokurën me nr. ***, datë 17.1.2012, me anë të së cilës shtetasja D. H. i ka dhënë tagrat e përfaqësimit shtetasit A. B.. Sipas kallëzueses, me anë të kësaj prokure, shtetasi A. B. ka kryer një sërë veprimesh në mashtrim të ligjit, deri tek tjetërsimi i pronave të shtetasës D. H.. Më pas ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasve P. Gj. dhe S. B. dhe ka pretenduar se shtetasja S. B., juriste pranë bizneseve të shtetasit P. Gj., është autorizuar nga shtetasi A. B. për të marrë pjesë në procedurat ligjore për fitimin e pronës në emër të shtetasës D. H. dhe, menjëherë pas kësaj, prona i ka kaluar me dhurim babait të shtetasit P. Gj., F. Gj..

43. Gjithashtu, ka paraqitur kallëzimin penal edhe shtetasi D. M., i cili ka pretenduar se vendimin nr. ***, datë 9.7.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet të cilit shtetasës D. H. i është kthyer një sipërfaqe toke prej 39 ha, në të cilën ndodhet edhe një pjesë e pasurisë së tij, është bazuar në dokumente të falsifikuara.

44. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasja D. H. nëpërmjet shtetasit A. B., të cilin e ka pajisur me prokurë, ka paraqitur kërkesë pranë AKKP-së Tiranë për njohjen dhe kthimin e një sipërfaqe toke prej 390 dynym tokë, të ndodhur në fshatin ***, Komuna Velipojë. AKKP Tiranë me vendimin nr. ***, datë 26.11.2012 ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se bie në kundërshtim me ligjin nr. *** dhe dokumentacioni nuk është i plotë. Ky vendim është kundërshtuar nga përfaqësuesi i shtetasës D. H. në gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 29.7.2013, ka vendosur pranimin e kërkesës, anulimin vendimit të AKKP-së Tiranë, njohjen e të drejtës së pronësisë paditëses D. H. për një sipërfaqe prej 390 dynym, të ndodhur në fshatin ***, Velipojë, kthimin si të lirë të sipërfaqes prej 30 dynym, si dhe kompensimin e paditëses për sipërfaqen 360 dynym. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 9.7.2014. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 18.5.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Më pas, me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 29.8.2017, shtetasja D. H., e përfaqësuar nga shtetasi A. B., i ka dhuruar shtetasit F. Gj. pasurinë me sip. 215.030 m².

²³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

45. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se provat mbi bazën e të cilave janë dhënë vendimet gjyqësore, që i kanë njohur shtetases D. H. të drejtën e pronësisë, janë vërtetimi i pronësisë datë 17.1.1997, i Zyrës së Hipotekës Shkodër, disa dokumente arkivore të vitit 1935, si dhe korrespondenca e Ministrisë së Financave të kohës me Komunën Velipojë, ku përmendet emri i shtetases D. H. si pronare e një sipërfaqeje toke në Velipojë. Hetimet kanë vërtetuar se dokumentet e mësipërme janë të falsifikuara²³⁵. Lidhur me pretendimet e shtetases L. Z. për falsifikimin e prokurës, nga kryerja e aktit ekspertimit ka rezultuar se kjo prokurë është nënshkruar nga shtetasja D. H., e cila gjithashtu ka deklaruar se prokurën e ka lëshuar me qëllim që shtetasi A. B. (djali i kushëririt) të kryente veprimet ligjore lidhur me kthimin e pronës.

46. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në gjykatë kërkesën për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se dokumentet që dyshohen të falsifikuara janë përdorur në vitin 2012 dhe, si pasojë, nga përdorimi për herë të fundit i dokumenteve të mësipërme dhe deri në regjistrimin e procedimit penal ka kaluar një periudhë kohore, që e tejkalon afatin e parashkrimit të ndjekjes penale, parashikuar nga neni 66/ç i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 14.11.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal nr. ***.

47. Komisioni, duke çmuar se të njëjtat fakte mund t'u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, pavarësisht faktit që veprimet e subjektit janë verifikuar nga gjykata, ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit në ndjekjen e çështjes penale²³⁶ si më poshtë vijon:

48. Kodi Penal në nenin 287²³⁷ ka parashikuar veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”²³⁸. Nga interpretimi literal dhe gramatik i kësaj dispozite, arrihet në përfundimin se nga ana objektive kjo veprë penale kryhet përmes veprimeve aktive të autorit të veprës në një nga format e parashikuara në këtë dispozitë. Nga interpretimi harmonik i dispozitave të mësipërme arrihet në konkluzionin se vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale ose e veprimtarisë kriminale presupozon pastrimin e produkteve, që janë rrjedhojë e kryerjes së një veprë penale²³⁹. Në këtë kuptim, është e rëndësishme të evidentohet fakti se midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (*conditio sine qua non*). Sipas dispozitës së mësipërme, parashikimet e saj zbatohen edhe në rastet kur personi që ka kryer veprën, prej së cilës burojnë produktet e veprës penale, nuk mund të merret i pandehur, nuk mund të dënohet, ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose mungon njëri nga kushtet e procedimit penal

²³⁵ Pas përsëritjes tri herë të akteve të ekspertimit.

²³⁶ Vendimi nr. 30, datë 18.11.2019 (JR), pg. 52 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²³⁷ Kodi Penal, neni 287: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale nëpërmjet: (a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; (b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; (c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale... dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”.

²³⁸ Parashikimi i nenit 287, pika 1, shkronja “b” e Kodit Penal, është e njëjtë me parashikimin e nenit 9, pika 1, shkronja “b” e Konventës së Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.

²³⁹ Vendimi nr. ***, datë 11.5.2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

për një veprë të tillë²⁴⁰ (p.sh. ka ndërruar jetë, është larguar jashtë shtetit, ose është i sëmurë në gjendje kome etj.).

49. Pastrimi i produkteve të veprës penale nuk përfaqëson një akt të vetëm, por përfshin një proces, i cili synon jo vetëm fshehjen e origjinës së vetë produktit, por edhe mbajtjen nën kontroll të tij dhe ky proces zakonisht kalon nëpër tri faza, të cilat janë: (i) vendosja në posedim/kontroll e produktit të veprës penale; (ii) shtresëzimi, i cili përfaqëson përpjekjen e autorit të veprës penale për të realizuar ndarjen e produktit nga burimi kriminal, duke krijuar rrjete komplekse transaksionesh financiare; (iii) integrimi, i cili përfaqëson epilogun e procesit të pastrimit të produkteve të veprës penale, në të cilin ky produkt integrohet në ekonominë e ligjshme dhe bashkohet me asetet e tjera të ligjshme.

50. Nocioni i “produktit të veprës penale” konstatohet edhe në nenin 36²⁴¹ të Kodit Penal, i cili parashikon detyrimin e gjykatës për konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale.

51. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se nuk është arritur të provohet personi i cili ka falsifikuar dokumentet e paraqitura në AKPP dhe në gjykatë dhe dijenia e shtetasit A. B. që këto dokumente ishin të falsifikuara, nuk janë bindëse, në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar se: (i) pasuria e paluajtshme tokë me sip. 39 ha është përfituar me dokumente të falsifikuara; (ii) dokumentacioni është paraqitur në AKKP e, më pas, në gjykatë nga shtetasi A. B., në cilësinë e përfaqësuesit të shtetases D. H.; (iii) pas përfitimit të pasurisë së mësipërme, shtetasi A. B., në cilësinë e përfaqësuesit të shtetases D. H., këtë pasuri e ka tjetërsuar tek shtetasi F. Gj.me anë të kontratës së dhurimit. Për pasojë, mbetet i dyshimtë fakti që ndaj shtetasit A. B. nuk është ngritur akuza për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

52. Në vijim, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit se nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për vërtetimin e faktit nëse shtetasi P. Gj. ka pasur ose jo dijeni që prona e shtetases D. H. është përfituar me dokumente të falsifikuara dhe nëse ka pasur si qëllim pastrimin e produkteve të veprës penale, nëpërmjet kalimit të pasurisë objekt hetimi babait të tij me anë të kontratës së dhurimit, në kushtet kur kallëzuesja ka pretenduar se: (a) pronën objekt hetimi e ka poseduar vazhdimisht shtetasi P. Gj.; (b) procesi gjyqësor për fitimin e pronës është ndjekur nga S. B., juriste pranë bizneseve të shtetasit P. Gj.. Për pasojë, mbetet i dyshimtë fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar marrëdhënien e shtetasit P. Gj. me pronën objekt hetimi dhe dijeninë e tij nëse kjo pasuri, e cila më pas i kaloi me dhurim babait të tij, është përfituar me dokumente të falsifikuara.

53. Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime edhe për sa i përket konstatimit të rezultateve të hetimit lidhur me paqartësinë e faktit se përse nuk ka kërkuar konfiskimin e pasurisë tokë me sip. 30 dynym, e cila i është kthyer si e lirë shtetases

²⁴⁰ Kodi Penal, neni 287: “...Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: (a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; (b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashikuar ose amnistuar...”.

²⁴¹ Kodi Penal, neni 36: “I. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: ...b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale”.

D. H., sipas parashikimeve të nenit 36 të Kodit Penal, në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar që dokumentet mbi bazën e të cilave është përfituar kjo pasuri kanë rezultuar të falsifikuara, si dhe në kushtet kur shtetasi K. Gj. e ka përfituar këtë pasuri me kontratë dhurimi. Për pasojë, edhe në këtë rast mbetet i dyshimtë fakti i mosveprimit të subjektit të rivlerësimit.

54. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Avokatura e Shtetit si organ që mbron interesat shtetërorë nuk ka shfaqur interes për të marrë pjesë në këtë gjykim, ky pretendim i subjektit nuk mbështetet në dispozitat e Kodit Penal, i cili parashikon në nenin 36 se *gjykata është e detyruar të konfiskojë dhe të kalojë në favor të shtetit produktet e rrjedhura nga vepra penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie*. Gjithashtu, shpjegimi i mësipërm nuk mbështetet edhe në natyrën dhe qëllimet që ndjek procesi penal i cili, në dallim nga procesi civil që ka karakter objektiv, ka karakter subjektiv, ku qëllimi kryesor është identifikimi i autorit të veprës penale, me qëllim vënien e tij para përgjegjësisë penale. Për pasojë, fakti që Avokatura e Shtetit nuk ka vepruar për kthimin e pronës së përfituar me dokumente të falsifikuara, nuk përbën justifikim për subjektin e rivlerësimit për moskryerjen e veprimeve hetimore, për ngritjen e akuzës penale sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal, si dhe në kërkimin e sekuestrimit, e më pas, të konfiskimit të pasurisë së përfituar me dokumente të falsifikuara sipas parashikimeve të Kodit Penal.

55. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se kërkesa e saj është pranuar nga gjykata, Komisioni arsyeton se në rastin konkret nuk ka shqyrtuar çështjen penale me qëllim për t'i dhënë zgjidhje asaj me pasoja konkrete për palët, por ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit.

56. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo çështje është shqyrtuar nga ILD-ja, Komisioni, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese²⁴², arsyeton se sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, organet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

57. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi të theksuara në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, duke u bazuar në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, kriteret që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

58. Në Komision, për subjektin e rivlerësimit Françeskina Lekani janë administruar 3 denoncime nga publiku, nga të cilat denoncimi i shtetases L. H. është trajtuar më lart, në paragrafët 31-38 të vendimit, ndërsa dy denoncimet e tjera u vlerësuan nga Komisioni se nuk ka të dhëna për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

²⁴² Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, ndërmjet të tjerave, është shprehur: "...sipas nenit 45 të ligjit, anëtarët e KPK-së, gjyqtarët e KPA-së dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit. Kjo dispozitë lejon që këto institucione të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes".

KONSTATIME TË TJERA

Në vijim të konstatimeve të pasqyruara në kreun ku janë trajtuar pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe ku është trajtuar konflikti i interesit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, bazuar në nenet 71 e 73, pika 2, dhe nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, analizoi veprimet e subjektit të rivlerësimit në ndjekjen e procedimit penal nr. ***/2022 dhe në kuadrin e vlerësimit të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas indikatorit të paanësisë.

59. Lidhur me ndjekjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2022, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *(i) Subjekti në ndjekjen e procedimit penal nr. ***/2022 dhe në marrjen e vendimit të datës 30.6.2022, për pushimin e këtij procedimi ka cenuar parimin e paanësisë pasi: (a) mes tij dhe të kallëzuarve ekzistonte marrëdhënia juridiko-civile me karakter pasuror/detyrimi, e cila nuk kishte përfunduar; (b) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka verifikuar nëse shoqëria “***” sh.p.k., pas dhënies së vendimit gjyqësor, ka kryer veprime për fshehjen e pasurive apo tërheqjen e shumave monetare nga bankat me qëllim pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor; (c) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka verifikuar nëse shtetasi Sh. D., pas dhënies së vendimit gjyqësor, ka kryer veprime për fshehjen e pasurive apo tërheqjen e shumave monetare nga bankat, me qëllim pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor; (ii) Subjekti në ndjekjen e procedimit penal nr. ***/2022 ka cenuar besimin e publikut tek organet e drejtësisë, pasi: (a) ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit; (b) me veprimet e mosveprimeve të tij ka favorizuar të kallëzuarit.*

60. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁴³, subjekti i rivlerësimit sqaron se shpjegimet lidhur me këtë barrë prove i ka sqaruar në pikën kur ka dhënë shpjegime lidhur me konfliktin e interesit.

Analiza e Komisionit

61. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se ndërmjet shtetasit C. F., në cilësinë e paditësit, dhe shoqërisë “***” sh.p.k., Sh. D., në cilësinë e të paditurve, është zhvilluar procesi gjyqësor me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së sipërmarrjes të datës 27.1.2015 dhe zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes datë 12.4.2012. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 30.12.2020, ka vendosur pranimin e padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së sipërmarrjes datë 27.1.2015, zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes datë 12.4.2012, si dhe detyrimin e të paditurve t’i kthejnë paditësit shumën 300.000 euro. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 5.5.2021. Në vijim, Zyra e Përmbarrimit Shkodër ka vënë në ekzekutim vendimin e mësipërm gjyqësor dhe, në kushtet kur nuk ka gjetur asnjë pasuri të sekuestrueshme dhe pala debitore nuk ka marrë masa për zbatimin e vendimit gjyqësor, ka paraqitur kallëzim penal në Prokurori për mosekzekutim vendimi gjyqësor.

62. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, si dhe ka administruar fashikullin e gjykimit dhe praktikën e zyrës së përmbarrimit. Më pas, me vendimin e datës 30.6.2022 ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nga hetimet nuk janë evidentuar veprime aktive, me qëllim që të mos ekzekutohet apo të pengohet

²⁴³ Email datë 22.11.2023.

ekzekutimi i vendimit gjyqësor, pasi mospasja në pronësi e pasurive të paluajshme dhe e parave në banka nuk përbën vepër penale.

63. Nga hetimi administrativ kryesisht i Komisionit ka rezultuar se: (i) ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe babait të subjektit të rivlerësimit, z. F. L., është lidhur kontrata e sipërmarrjes e datës 7.9.2011 për blerjen e dy apartamenteve në vlerën 113.000 euro; (ii) shuma që i është paguar shoqërisë për këtë apartament nga subjekti dhe babai i saj është në vlerën 6.241.950 lekë²⁴⁴; (iii) pas vdekjes së shtetasit F. L., subjekti rezulton trashëgimtare ligjore e tij, duke gëzuar 1/3 e pjesës së pasurisë; (iv) subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar që marrëdhënia me shoqërinë nuk është përfunduar²⁴⁵.

64. Kodi i Procedurës Penale në nenin 26²⁴⁶ parashikon se *prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie sipas parashikimeve të nenit 17²⁴⁷, që parashikon rastet kur gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje.*

65. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në një çështje konkrete, ndërsa testi i dytë lidhet me vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe, mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor²⁴⁸. Më tej, ka arsyetuar se respektimi i parimit të paanësisë duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie²⁴⁹.

66. *Lidhur me testin subjektiv*, Komisioni arsyeton se dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, janë komplementare me ato të Kodit të Procedurës Penale për rastet e përjashtimit të gjyqtarit. Shkronja “ë” e pikës 1 e nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale parashikon si rast të përjashtimit të gjyqtarit, përveç rasteve të përcaktuara në pikat e tjera, kur sipas rrethanave konkrete

²⁴⁴ (i) Datë 9.9.2011, vlera 2.107.500 lekë, transfertë nga BKT-ja në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) datë 10.9.2012, vlera 690.450 lekë (ekuivalenti i vlerës 5.000 euro), depozitim në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) datë 26.4.2013, vlera 3.444.000 lekë, transfertë nga BKT-ja në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

²⁴⁵ Në procesverbalin e datës 25.5.2021 të ILDKPKI-së.

²⁴⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 26: “Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17”.

²⁴⁷ Neni 17: “Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij; b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private, ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërin prej palëve private; d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

²⁴⁸ Vendimet nr. 18, datë 3.5.2007, nr. 11, datë 5.4.2013 etj., të Gjykatës Kushtetuese.

²⁴⁹ Vendimet nr. 7, datë 11.3.2008, nr. 11, datë 2.4.2008, nr. 23, datë 4.11.2008, nr. 25, datë 11.6.2013 etj., të Gjykatës Kushtetuese.

vërtetohen arsye serioze njëanshmërie. Ky parashikim është pika prerëse mes përcaktimeve të ligjit nr. 9367/2005 dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Përkufizimi i interesave privatë, i parashikuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005, i shërben gjyqtarit/prokurorit për të vlerësuar rast pas rasti nëse është apo jo në kushtet e arsyeve serioze të njëanshmërisë, të tilla që të cenojnë procesin e rregullt ligjor²⁵⁰. Neni 5²⁵¹ i ligjit nr. 9367/2005, në rastet e interesave privatë të zyrtarit, ndërmjet të tjerave, ka parashikuar interesat që burojnë nga të drejtat dhe detyrime pasurore dhe nga çdo marrëdhënie juridiko-civile.

67. Në rastin konkret, rezulton se në kohën kur subjekti është caktuar në ndjekjen e procedimit penal nr. ***/2022 dhe në marrjen e vendimit të pushimit, ndërmjet tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k. ekzistonte një marrëdhënie juridiko-civile me karakter pasuror për fitimin e pronësisë së dy apartamenteve, e cila nuk kishte/nuk ka përfunduar, për shkak se subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i saj nuk kanë paguar vlerën totale të çmimit të blerjes²⁵². Në këto rrethana, duket se subjekti i rivlerësimit ishte e detyruar të hiqte dorë nga ndjekja dhe marrja e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***/2022, me qëllim shmangien e situatës së papajtueshmërisë, duke qenë se mes saj dhe të kallëzuarit ekzistonte marrëdhënia juridiko-civile me karakter pasuror/detyrimi, e cila nuk kishte përfunduar.

68. Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk e kalon testin subjektiv lidhur me respektimin e parimit të paanësisë.

69. *Lidhur me testin objektiv*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk evidentohen veprimet e parashikuara nga neni 320 i Kodit Penal, si dhe nuk rezulton që gjatë gjykimit civil të jetë bërë sigurimi i padisë për ndonjë send, objekt apo llogari. Mospasja në pronësi e pasurive të paluajtshme dhe para në llogari bankare, konkludon subjekti i rivlerësimit, nuk përbën vepër penale.

70. Komisioni arsyeton se sipas parashikimeve të nenit 320²⁵³ të Kodit Penal, vepra penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, nga ana objektive konsumohet nëpërmjet: (i) veprimeve aktive që parashikohen në këtë dispozitë²⁵⁴ ndaj sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës; (ii) kryerjes së veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor.

71. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale konstatohet se përmbaruesi gjyqësor, pasi ka kërkuar informacion nga bankat dhe ASHK-ja, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative për pronat dhe llogaritë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., por nuk ka kërkuar informacion lidhur me veprimet e kësaj shoqërie pas datës kur është dhënë vendimi gjyqësor. Në këto kushte, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit dhe sipas parashikimeve të nenit 320 të Kodit Penal, duhej hetuar nëse nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. është kryer ndonjë veprim pas dhënies së vendimit gjyqësor, me qëllim pengimin e ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu, rezulton se përmbaruesi gjyqësor, pasi ka kërkuar informacion nga bankat dhe ASHK-ja, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative vetëm për pronat dhe llogaritë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe jo ndaj shtetasit Sh. D., i cili ka qenë i paditur në gjykim e, për pasojë, debitor solidar bashkë

²⁵⁰ Për analogji – vendimi nr. 10/202 (JR) i Kolegjit (A. Z.sh).

²⁵¹ Ligji 9367/2005, neni 5: “Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile...”.

²⁵² Bazuar në arsyetimin e pasqyruar në pg. 6.33 të kreut ku janë trajtuar pasuritë e subjektit të rivlerësimit.

²⁵³ Neni 320: “Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

²⁵⁴ Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi.

me shoqërinë. Në këto kushte, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, ishte e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore për identifikimin e pasurive, llogarive personale të shtetasit Sh. D. përpara dhënies së vendimit gjyqësor e, më pas, nëse ky shtetas pas vendimit gjyqësor ka kryer veprime për fshehjen e pasurive apo tërheqjen e shumave monetare nga bankat, me qëllim pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore.

72. Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk e kalon testin objektiv të respektimit të parimit të paanësisë.

73. Komentari i Parimeve të Bangalorit, në pikën 52 të tij parashikon se: *“Paanshmëria është cilësia themelore e kërkuar nga një gjyqtar dhe atributi kryesor i gjyqësorit. Paanshmëria duhet të ekzistojë edhe si çështje faktike, edhe si çështje e perceptimit të arsyeshëm. Nëse njëanshmëria perceptohet në mënyrë të arsyeshme, ky perceptim ka të ngjarë të lërë një ndjenjë ankese dhe padrejtësie që është kryer, duke shkatërruar kështu besimin në sistemin gjyqësor”.*

74. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek organet e drejtësisë, pasi në ndjekjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2022 ka vepruar në kundërshtim me parimin e paanësisë, parashikuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

75. Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale, duke çmuar se: (i) në periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 subjektit të rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” nga Prokurori i Përgjithshëm dhe rrethanat që kanë shërbyer si shkak për dhënien e saj; (ii) dyshimet e arsyeshme të krijuara nga shqyrtimi i procedimit penal nr. *** të vitit 2020 lidhur me moskryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe interpretimit të gabuar të ligjit me pasoja të rënda të interesave shtetërore; (iii) faktin që subjekti i rivlerësimit në ndjekjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2022 ka vepruar në kushtet e papajtueshmërisë duke cenuar parimin kushtetues të paanësisë – Komisioni në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese²⁵⁵, në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave që përmbajnë këto praktika, vlerëson se shkeljet e konstatuara nuk përshihen në kategorinë e atyre që plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, por janë shkelje që kanë cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a”, “b”, “c”, dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke e vënë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

²⁵⁵ “54. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).

Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, për sa i përket problematikave të konstatuara, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë e, për pasojë, gjendet në kushtet e parashikuara nga pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Françeskina Lekani, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të shkarkohet nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 58, pika 1/c, nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Françeskina Lekani, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.12.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj